

**NDIKIMI I COVID-19 NË HUMBJET  
MËSIMORE, PASOJAT NË RRITJEN E  
PABARAZIVE NË MËSIM DHE SFIDAT  
E PËRMBUSHJES/KOMPENSIMIT**

Prishtinë, 2021



**NDIKIMI I COVID-19 NË HUMBJET  
MËSIMORE, PASOJAT NË RRITJEN E  
PABARAZIVE NË MËSIM DHE SFIDAT E  
PËRMBUSHJES/KOMPENSIMIT**

# **Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit**

## **Realizuar nga:**

Hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës

## **Raporti është hartuar nga:**

Selim Mehmeti, Haxhere Zylfiu, Lirije Bytyqi, Agim Bujari, Skender Mekolli, Mevlude Aliu, Bekim Morina, Ismet Potera

## **Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

## **Për botuesin:**

Nezir Çoçaj, drejtor

## **Këshilli Shkencor:**

Prof. dr. Naser Zabeli

## **Korrektues gjuhësor:**

Bekim Morina

## **Përgatitja teknike:**

Skender Mekolli

## **Shtypi:**

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

## Përmbajtja

<b>LISTA E SHKURTESAVE</b> .....	<b>8</b>
<b>PARATHËNIE</b> .....	<b>9</b>
<b>PREFACE</b> .....	<b>12</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>15</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>21</b>
<b>2. KONTEKSTI – ARSIMI PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË GJATË PANDEMISË COVID-19</b> .....	<b>24</b>
2.1. <i>Masat e ndërmarra për vazhdimin e mësimin në kushtet e pandemisë dhe përfundimin e vitit shkollor 2019/2020</i> .....	25
2.2. <i>Masat e ndërmarra për realizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021</i> .....	27
<b>3. HUMBJET MËSIMORE GJATË PANDEMISË, STUDIMET DHE TRAJTIMI I TYRE NGA STUDIUES TË VENDEVE TË NDRYSHME</b> .....	<b>37</b>
<b>4. QËLLIMI I STUDIMIT</b> .....	<b>44</b>
<b>5. METODOLOGJIA E STUDIMIT</b> .....	<b>45</b>
<b>6. REZULTATET E STUDIMIT</b> .....	<b>51</b>
6.1. Masa e humbjeve mësimore të nxënësve në arsimin parauniversitar .....	51
6.2. Rezultatet e nxënësve dhe humbjet mësimore gjatë pandemisë në lëndët gjuhë shqipe dhe matematikë .....	<b>56</b>
6.2.1. <i>Rezultatet e nxënësve të klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe</i> .....	56
6.2.2. <i>Rezultatet e nxënësve të klasës së shtatë në lëndën e Gjuhës shqipe</i> .....	62
6.2.3. <i>Rezultatet e nxënësve në testin e lëndës së Matematikës</i> .....	66
6.2.4. <i>Rezultatet në testin e Gjuhës shqipe dhe të Matematikës, sipas gjendjes socio-ekonomike të nxënësve dhe disa specifikave të punës së shkollave gjatë pandemisë</i> .....	69
6.3. Mësimi në kushtet e pandemisë nga perspektiva e drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve .....	80

6.3.1. Përgatitjet e shkollave për fillimin e vitit shkollor 2020/2021 dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë.....	81
6.3.2. Përfshirja e mësimeve në aktivitetet e zhvillimit profesional gjatë pandemisë.....	86
6.3.3. Planifikimi mësimor dhe zbatimi i kurrikulës gjatë pandemisë.....	89
6.3.4. Mësimi online dhe mësimi përmes RTK-së gjatë pandemisë.....	93
6.3.5. Angazhimi i nxënësve në mësim, bashkëpunimi me prindër, rezultatet e nxënësve dhe humbjet mësimore gjatë pandemisë.....	97
6.4. Roli i prindërve në përkrahjen e fëmijëve në mësim gjatë pandemisë .....	101
6.5. Mësimi në kushtet e pandemisë nga perspektiva e nxënësve të klasës së shtatë .....	110
<b>7. DISKUTIMI I REZULTATEVE .....</b>	<b>119</b>
7.1. Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore dhe në rritjen e pabarazive në mësim.....	120
7.2. Mësimi në kushtet e pandemisë nga perspektiva e qëndrimeve të subjekteve të shkollave (drejtorëve, mësimeve, prindërve dhe nxënësve).....	129
7.3. Kuadri i masave dhe politikave arsimore të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID - 19.....	134
7.4. Zgjidhjet e mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim .....	138
<b>8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>141</b>
8.1. Përfundime .....	141
8.2. Rekomandime .....	147
<b>REFERENCAT.....</b>	<b>151</b>

## **Falënderim**

Studimi nuk do të mund të realizohej pa bashkëpunimin, angazhimin dhe përkrahjen e të gjithë hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës, si dhe pa mirëkuptimin dhe përkrahjen e nxënësve, prindërve, mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave, zyrtarëve arsimorë në DKA dhe MASHTI.

Më këtë rast, falënderojmë të gjithë ata që përkrahën dhe mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij studimi. Në veçanti nxënësit e klasës së dytë dhe nxënësit e klasës së shtatë, prindërit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, të cilët iu përgjigjën pa asnjë hezitim kërkesës për të qenë mostër e këtij studimi, si dhe ata që ndihmuan në informimin e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve.

Ky studim është produkt dhe kontribut i veçantë i Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe stafit të tij, për ndikimin e pandemisë Covid-19 në arsimin parauniversitar në Kosovë.

## Lista e shkurtesave

<b>AP</b>	Aktivet/Departamentet Profesionale
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>COVID 19</b>	CO (Corona), VI (Viral), D (Disease)
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>GIZ</b>	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>IEAA</b>	Institucioni Edukativo – Arsimor Aftësues
<b>IA</b>	Inspektorati i Arsimit
<b>IKShPK</b>	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>KEC</b>	Qendra për Arsim e Kosovës
<b>KKAP</b>	Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit.
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>PISA</b>	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
<b>PSAK</b>	Planin Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>RNF</b>	Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare
<b>RNL</b>	Rezultatet e të nxënit të lëndës/temës mësimore
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
<b>UA</b>	Udhëzimi Administrativ
<b>UNICEF</b>	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët



## Parathënie

Studimi *Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit* është tematik, i realizuar nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës. Është dëshmi e kontributit dhe rolit modest të Institutit për të mbështetur zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, përmes studimeve të tilla, publikimeve të gjetjeve të studimit dhe nxjerrjes së rekomandimeve për institucionet arsimore, për qëllime të orientimit të politikave dhe praktikave arsimore.

Kur vendosëm të hulumtojmë dhe trajtojmë këtë temë, jemi përballur me disa dilema dhe me diskutime të shpeshta, se si t'i qasemi studimit, cilat aspekte të hulumtohen në ndërlidhje me objektin e studimit – ndikimin e pandemisë në humbjet mësimore. Po ashtu, çfarë metodologjie të përdorim për vlerësimin e humbjeve mësimore, kur nuk kemi një sistem të vlerësimit dhe të informatave kthyesë në formën elektronike për arritjet e nxënësve, për të krahasuar arritjet e rezultateve të nxënësve në raport me klasën dhe lëndët mësimore të caktuara.

Studimi ka arritur të përmbushë qëllimin e tij, të analizojë ndikimin e COVID-19 në arsimin parauniversitar, ndikimin në humbjet mësimore dhe në thellimin e pabarazive në mësim, dhe t'i kontribuojë sqarimit të arritjeve dhe humbjeve mësimore gjatë pandemisë, sfidave kryesore me të cilat janë përballur nxënësit, mësimdhënësit dhe institucionet arsimore parauniversitare në realizimin e mësimin në këto rrethana. Gjithashtu, studimi ofron rekomandime për mundësitë që duhen shfrytëzuar për vazhdimin e mësimin në këto rrethana, për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe për ngritjen e cilësisë së mësimin në arsimin parauniversitar.

Raporti i këtij studimi është organizuar në tetë pjesë të përmbledhura në kuadër të këtij botimi të veçantë, të cilit i paraprin një përmbledhje ekzekutive, e cila përshkruan qasjen hulumtuese dhe sjell përfundimet kryesore të bazuara në gjetjet e këtij studimi dhe rekomandimet kryesore, të cilat do t'u shërbejnë MASHTI-t dhe institucioneve edukativo-arsimore aftësuese si referencë për hapat e mëtejshme në organizimin e mësimin në kushtet/rrethanat e pandemisë.

Në pjesën e hyrjes përshkruhet konteksti i vendimmarrjes për mbylljen e institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA), në të gjitha nivelet e arsimit, me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, organizimin e mësimit në distancë, fillimin e vitit të ri shkollor në kushtet e pandemisë dhe organizimin e mësimit gjatë këtij viti në kushtet e pandemisë.

Pjesa e dytë e studimit trajton kontekstin e arsimit parauniversitar në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19, duke përshkruar masat e ndërmarra nga institucionet arsimore për vazhdimin e mësimit në kushtet e pandemisë dhe përfundimin e vitit shkollor 2019/2020, si dhe masat e ndërmarra për realizimin e mësimit në gjithë vitin shkollor 2020-2021. Në ndërlidhje me objektin e studimit, pjesa e tretë ofron një përmbledhje të humbjeve mësimore gjatë pandemisë, të pasqyruara në studime të vendeve të ndryshme dhe qasjet në trajtimin e tyre nga studiues të ndryshëm.

Pjesët në vijim të raportit të studimit janë kapitujt katër dhe pesë, për qëllimin dhe metodologjinë e studimit. Pasqyrohen objekti dhe objektivat e studimit, si dhe pyetjet kryesore, të cilat e udhëheqin studimin. Kapitulli për metodologjinë e studimit përshkruan qasjen hulumtuese, popullatën dhe mostrën, metodat dhe instrumentet e hulumtimit, procedurën e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, aspektin etik dhe kufizimet e studimit.

Kapitulli i gjashtë pasqyron rezultatet e studimit. Në këtë kapitull prezantohen rezultatet dhe argumente të rëndësishme, të lidhura me studimin. Veçanërisht pasqyrohen argumentet për masën e humbjeve mësimore të nxënësve në arsimin parauniversitar, rezultatet e nxënësve dhe humbjet mësimore gjatë pandemisë në lëndët Gjuhë shqipe (klasat e dyta dhe të shtata) dhe Matematikë (klasat e shtata), që pasqyrohen nga vlerësimi i realizuar me një mostër të nxënësve nga 52 shkolla, në 15 komuna.

Gjithashtu, prezantohen argumente, perceptime, ide dhe propozime që lidhen me përgatitjet dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, përkrahjen e mësimdhënësve, planifikimin mësimor dhe zbatimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë, rezultatet e nxënësve dhe humbjet mësimore të ndikuara nga pandemia.

Kapitulli i shtatë paraqet diskutimin e rezultateve në ndërlidhje me objektivat e studimit dhe pyetjet kërkimore, duke përfshirë ndikimin e COVID-19 në humbjet mësimore dhe në rritjen e pabarazive në mësim, mësimin në kushtet e pandemisë nga perspektiva e qëndrimeve të komunitetit të shkollës (drejtorëve, mësime dhënësve, prindërve dhe nxënësve), kuadrin e masave dhe politikave arsimore të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimin në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID-19, si dhe zgjidhjet e mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazisë në mësim.

Në kapitullin e tetë janë prezantuar përfundimet, mbështetur në gjetjet kryesore të studimit, dhe rekomandimet për institucionet arsimore. Falënderojmë të gjithë ata që e përkrahën dhe mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij studimi. Në mënyrë të veçantë mirënjohje për nxënësit pjesëmarrës në këtë studim, të cilët mundësuan të prekim thelbin e problemit të trajtuar.

Botimi i këtij raporti të studimit do t'u shërbejë lexuesve dhe politikëbërësve. Çdo sugjerim, kritikë dhe ndihmë tjetër në këtë tematikë të studimit, IPK-ja e mirëpret me kënaqësi, si formë të bashkëpunimit për përmirësimin dhe avancimin e arsimit kosovar.

Nezir Çoçaj, drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës

## Preface

The Study of impact of COVID-19 on learning losses, the consequences on increasing learning inequalities and the challenges of fulfillment, is a thematic study conducted by researchers of Kosovo Pedagogical Institute, is a contribution and modest support development of pre-university education in Kosovo. Through such studies, findings and the issuance of recommendations for educational institutions for the purposes of orienting educational policies and practices is welcome. When we decided to research and address this topic, we faced several dilemmas and frequent discussions on how to approach the study, which aspects to research in relation to the object of study - the impact of the pandemic on learning losses, what methodology will we use to assess learning losses when we do not have an electronic feedback system for student achievement to compare student learning achievement for weeks or months before the pandemic and weeks or months after the pandemic begins

The study managed to fulfill its purpose, to analyze the impact of COVID-19 on pre-university education, the impact on learning losses and the deepening of learning inequalities and to contribute to the clarification of learning achievements and losses during the pandemic, the main challenges faced by students, teachers and pre-university educational institutions in the realization of learning in these circumstances, as well as to provide recommendations for opportunities to be used to continue learning in these circumstances, reduce learning losses and increase the quality of learning in pre-university education.

The report of this study is organized in eight parts or chapters, summarized within this special edition, which is preceded by an executive summary, which describes the research approach and brings the main conclusions based on the findings of this study and the main recommendations, which will serve MESTI and training educational institutions, as a reference for further steps in organizing education in the conditions of the pandemic that is continuing to follow us, and to approach institutionally to support students

to reduce learning losses affected by COVID 19 and to eliminate inequalities in learning.

After the introduction, which describes the decision-making context for the closure of educational and training institutions (IEAA) at all levels of education, in order to prevent the spread of the virus and protect the health of citizens, the organization of distance learning, guidelines developed by MEST for the organization of distance learning, continuation of learning in pandemic conditions and the end of the school year 2019/2020, preparations of educational institutions in Kosovo for the beginning of the new school year in pandemic conditions, school year 2020 / 2021, worldwide discussions that pandemic has exacerbated (worsened) existing education, reduced access to learning, increasing learning inequalities, has affected social and emotional learning, interaction and social support, as well as the context of the situation and the needs to support the education system in Kosovo through such a study.

The second part of the study report, deals in more detail with the context of pre-university education in Kosovo during the COVID-19 pandemic, describing the measures taken by educational institutions to continue learning in the conditions of the pandemic and the end of the school year 2019/2020, as well as the measures taken for the realization of teaching in the whole school year 2020-2021. In relation to the object of the study, the third part provides a summary of the learning losses during the pandemic reflected in the studies of different countries and the approaches to their treatment by different researchers.

The following parts of the study report are chapters four and five about the purpose and methodology of the study. The chapter purpose of the study reflects the object and objectives of the study, as well as the main questions that guide the study. The study methodology chapter describes the study methodology, population and sample, research methods and instruments, data collection and analysis procedure, ethical aspect and limitations of the study.

Chapter six reflects the results of the study; it is the most special chapter of this study. This chapter brings important results and arguments related to the study. This chapter reflects the arguments for the extent of student learning

losses in pre-university education, student outcomes and learning losses during the pandemic in Albanian language subjects (grades 2 and 7) and mathematics (grade 7) which are reflected by the assessment carried out with a sample of students from 52 schools in 15 municipalities.

Chapter six, brings arguments, perceptions, ideas and proposals related to the preparation and organization of learning in pandemic conditions; teacher support, lesson planning and curriculum implementation in pandemic conditions; and student outcomes and learning losses affected by the pandemic.

Chapter 7 brings a discussion of the results in relation to the study objectives and research questions that guide the study, including the impact of COVID-19 on learning losses and increasing learning inequalities, learning in pandemic conditions from the perspective of attitudes of the school community (principals, teachers, parents and students), the framework of educational measures and policies undertaken by educational institutions in Kosovo for the organization of teaching in pre-university education, in the conditions of the COVID - 19 pandemic, as well as possible solutions for reducing learning losses and eliminating learning inequalities.

In the eighth chapter are organized the conclusions of the study that are based on the main findings of this study and recommendations for educational institutions, suggesting institutional actions to reduce learning losses and development directions in pre-university education in coherence with time.

We cordially thank all those who supported the successful realization and completion of this study, in particular gratitude to the students participating in this study who enabled us to touch the core of the problem addressed.

The publication of this study report is intended to serve readers. Any suggestions, criticisms and other assistance on this topic of the study, KPI welcomes, as a form of cooperation for the improvement and advancement of Kosovar education.

Nezir Çoçaj, Director of the Kosovo Pedagogical Institute

## Përmbledhje ekzekutive

Pandemia nuk e gjeti të përgatitur pothuajse asnjë sistem arsimor që të përballlet me sfidat e organizimit të mësimi. Rrethanat e imponuara nga pandemia globale ndryshuan rrjedhën e organizimit shoqëror, të punës dhe të organizimit të mësimi në kuadër të të gjithë sistemit arsimor, shtruan nevojën për procese e vendime në sektorin e arsimit, për sigurimin e vazhdimësisë në sistemin arsimor dhe për ruajtjen e mirëqenies së fëmijëve/nxënësve dhe shëndetit të të gjithëve.

Mbyllja e shkollave dhe organizimi i mësimi në distancë për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së pandemisë, në periudhën mars–qershor 2020, organizimi i mësimi në kushte të pandemisë për gjatë gjithë vitit shkollor 2020/2021 në arsimin parauniversitar në Kosovë, ndikuan në mobilizimin Institutit Pedagogjik të Kosovës, që të angazhohet dhe të realizojë studimin *Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit*, i cili trajton disa aspekte të veçanta të ndikimit të pandemisë në arsim, e të cilat janë në qendër të trajtimeve dhe diskutimeve nga shkencëtarët, hulumtuesit dhe profesionistët arsimorë, por edhe nga komuniteti i shkollave.

Studimi ka për qëllim të analizojë ndikimin e COVID-19 në arsimin parauniversitar, ndikimin në humbjet mësimore dhe në thellimin e pabarazive në mësim, t'i kontribuojë sqarimit të arritjeve dhe humbjeve mësimore, sfidave kryesore, me të cilat janë përballur nxënësit, mësimdhënësit dhe institucionet arsimore parauniversitare në realizimin e mësimi në këto rrethana, me qëllim që të ofrojë rekomandime për mundësitë që duhen shfrytëzuar për vazhdimin e mësimi në këto rrethana, zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe ngritjen e cilësisë së mësimi në arsimin parauniversitar. Realizimi i qëllimit të këtij studimi del përtej pasqyrit të ndikimeve në arsim nga pandemia, duke sugjeruar kahe zhvillimore në arsimin parauniversitar në koherencë me kohën.

Në ndërlidhje me objektin e studimit, i cili lidhet me humbjet mësimore, trajtohen përgatitjet e institucioneve arsimore dhe organizimi i mësimi në kushtet e pandemisë, përkrahja e mësimdhënësve gjatë pandemisë,

planifikimi mësimor, zbatimi i kurrikulës gjatë pandemisë, mësimi online, si dhe angazhimi i nxënësve në mësim.

Studimi është realizuar përmes qasjes hulumtuese të përzier, cilësore dhe sasiore, me një mostër të qëllimshme nga komuniteti i 52 shkollave (n=2504 nxënës; n = 490 mësimdhënës; n= 63 drejtorë të shkollave; n=826 prindër), në 15 komuna të Kosovës. Në kuadër të metodave cilësore, hulumtimi është realizuar përmes testeve të vlerësimit me nxënësit e klasave të dyta në lëndën e Gjuhës shqipe dhe vlerësimit me nxënësit e klasës së shtatë, në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë. Ndërsa, mbledhja e të dhënave sasiore është realizuar përmes pyetësorëve me nxënës të klasës së shtatë, mësimdhënës dhe prindër, të cilët u përdorën më pas si bazë për të zhvilluar analiza krahasuese.

Gjetjet nga studimi tregojnë se masat e ndërmarra nga institucionet arsimore, për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë, janë përqendruar më shumë në aspektet organizative të mësimin, në përgjigje rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19, kujdesin shëndetësor, pjesëmarrjen fizike të nxënësve në shkollë, realizimin zyrtar të programeve mësimore, kundrejt masave dhe veprimeve për këshillim dhe mbështetje psiko-sociale për fëmijët gjatë mësimin në kushtet e pandemisë, masave për të shmangur thellimin e pabarazive arsimore dhe zvogëlimin e humbjeve mësimore.

Humbjet mësimore në të gjitha nivelet e shkollimit, si pasojë e mbylljes, ishin evidente. Rezultatet nga studimi tregojnë se humbjet mësimore të nxënësve të arsimit parauniversitar në Kosovë nga ndikimi i pandemisë vijnë nga faktorë të ndryshëm, si: mbyllja e shkollave dhe mësimi në distancë; shkurtimi i kohës mësimore (orëve të mësimin), reduktimi i orëve mësimore dhe përmbajtjeve kurrikulare në disa lëndë mësimore, dhe metodat e mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë, kundrejt mësimdhënies në kushte të zakonshme në mjediset e klasës.

Metodologjia për vlerësimin e humbjeve mësimore, e përdorur në këtë studim, bazohet në metodologjinë e Bankës Botërore, në raportin për humbjet mësimore në periudhën e parë të pandemisë në Ballkanin Perëndimor, dhe në analizën e kontekstit të organizimit të mësimin në



arsimin parauniversitar në Kosovë gjatë periudhës së pandemisë. Rezultatet tregojnë se ndikimi i pandemisë në humbjet mësimore të nxënësve në Kosovë është i mundshëm të jetë sipas dy skenarëve:

- Skenari 1: humbje mësimore të krahasuara me 41 pikë të të nxënësve në PISA, apo mbi një vit të shkollimit, si rezultat i mospjesëmarrjes së nxënësve në mësimin në distancë në periudhën mars-qershor 2020, kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta, reduktimit të kurrikulave (rreth 25%) në disa lëndë mësimore gjatë vitit shkollor 2020/2021 dhe metodave të mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë;
- Skenari 2: humbje mësimore të krahasuara me 24 pikë të të nxënësve në PISA, apo më shumë se 60% e një viti të shkollimit sipas pikëve të të nxënësve në PISA, si rezultat i metodave të mësimdhënies joefektive gjatë mësimin në distancë dhe kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta.

Humbjet mësimore dhe pabarazitë në mësim në rritje dalin në pah edhe në vlerësimet e organizuara në kuadër të këtij studimi me nxënësit e klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe dhe nxënësit e klasës së shtatë në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë. Vlerësimi është bërë me teste të vlerësimit për shkallë kurrikulare, të përgatitura nga MASHTI para pandemisë, me administrim nga vetë shkollat, në bazë të udhëzimeve nga IPK-ja.

Nxënësit e klasës së dytë në këtë vlerësim, me mesataren e arritshmërisë 51.5 % në lëndën e Gjuhës shqipe, kanë arritur vetëm minimumin bazë të rezultateve të të nxënësve dhe kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Prej tyre, rreth 23% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të arritshmërisë. Rezultatet e nxënësve të klasës së dytë, të përfshirë në këtë studim, janë më të ulëta për rreth 28%, krahasuar me notën mesatare të këtyre nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe në fund të vitit shkollor.

Nxënësit e klasës së shtatë në lëndën e Gjuhës shqipe, me mesataren e arritshmërisë 41.%, kanë arritur vetëm minimumin e rezultateve bazë të të nxënësve dhe kanë nevojë për përkrahje dhe përmirësim të vazhdueshëm. Rezultatet e përgjithshme në lëndën e Gjuhës shqipe tregojnë se rreth 51 %

e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe, të cilat janë matur me instrumentin e vlerësimit në këtë studim, as në nivelin minimal të pritjeve. Prej tyre, rreth 15% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të rezultateve.

Rezultate të përafërta janë arritur edhe në lëndën e Matematikës. Nxënësit e klasës së shtatë në lëndën e Matematikës, me mesataren e arritshmërisë 48%, kanë arritur vetëm minimumin e minimumit të rezultateve bazë të të nxënësve. Ashtu si në lëndën e Gjuhës shqipe, edhe në lëndën e Matematikës nxënësit kanë nevojë për mbështetje dhe përmirësim të vazhdueshëm. Rezultatet e përgjithshme në lëndën e Matematikës tregojnë se rreth 36 % e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënësve, të cilat janë matur me instrumentin e vlerësimit në këtë studim.

Në vlerësimet e realizuara në kuadër të studimit janë identifikuar dallime në arritjet e nxënësve sa u përket vendbanimit (fshat-qytet), gjinisë, kushteve shtëpiake për mësim gjatë pandemisë, si dhe dallime në raport me arritjet e nxënësve sipas numrit të anëtarëve në familje dhe numrit të fëmijëve në shkollë. Këto dallime tregojnë për rritjen e pabarazive në mësim, të cilat edhe ashtu kanë qenë të reflektuara në studimet ndërkombëtare, në të cilat ka marrë pjesë Kosova.

Referuar analizës së rezultateve sipas kërkesave/pyetjeve të veçanta në lëndën e Gjuhës shqipe dhe në lëndën e Matematikës, nxënësit kanë arritur rezultate më të larta në kërkesat/pyetjet në të cilat kërkohej përdorim i strategjive të memorizimit, kundrejt kërkesave që kërkonin përdorim të strategjive elaboruese dhe të mendimit kritik.

Rezultatet e vlerësimeve tregojnë se puna e kërkuar për shkollat dhe mësimdhënësit, për zvogëlimin e humbjeve mësimore përmes organizimit të mësimin plotësues, është orientuar vetëm në ofrimin e përmbajtjeve, të cilat mësimdhënësit nuk kanë arritur t'i ofrojnë nga planet e tyre mësimore, e jo të bazuara në çfarë nxënësit në fakt kanë nevojë. Kjo ka ardhur në shprehje në mungesë të ofrimit të udhëzimeve apo orientime të qarta nga MASHTI dhe DKA. Orientimi në punë/mësimdhënie të bazuar në projekte dhe në

tema/përmbajtje të identifikuara nga nxënësit, e të drejtuara/plotësuara nga mësimdhënësit, do të ishte një qasje sadopak e bazuar në nevoja të nxënësve.

Në përgjithësi, organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë, referuar qëndrimeve të respondentëve nga shkollat, mund të konsiderohet i suksesshëm. Vështirësitë e hasura gjatë periudhës së pandemisë, në masë të madhe, janë menaxhuar mirë, mirëpo procesi përshkruhet me sfida dhe shqetësime të shumta, si: mungesa e pajisjeve të TIK-ut dhe kompetencës digjitale të mësimdhënësve, planifikimi mësimor dhe zbatimi i kurrikulës, ndryshimi i qasjes në mësim, ngarkesa emocionale dhe psikologjike e nxënësve, lodhja dhe ngarkesa e mësimdhënësve, performanca e nxënësve etj.

Politikat e planifikuara, lidhur me sigurimin e kushteve për përfundim e dy viteve shkollore në kushtet e pandemisë, ishin në përputhje me masat e rekomandimeve nga mekanizmat ndërkombëtarë dhe IKShPK-ja, në pajtim me situatën dhe përvojat nga vendet e tjera, gjë që mundësuan përfundimin e viteve shkollore. Edhe pse të vonuara në disa raste, me mbështetje të fragmentuar dhe udhëzime të pakta të ofruara për mësimdhënësit, nxënës dhe prindër.

Ky studim ofron rekomandimet për institucionet arsimore, për qëllime të orientimit të politikave arsimore lidhur me ngritjen e sistemit pas pandemisë dhe praktikave institucionale për mbështetjen e nxënësve, për zbutjen në masë të mundshme të humbjeve mësimore, dhe për eliminimin e pabarazive në mësim.

Në radhë të parë, MASHTI duhet të hartojë plan kombëtar për zvogëlimin e humbjeve mësimore të ndikuara nga COVID-19 dhe për eliminimin e pabarazive në mësim, të mbështetur financiarisht, si dhe të zhvillojë një mekanizëm efektiv dhe të përshtatshëm, që t'u ndihmojë shkollave për vlerësimin real të humbjeve mësimore dhe për mbështetje afatgjate të nxënësve për kompensimin e humbjeve mësimore.

Shkollat, me mbështetje nga DKA-të dhe komuniteti i prindërve, duhet të organizojnë aktivitete plotësuese ndërvepruese për nxënësit, mësimdhënie të bazuar në projekte - në tema/përmbajtje të identifikuara nga nxënësit, e të

drejtuar/plotësuar nga mësimdhënësit, aktivitete jashtëkurrikulare, përmes klubeve shkollore, me qëllim të promovimit të të mësuarit ndërveprues, pjesëmarrjes dhe përfshirjes sociale. Aktivitetet dhe projektet mësimore duhet të ofrohen dhe të përshtaten sipas nevojave të nxënësve, veçanërisht për fëmijët nga grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, komunitetet joshumicë dhe atyre në gjendje të vështirë socio-ekonomike.

Mbështetja e fëmijëve nga prindërit, për t'u përballur me të nxënit në kushtet e pandemisë dhe për mësim në shtëpi, duhet të jetë e vazhdueshme, krahas kujdesit për sigurimin e teknologjisë për mësim dhe përdorimin e saj për qëllime mësimore. Në anën tjetër, sistemi arsimor duhet të sigurojë mbështetje për prindërit që kanë burime të kufizuara dhe kanë shumë fëmijë për të mbajtur në shkollë. Ndërsa, shkollat duhet të thellojnë bashkëpunimin e vazhdueshëm me prindër për çështje të mësimin në zvogëlimin e humbjeve mësimore, si dhe për çështje të këshillimit dhe përkrahjes socio-emocionale të fëmijëve.

Për adresimin e të gjitha problemeve të arsimit parauniversitar që lidhen me cilësinë e arsimit, atyre të njohura para pandemisë dhe atyre të shpërfaqura gjatë periudhës së pandemisë, nevojitet planifikim dhe bashkërendim i integruar i veprimeve ndërmjet të gjitha niveleve të institucioneve arsimore në Kosovë, si dhe referime në rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë për ngritjen e sistemeve arsimore pas pandemisë.

Ne vlerësojmë se me këtë qasje të trajtimit të problematikave në sektorin e arsimit, me trajtimin e problemeve aktuale dhe të ndjeshme, publikimin dhe prezantimin e gjetjeve të studimit, synojmë të rrisim nivelin e shqyrtimit dhe diskutimit shkencor me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Gjithashtu, me këtë raport të studimit, synojmë të nxisim debatin lidhur me cilësinë e arsimit parauniversitar, studime të mëtejme, për aspekte të veçanta, për të parë më thellësisht disa nga aspektet që nuk janë mbuluar me këtë studim, si pasojat psiko-sociale të fëmijët, ndikimi në raportet sociale të fëmijët, përparësitë dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjisë nga fëmijët për një kohë më të gjatë pandemisë etj.

## Hyrje

Pandemia COVID-19 në mars të vitit 2020 i detyroi shumë sisteme arsimore të ndërmarrin masa të shpejta, për mbylljen e institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) në të gjitha nivelet e arsimit, me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve. Krahas me mbylljen e IEAA, masat tjera të izolimit dhe distancimit shoqëror, qeveritë–sistemet arsimore kaluan në organizimin e mësimin në distancë, duke shfrytëzuar teknologjinë informative dhe qasjet e tjera për mësimin në distancë, në varësi të kapaciteteve dhe përgatitjeve paraprake të sistemeve për arsim në distancë.

Edhe në Kosovë, më 12 mars 2020, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është ndërprerë mësimi në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare dhe në institucionet e arsimit të lartë (Qeveria e Republikës së Kosovës, 11 mars 2020), me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve. Krahas kësaj, janë ndërmarrë veprime për të kaluar në mësimin në distancë. Bazuar në udhëzimet e hartuara nga MASHTI<sup>1</sup>, mësimi në distancë për klasat 1-9, në periudhën mars-qershor 2020, është realizuar nëpërmjet transmetimit të mësimëve të regjistruara në televizionin publik (RTK), përmes kanalit të MASHTI në ‘YouTube’, si dhe përmes mësimin të organizuar me aplikacione të ndryshme nga mësimdhënësit. Theksi kryesor është dhënë në detyrat e dala nga mësimi përmes televizionit publik dhe informatat kthyesë lidhur me detyrat e nxënësve dhe mbajtja e tyre aktivë në mësim. Ndërsa, mësimi në distancë në nivel të shkollave të mesme të larta (klasat 10-12) është zhvilluar në mënyrë të decentralizuar, në nivel shkolle, dhe mësimdhënësit ishin bartësit kryesorë të mësimin në distancë.

Në të gjitha udhëzimet e zhvilluara nga MASHTI për vazhdimin e mësimin në kushtet e pandemisë dhe përfundimin e vitit shkollor 2019/2020, është potencuar se qëllimet primare të mësimin në distancë ishin mirëqenia e fëmijëve dhe nxitja e të nxënësve. Kjo bëri që të njihet niveli i arritshmërisë së nxënësve deri më 11 mars 2020 dhe e gjithë puna me fëmijë/nxënës të

---

<sup>1</sup> Të gjitha udhëzimet e MASHTI-t janë publikuar në linkun e veçantë të faqes zyrtare të MASHTI-t: <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

fokuset në mirëqenien e nxënësve dhe nxitjen e të nxënësve të tyre për arritshmëri më të lartë në mësim. Masa të tilla ishin vendosur nga shumica e sistemeve arsimore (IPK, 2020). Me këtë qasje është arritur të përfundohet viti shkollor 2019/2020, i cili vlerësohet se i ka përmbushur pritshmëritë bazë, por njëkohësisht, sipas raportit të Bankës Botërore, ky vit është përcjellë me humbje mësimore, thellim të pabarazive në mësim, me tendencë të rritjes me vazhdimin e pandemisë.

Përgatitjet e institucioneve të arsimit në Kosovë për fillimin e vitit të ri shkollor në kushtet e pandemisë, vitit shkollor 2020/2021, janë ashtu siç janë bërë edhe nga sistemet arsimore të rajonit dhe më gjerë, duke planifikuar disa skenarë për organizimin dhe zhvillimin e mësimin, me përparësi rihapjen e shkollave, por në varësi të përhapjes së virusit dhe të specifikave të shkollave edhe mësim në distancë ose të kombinuar. Pra, edhe në Kosovë, organizimi i mësimin për vitin shkollor 2020/2021 filloi sipas tre skenarëve<sup>2</sup>, me qëllim që të ndihmohet ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve, si dhe realizimi i procesit edukativo-arsimor sipas Kornizës së Kurrikulës të Kosovës (MASHTI, 2020/b).

Nisur nga diskutimet dhe studimet në shkallë botërore, pandemia e ka përkeqësuar arsimin ekzistues, ka ndikuar në zvogëlimin e qasjes në mësim, rritjen e pabarazive në mësim, ka ndikuar në të nxënësve social dhe emocional, si dhe ndërveprimin dhe mbështetjen sociale. Pra, nga rrethanat e krijuara pritet që pandemia të ketë ndikim domethënës në performancën e nxënësve, arritjet e nxënësve dhe në krijimin e pabarazive në mësim dhe se ato do të dallojnë varësisht nga mënyrat dhe qasjet se si u janë përgjigjur sistemet arsimore rrethanave të pandemisë.

Nga konteksti i situatës dhe nga nevoja për të përkrahur sistemin arsimor në Kosovë, Instituti Pedagogjik i Kosovës ka ndërmarrë realizimin e këtij studimi, i cili përqendrohet në analizën e masave të institucioneve arsimore

---

<sup>2</sup> Skenarët A, B dhe C:

- **Skenari A:** Niveli i rrezikshmërisë i ulët. Mësimi me prezencë në institucionet parashkollore dhe shkolla - me masat parandaluese;
- **Skenari B:** Niveli i rrezikshmërisë mesatar. Rikthim i pjesshëm - mësim i kombinuar, me prezencë në shkollë dhe mësim në distancë.
- **Skenari C:** Niveli i rrezikshmërisë i lartë. Mësimi në distancë - TV + e-mësimi.

për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, ndikimin e COVID-19 në arsim, në mënyrë të veçantë për ndikimin në humbjet mësimore në shkollimin e detyrueshëm, pasojat dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit në arsimin parauniversitar.

*Studimi Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit* është realizuar në periudhën maj–gusht 2021, me qasje metodologjike të përzier, bazuar në të dhëna sasiore dhe cilësore. Studimi është realizuar me një mostër prej 52 shkollave të arsimit bazë dhe me përfshirje të përfaqësuesve të të gjithë komunitetit të shkollës, përmes pyetësorëve të përdorur për qëllimet e këtij studimi. Studimi ka një përqendrim të veçantë në vlerësimin e arritjeve të nxënësve të klasave të dyta dhe të shtata, pasi që këto klasa të arsimit bazë lidhen me përfundimin e shkallës kurrikulare përkatëse dhe janë klasa të cilat janë ballafaquar me rrethanat e pandemisë nga fillimi i saj.

Me këtë raport të studimit synojmë të pasqyrojmë rezultatet e analizave të bëra për ndikimin e COVID-19 në humbjet mësimore, arritjet e nxënësve në fund të klasës së dytë dhe të shtatë, faktorët ndikues në arritjet e nxënësve, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit. Përmes publikimit të të gjeturave nga ky studim dhe rekomandimeve të dala nga studimi, synojmë t'u kontribuojmë angazhimeve institucionale për vendosje të masave dhe veprimeve efektive në adresimin e problemeve dhe sfidave të shkaktuara nga pandemia dhe për mbështetjen e nxënësve, me qëllim zvogëlimin e humbjeve mësimore, eliminimin e pabarazive në mësim dhe ngritjen e cilësisë së mësimit në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, me këtë raport të studimit synojmë të nxisim debatin lidhur cilësinë e arsimit parauniversitar, mundësitë për të përmirësuar dhe për të avancuar arsimin parauniversitar në nivele të zhvillimit, që të mund t'u përgjigjet në mënyrë efektive kërkesave të shoqërisë, përtej situatave emergjente.

## **2. Konteksti – arsimi parauniversitar në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19**

Pandemia globale, e njohur si COVID-19, që nga fillimi i vitit 2020 ka sfiduar shoqëritë dhe sistemet arsimore, në të gjitha proceset e organizimit të jetës: shëndetësisë, punës, ekonomisë, arsimit etj. Në përgjigje të rrethanave të imponuara nga pandemia globale, në fillim të muajit mars 2020, pjesa më e madhe e sistemeve arsimore nga vendet e rajonit, BE-ja dhe vendet tjera të botës, ndërprejnë mësimin në shkolla dhe në institucione të tjera arsimore. Edhe në Kosovë, më 12 mars 2020, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është ndërprerë mësimi në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare dhe në institucionet e arsimit të lartë.

Në mbështetje të vendimeve të Qeverisë, masave dhe rekomandimeve nga mekanizmat ndërkombëtarë, siç janë Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), UNICEF etj., Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në bazë të udhëzimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit, shkollat, partnerët ndërkombëtarë që mbështesin arsimin në Kosovë, arriti që shumë shpejt, gjatë muajit mars 2020, të fillojë organizimin e mësimin në distancë dhe të organizohet mësimi në kushte pandemie gjatë gjithë vitit shkollor 2020/2021, në të gjitha nivelet e arsimit.

Konteksti dhe përshkrimi i zhvillimit të arsimit parauniversitar në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19 për këtë studim është organizuar në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë pasqyrohen disa nga masat e ndërmarra për vazhdimin e mësimin në kushtet e pandemisë dhe përfundimin e vitit shkollor 2019/2020, ndërsa në pjesën e dytë pasqyrohet një përmbledhje e masave të ndërmarra për realizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021.



## **2.1. Masat e ndërmarra për vazhdimin e mësimin në kushtet e pandemisë dhe përfundimin e vitit shkollor 2019/2020**

Masat e ndërmarra për vazhdimin e mësimin në kushtet e pandemisë dhe përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 janë përshkruar në studimin e Institutit Pedagogjik të Kosovës (2020): *Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19*; në studimin e publikuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (2021): *Ndikimi i pandemisë COVID-19 në arsimin parauniversitar në Kosovë*, si dhe në raporte të MASHTI-t dhe raporte të studimeve tjera, të realizuara nga institucione, organizata dhe partnerë që mbështesin arsimin në Kosovë.

Referuar këtyre raporteve, sistemi i arsimit parauniversitar nuk ishte i përgatitur për një modalitet të tillë të mësimin. Sfidat kryesore ishin: mungesa e kompetencës digjitale të mësimitdhënësve për mësim online, mungesa e teknologjisë, koha e shkurtër për të riorganizuar gjithë procesin mësimor, mungesa e strukturave përkatëse për mësimin në distancë, mungesa e përvojës së MASHTI-t, procedurat e komplikuar për prokurim në MASHTI, mungesa e një platforme të standardizuar për mësim në distancë etj.

Gjithashtu, referuar këtyre raporteve, masat e ndërmarra për këtë periudhë mund t'i përmbledhim si në vijim:

- Qeveria e Republikës së Kosovës në mars të vitit 2020, ashtu si të gjitha vendet e rajonit, BE-ja dhe vendet e tjera të botës, ka reaguar në mënyrë të shpejtë sa i përket marrjes së masave dhe veprimeve në përgjigje të rrethanave të krijuara nga COVID-19.
- Në të gjitha masat e ndërmarra në këtë periudhë, mirëqenia dhe ruajtja e shëndetit ishin primare dhe të orientuara për vazhdimin dhe përfundimin e vitit shkollor (2019/2020) përmes mësimin në distancë, në rrethanat e situatës së mbylljes së plotë të vendit.
- Masat e ndërmarra nga institucionet vendimmarrëse për realizimin e mësimin në arsimin parauniversitar gjatë pandemisë, në fazën e parë të pandemisë, janë të përafërta me ato të rajonit, të cilat lidhen me

nxjerrjen e vendimeve për ngritjen e mekanizmave për menaxhimin e mësimit në distancë, nxjerrjen e udhëzimeve dhe udhëzuesve për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, modalitetet e organizimit të mësimit, zhvillimin e platformave online, si dhe angazhimin e televizioneve publike, si transmetues zyrtarë të mësimit në distancë për arsimin bazë.

- Dokumentet e zhvilluara në periudhën e parë të pandemisë ofrojnë udhëzime për aspektet që mbulojnë realizimin e mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Në dokumentet e zhvilluara nuk ofrohen udhëzime specifike për zbatimin e kurrikulës, përcaktimin e temave kryesore që duhet të realizohen gjatë mësimit në distancë, ose nuk kishte vendim për përqendrim vetëm në kompetencat kryesore. Kjo ka bërë që mësimi në distancë të vazhdojë nga aty ku është ndërprerë mësimi i rregullt në shkollë, për shkak të pandemisë COVID-19.

Viti shkollor 2019/2020, i sfiduar nga pandemia globale COVID-19, me përpjekje maksimale të institucioneve arsimore, prindërve dhe nxënësve, përfundoi me sukses, duke pëmbushur pritshmërinë bazë për këtë vit shkollor. Pavarësisht përpjekjeve dhe angazhimeve për organizimin e mësimit në distancë në kushtet e pandemisë, janë raportuar sfida dhe probleme të shumta për realizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, si nga ana e shkollave ashtu edhe nga ana e prindërve dhe nxënësve.

Ndër sfidat kryesore për mësimin në distancë në periudhën e parë të pandemisë ishin: cilësia e mësimit në distancë, përfshirë cilësinë e video-materialeve dhe qasjeve të mësimdhënies gjatë mësimit në distancë; organizimi dhe mbikëqyrja e mësimit; mungesa e teknologjisë dhe kompetencës digjitale të mësimdhënësit dhe të nxënësit (familjet);



vlerësimi i nxënësve; mungesa e mjediseve të të nxënësve në shtëpi; mospjesëmarrja në mësim e fëmijëve nga grupet me disavantazhe socio-ekonomike dhe ata që jetojnë në zona rurale (IPK, 2020).

Të gjitha këto sfida dhe probleme tregojnë se mbyllja e shkollave në fazën e parë të pandemisë pritet të ndikojnë në cilësinë e arsimit parauniversitar në Kosovë, e cila, referuar rezultateve të nxënësve kosovarë në PISA 2015 dhe PISA 2018, ishte e ulët edhe pa mbylljen e shkollave. Vazhdimi i pandemisë globale do të thellojë edhe më shumë pabarazitë në të nxënit e fëmijëve.


## ***2.2. Masat e ndërmarra për realizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021***

Për dallim prej fazës së parë të reagimit të institucioneve arsimore ndaj pandemisë, në planifikimin dhe përgatitjet për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie – viti shkollor 2020-2021, janë zhvilluar më pak dokumente dhe udhëzues, por brenda tyre janë integruar masa e orientime që mbulojnë aspektet e planifikimit, masat higjienike, orientimet për organizimin e mësimit sipas skenarëve dhe aspektet e monitorimit dhe inspektimit të punës së institucioneve arsimore (Mehmeti, S., 2021).

Dokumentet bazë për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie, për vitin shkollor 2020-2021 (MASHTI, 2020/b), janë përgatitur me pjesëmarrje të të gjithë përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe në koordinim me IKShPK-në. E gjithë korniza e planifikimit dhe përgatitjeve për zhvillimin e mësimit në këto kushte është bërë që mësimi të zhvillohet sipas tre skenarëve të mësimit: A dhe B dhe C, me qëllim që të ndihmohen ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, ruajtja e mirëqenies shëndetësore të qytetarëve, si dhe realizimi i procesit edukativo-arsimor sipas dokumenteve kurrikulare, në kushte të pandemisë COVID-19.

Udhëzuesi i përgjithshëm i MASHTI-t për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021, në kushtet e pandemisë COVID-19, është i mbështetur në Kornizën për rihapjen e institucioneve edukativo-arsimore, të aprovuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (2020) - UNESCO, UNICEF-i, Banka Botërore, WFP, dhe UNHCR-ja.

Udhëzuesi i përgjithshëm i MASHTI-t për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021, në kushtet e pandemisë COVID-19, është organizuar në shtatë kapituj, sipas skenarëve të mësimin.



Në dy kapitujt e parë të udhëzuesit të përgjithshëm ofrohen informacione dhe udhëzime për kornizën e planifikimit (politikat, veprimtaria e sigurt, përgjegjësitë e pjesëmarrësve, themelimin dhe detyrat për task-forcat në MASHTI, DKA dhe në nivel të institucionit parashkollor/shkollës), grupet e marginalizuara, financimi dhe masat e përgjithshme për mbrojtjen nga COVID-19, duke iu referuar skenarëve të mësimin sipas niveleve të rrezikut/situatës, pandemisë dhe masave.

### **Organizimi i mësimin dhe punës së shkollës, sipas skenarëve A, B dhe C.**

Lidhur me organizimin e mësimin, në udhëzuesin e përgjithshëm theksi vendoset në informacione të përgjithshme, sipas niveleve të shkollimit, duke përfshirë orientimet për rikthim në shkollë, në varësi të skenarëve,

prioritetet, numrin maksimal të nxënësve në klasa, orarin mësimor të shkurtuar, mësimin online përmes TV e-mësimin, përdorimin e platformave për e-mësim, kontaktin e rregullt me mësimdhënës, kujdestarë klase, mësues lëndorë etj. Gjithashtu, në këtë përshkrim pasqyrohet propozimi për planifikim mësimor, me reduktimin e përmbajtjeve për 25% për shkollat që punojnë në skenarin A.

Në anën tjetër, referuar udhëzuesit të përgjithshëm, nuk ka orientime dhe propozime për reduktimin e përmbajtjeve për shkollat kur punojnë me skenarin B apo C dhe kjo bën të kuptohet se shkollat, pavarësisht me cilin skenar punojnë, të gjitha angazhimet duhet t'i bëjnë për të arritur 75% të programit mësimor, rezultateve të të nxënësve dhe përmbajtjeve mësimore. Gjithashtu, nuk ka orientime dhe udhëzime se si të veprohet me lëndët tjera, të cilat nuk mbulohen në kuadër të gjimnazeve, si të bëhet angazhimi i mësimdhënësve të këtyre lëndëve etj. Për gjimnaze vetëm sugjerohet që zbatimi i kurrikulës të jetë i kufizuar në lëndët kryesore (Gjuhë, Matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore), varësisht nga tipi i gjimnazit, pa dhënë detaje të tjera.

Është e rëndësishme të theksohet se, sipas udhëzimeve të vendosura për skenarët përkatës të mësimin, mundësohet që organizimi i mësimin të bëhet sipas kushteve epidemiologjike në vend, duke përfshirë edhe kushtet e rihapjes së institucioneve edukativo-arsimore me masa të shtuara për shëndetin publik, kushtet e mbylljes së pjesshme apo kushtet e mbylljes së plotë, për shkak të rrezikshmërisë së shëndetit nga pandemia COVID-19. Kjo ka ndodhur gjatë gjithë vitit shkollor.

**Edukimi parashkollor në kushtet e pandemisë.** Kthimi i fëmijëve në institucionet parashkollore – me aktivitete të edukimit/mësimin në grupe me më së shumti 15-20 fëmijë, në distancë prej së paku 1.5 – 2 m nga njëri-tjetri, është përshkruar si një ndër prioritetet e para në udhëzuesin e përgjithshëm të MASHTI-t. MASHTI, në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë dhe organizatën 'Save the Children', si dhe me përkrahje teknike nga organizata 'Open Data Kosovo', e ka përgatitur platformën "Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme, për moshën 0 – 6 vjeç" <https://edukimihershem.rks->

gov.net/. Platforma u dedikohet fëmijëve të moshës nga 0 deri në 6 vjeç dhe është në përputhje me Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0 – 6 vjeç, si dhe ofron mbështetje për prindërit/kujdestarët ligjorë dhe edukatorët në realizimin e aktiviteteve ditore e javore me fëmijët në kushte shtëpie. Sipas përshkrimeve në platformën për edukimin në fëmijërinë e hershme, përmbajtja e aktiviteteve të prezantuara në këtë platformë stimulon fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore, si: fizike, njohëse, emocionale, matematikore, dhe kreativitetin, në varësi të moshës së tyre.

Referuar statistikave që nga lansimi i platformës (të analizuar me 13.05.2021), platforma është vizituar nga 2,724,122 subjekte, 1,600 edukatorë janë trajnuar për përdorimin e platformës, janë gjeneruar 1,749 raporte digjitale, si dhe janë realizuar 1,075 aktivitete. Ndërsa, referuar raportit për ministren e Arsimit (prill 2021): *Arsimin parauniversitar në kohë pandemie, për periudhën shtator 2020 – prill 2021*, me mbështetjen e UNICEF-it, Bankës Botërore, ‘Save the Children’ dhe Caritasit të Zvicrës, në përgjigje të situatës së krijuar me Covid-19 në fushën e edukimit, gjatë këtij viti, kanë përfituar me paketat didaktike 8,123 fëmijë, kryesisht nga komunitetet dhe familjet me asistencë sociale.

**Arsimi gjithëpërfshirës në kushtet e pandemisë.** Në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, institucionet arsimore sugjerohen që t'u kushtojnë kujdes të veçantë fëmijëve që vijnë nga grupet e marginalizuara: atyre me gjendje të vështirë socio-ekonomike; atyre me nevoja të veçanta; fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian etj., për të cilët kërkohet qasje individuale, në mënyrë që të kenë qasje në arsim dhe të jenë pjesëmarrës aktivë në mësim. Udhëzime shtesë ofrohen në udhëzuesin e veçantë për qasjen dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta, për vitin shkollor 2020-2021, publikuar më 13 gusht 2020<sup>3</sup>.

Në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës, MASHTI, me mbështetjen e organizatës ‘Save the Children’, ka zhvilluar platformën “Arsimi

---

<sup>3</sup> Më gjerësisht shih: <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

gjithëpërfshirës”, me qëllim të ofrimit të mundësive për zhvillim socio-emocional dhe njohës së fëmijëve me nevoja të veçanta. Platforma ofron aktivitete mësimore për fëmijë dhe materiale ndihmëse për prindër/kujdestarë ligjorë, mësimdhënës dhe asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta<sup>4</sup>.

Lidhur me arsimin gjithëpërfshirës, në raportin për ministren e Arsimit (prill 2021): *Arsimi parauniversitar në kohë pandemie, për periudhën shtator 2020 – prill 2021*, theksohet se janë arritur zhvillime që lidhen me trajnimin e ekipeve vlerësuese komunale (180 anëtarë të ekipeve komunale janë përfshirë në trajnimin treditor, angazhimin e 35 asistentëve, pajisjen e nxënësve me nevoja të veçanta mjete teknologjike - tablete (janë pajisur me tablete 958 nxënës, me përkrahje nga UNICEF dhe ‘Save the Children’), makina shkrimi në brail 5 copë, laptopë 8, monitorë zmadhues 4, llupë zmadhuese për tavoline 8 copë, syze për caktimin e dioptrisë së syve 1 palë, shkop i bardhë për të verbër 1 etj.

**Zbatimi i kurrikulës në kushtet e pandemisë** përshkruhet shkurtimisht në udhëzuesin e përgjithshëm. Në rreth tetë faqe janë dhënë udhëzime dhe orientime të përgjithshme, të cilat, kryesisht, ndërlidhen me qëllimet e arsimit parauniversitar të Kosovës, kompetencat që parashihen me Kornizën kurrikulare, parimet e kurrikulës, si dhe me udhëzuesit didaktikë-metodikë për mësimdhënës, të hartuar nga UNICEF-i.

Gjithashtu, në kapitullin që përshkruhet zbatimi i kurrikulës në kushtet e pandemisë theksohet se grupi i kurrikulës në MASHTI do të përcaktojë një version më të përmbledhur të RNF dhe RNL për mësimin në kushtet e pandemisë, përfshirë edhe mësimin në distancë. Përveç planeve mësimore, të hartuara nga grupet profesionale të mësimdhënësve të Komunës së Prishtinës për klasat 1-9, të cilat janë shpërndarë në forma të ndryshme në gjithë Kosovën, nuk është arritur të sigurohet ndonjë dokument/udhëzues nga grupi i kurrikulës në MASHTI, i cili përmbledh RNF dhe RNL për mësimin në kushtet e pandemisë.

---

<sup>4</sup> Më gjerësisht, shih: <http://arsimigjithepershires.rks-gov.net/>

Udhëzuesi i përgjithshëm parasheh që arritja e kompetencave dhe rezultateve të të nxëniet të fushës (RNF) dhe të lëndëve të caktuara (RNL) është e mundur të bëhet edhe me numër të reduktuar të njësive mësimore (deri në 80%), sipas një plani mësimor të organizuar mirë dhe me qasjen e mësimit të integruar. Mirëpo, nuk ofrohen udhëzime specifike se si duhet të bëhet kjo, cilat tema duhet të hiqen nga 20 përqindëshi i reduktimit të përmbajtjeve programore, kush duhet ta bëjë dhe kur, si të merren për bazë zhvillimet e vitit shkollor paraprak në raport me realizimin e kurrikulave në këtë vit etj.

Në raportin për Ministrinë e Arsimit (prill 2021): *Zhvillimet në arsimin parauniversitar në kohë pandemie, për periudhën shtator 2020 – prill 2021*, lidhur me zhvillimet në zbatimin e kurrikulës, pasqyrohen vetëm dy aspekte të arritjeve për këtë periudhë: (i) përqindja e planifikimit të përmbajtjeve kurrikulare (planifikimi i përmbajtjes programore për t'u realizuar për klasat 1-9 është paraparë të jetë 75%, pra është i reduktuar për 25%) dhe (ii) puna e bërë për formimin e komisionit profesional për menaxhimin e procesit të dorëshkrimeve të teksteve shkollore për klasat 3, 8 dhe 12.

**Trajnimi i mësimeve referohet në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë.** Në udhëzuesin e përgjithshëm janë vendosur disa veprime më urgjente, të cilat duhet të ndërmerren lidhur me trajnimet obliguese për mësimin online, si: Koordinimi i DKA-ve lidhur me kërkesat dhe nevojat e trajnimeve për mësimeve; Trajnimi i mësimeve për përdorimin e platformës mësimore nga ofruesi i platformës ose organizatë profesionale; Trajnimi i mësimeve për metodologji të mësimit online dhe punë eksperimentale; Ofrimi i trajnimit të mësimeve për mjete të TIK-ut; Ofrimi i këshillimit DKA-ve, mësimeve dhe prindërve, për përdorimin e mjeteve të TIK-ut; Trajnime për metodat e mësimit online dhe të kombinuar.

Sipas përshkrimeve në udhëzuesin e përgjithshëm, lidhur me trajnimin e mësimeve, pjesa më e madhe e trajnimeve të propozuara ka mbetur të konfirmohen nga partnerët mbështetës, përfshirë edhe kohën e realizimit të tyre. Përveç trajnimeve për mësimin online, në udhëzues theksohet se do të organizohen edhe trajnime të tjera, mirëpo pa detaje.



Referuar raportit të Departamentit të Arsimit Parauniversitar për Ministrinë e Arsimit (prill 2021), gjatë këtij viti janë realizuar disa programe të trajnimit dhe forma të tjera të zhvillimit profesional nga MASHTI, partnerët mbështetës dhe OJQ-të që ofrojnë trajnime (British Council, IPK, KEC), janë mbajtur ligjërata vetëdijesuese me rreth 1000 mësime për shëndetin mendor të organizuara nga MASHTI në bashkëpunim me IKShPK-së, me mbështetje të OBSH-së, ndërsa ligjërues kanë qenë dy psikologë shkollorë nga Departamenti i Psikologjisë. Materialet janë në faqen zyrtare të MASHTI-t. Mirëpo, në këtë raport nuk theksohet se janë realizuar trajnimet/modulet e propozuara me Udhëzuesin e përgjithshëm, apo cilat prej tyre janë realizuar deri në prill të vitit 2021, si dhe nuk përfshihen trajnimet që janë realizuar gjatë pandemisë gjatë këtij viti shkollor (2020-2021), si nga GIZ, “Save the Children”, “Caritasi Zviceran” dhe IPK.

**Vlerësimi i nxënësve** - Në udhëzuesin e përgjithshëm të MASHTI-t për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19, pasi që ato janë detajuar më shumë në Udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve, në vitin shkollor 2020-2021, në kushtet e pandemisë, të publikuar në faqen zyrtare të MASHTI-t (platformën e-mësimi), më 24 tetor 2020 (MASHTI, 2020/d).

Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve është organizuar në gjashtë kapituj, duke përfshirë udhëzimet për: Parimet e vlerësimin të nxënësve, në kushtet e pandemisë; Vlerësimin e nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës dhe skenarëve të organizimit të vitit shkollor 2020-2021, në kushtet e pandemisë; Metodatat e vlerësimin të nxënësve në kushtet e pandemisë; Format e vlerësimin të nxënësve në kushtet e pandemisë; Modalitetet e vlerësimin në raste specifike; Rolet dhe përgjegjësitë në vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë. Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë nuk ka përqendrim në udhëzime më konkrete, të shkurtra dhe të ilustruara me shembuj për situata konkrete që lidhen me vlerësimin e nxënësve në këto kushte, siç është për shembull identifikimi i humbjeve mësimore përmes qasjeve të mënyrave të vlerësimin (Mehmeti, S., 2021).

Gjatë këtij viti, krahas dy vlerësimeve kombëtare (Testi i klasës së 9-të dhe Provimi i Maturës) nga Divizioni për Standarde dhe Vlerësime, janë realizuar edhe pilotimet për testet ndërkombëtare PISA 2022 dhe PIRLS 2021.

### **Digjitalizimi i mësimit në shkolla - platformat, përgatitja dhe zbatimi i mësimit online.**

Në Kosovë, sipas Kantar (2019), penetrimi i internetit është vazhdimisht në rritje. Rreth 97% e popullatës kanë qasje në telefoni mobile, 37% kanë Smart TV, 30% tablet, 39% kanë kompjuter dhe 48% kanë laptop.



Në Kosovë, teknologjia në shumicën e rasteve, përdoret për komunikim dhe media sociale, duke treguar një përdorim të ulët për qëllime arsimore (Qirezi, 2020).

Në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit, në vitin shkollor 2020-2021, janë përshkruar disa aspekte të përgjithshme lidhur me këtë fushë, informacione dhe orientime që priten të zhvillohen. Mirëpo, mungojnë udhëzimet dhe orientimet lidhur me veprimet afatshkurta, për të siguruar një platformë bazike në nivel shkollë, e cila lehtëson punën e shkollës gjatë mësimit në kushtet e pandemisë, mundëson vendosjen e materialeve mësimore digjitale që zhvillohen në nivel të aktiveve profesionale, eliminon përdorimin e aplikacioneve të ndryshme për mësim online nga mësimdhënësit e shkollës së njëjtë, apo të një klasë të njëjtë, e cila raportohet të jetë mjaft sfiduese për nxënës (Mehmeti, S., 2021). Kjo ka bërë që mësimi sipas skenarit C, mësimi online, të zhvillohet me dallime të mëdha nga shkolla në shkollë, nga komuna në komunë, varësisht nga sigurimi i platformave për mësim, siç ishte platforma E-shkollori në Prishtinë dhe në Malishevë.

Gjatë këtij viti është draftuar Strategjia e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026. Dokumenti përshkruan gjendjen aktuale dhe vendos masat dhe veprimet në katër fusha të intervenimit: (i) Të dhënat digjitale; (ii) Materialet mësimore digjitale; (iii) Shërbimet dhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK); dhe (iv) Kompetencat digjitale.

Sa i përket digjitalizimit të materialeve mësimore për nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar në Kosovë, në analizën e gjendjes paraprake për Strategjinë e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026<sup>5</sup> (Thaçi, J., 2020), theksohet se në aspektin institucional nuk është bërë ende asgjë, meqë në Kosovë ende nuk ekzistojnë materiale mësimore digjitale, të zhvilluara në mënyrë institucionale, në përputhje me kurrikulat shtetërore, me programet lëndore e me planet mësimore, të cilat kanë kaluar nëpër filtrat përkatës të kontrollit dhe të jenë miratuar nga MASHTI për përdorim nga institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Sipas raportit të njëjtë, të vetmet materiale mësimore të tilla janë ato që janë prodhuar gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 (duke filluar nga muaji mars 2020 e deri më sot), me qëllim të ofrimit të mësimin në distancë për fëmijë/nxënës të niveleve dhe kategorive të ndryshme të arsimit parauniversitar. Situata e njëjtë u reflektua edhe më 14 shtator 2020, kur filloi viti i ri shkollor 2020-2021.

Nuk duhet harruar angazhimin e MASHTI-t dhe DKA-së në Prishtinë për planifikimin dhe incizimin e njësive mësimore të udhëhequra nga mësimdhënësit dhe të publikuara në platformën e-mësimi, në RTK dhe në 'YouTube'. Ishte angazhim i madh dhe të paktën arritën të ofrojnë diçka përmbajtjesore dhe elementare për të lehtësuar punën e mësimdhënësve dhe nxënësve. Cilësia dhe mënyra e përdorimit të këtyre përmbajtjeve të publikuara është analizuar më herët dhe mund të diskutohet edhe më tutje.

Në anën tjetër, sa u përket shërbimeve dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), sipas raportit për analizën e gjendjes paraprake për Strategjinë e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026,

---

<sup>5</sup> Dokumenti është hartuar nga Instituti ATOMI, në kuadër të projektit "Mbështetje për hartimin e një strategjie të mirë-planifikuar për digjitalizimin e sistemit të arsimit në Kosovë", i cili realizohet me fonde të Ministrisë Britanike për Punë të Jashtme dhe Zhvillim përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë dhe i cili zbatohet nga Instituti ATOMI.

qasje në internet dhe pajisja me mjete të TIK-ut në shkollat publike në Kosovë del të jetë në gjendje shumë të keqe. Në 125 shkolla publike të Kosovës nuk kanë qasje në internet (jo për shkak të pamundësisë teknike për qasje në internet, por për shkak të koston mujore të internetit).

**Monitorimi dhe inspektimi në arsimin parauniversitar.** Sipas udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, Inspektorati për monitorimin dhe inspektimin e arsimit parauniversitar ka prioritet mbikëqyrjen e shkollave dhe metodave të mësimdhënies, se sa e respektojnë protokollin për siguri dhe shëndet dhe mirëqenien e fëmijëve.

Kjo tregon se fokusi kryesor i monitorimit dhe inspektimit në arsimin parauniversitar në kohë pandemie vihet tek aspektet e mirëqenies, aspektet higjienike, logjistike dhe organizative të shkollave, jo në përmbajtjen e procesit mësimor, qasjet në mësimdhënie dhe cilësinë e mësimit në kushtet e pandemisë. Disa nga aspektet përmbajtjesore të monitorimit mbulohen në udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve, përkatësisht në pjesën e këtij udhëzuesi për monitorimin dhe raportimin lidhur me vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë, por ato nuk janë të mjaftueshme për monitorimin gjithëpërfshirës të organizimit të mësimit dhe cilësisë së tij në këto kushte (Mehmeti, 2021).

### **3. Humbjet mësimore gjatë pandemisë, studimet dhe trajtimi i tyre nga studiues të vendeve të ndryshme**

Secila formë e çrregullimit të rrjedhës normale të proceseve që zhvillohen në sistemin arsimor të një vendi lë pasoja në realizimin e programeve mësimore, në arritjet e nxënësve, në performancën e përgjithshme të institucionit arsimor, por edhe efekte të tjera sociale, psiko-pedagogjike dhe ekonomike. Pandemia e shkaktuar nga epidemia me COVID-19 ka prekur të gjitha sferat e jetës, në botë dhe te ne. Meqenëse arsimi është pjesa më vitale e një shoqërie, pas shëndetësisë, ishte sektori më i prekur nga pandemia. Pasi që në sistemin arsimor përfshihen fëmijët e të gjitha moshave, por edhe të rriturit, ndërmarrja e masave, siç ishte ndërprerja e procesit mësimor në shkollë për një kohë të gjatë, organizimi i procesit mësimor në distancë zuri sistemin të papërgatitur për format alternative të punës.

Përveç kësaj, mjedisi shkollor te ne kishte edhe mangësi të tjera, të cilat ndikuan keq në procesin mësimor, por edhe në aspektin akademik të përbushjes së detyrimeve pedagogjike ndaj nxënësve. Ndër mangësitë kryesore mund të numërohen: niveli i pamjaftueshëm i përgatitjes së infrastrukturës shkollore dhe familjare për shfrytëzimin e teknologjisë për qëllime të mësimdhënies; niveli i pamjaftueshëm i përgatitjes së mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë si mjet i mësimdhënies; nivel i pamjaftueshëm i përgatitjes së prindërve, si në aspektin e përdorimit ashtu edhe në sigurimin e pajisjeve adekuate për nxënie të papenguar nga ana e nxënësve; nivel i pamjaftueshëm i kulturës së përdorimit të teknologjisë dhe internetit për qëllime mësimore, si qasja në burime dhe shfrytëzimi i tyre, përgatitja e materialeve mësimore për nxënës etj.

Sfida të ngjashme kishte edhe në vendet e tjera, por të cilat kishin një traditë më të pasur në përdorimin e teknologjisë, sigurimin institucional të burimeve dhe të materialeve mësimore, por edhe platformave të veçanta mësimore për nxënës dhe për prindër e mësimdhënës.

Në këtë kapitull do të përfshihen konceptet kryesore të konceptit ‘humbje mësimore’, si dhe qasjet e ndryshme nga autorë të ndryshëm, si ndaj dukurisë së humbjeve mësimore, ashtu edhe në sfidat me të cilat janë ballafaquar vendet e ndryshme në organizimin e mësimimit në kohë pandemie. Por, përveç trajtimeve dhe sfidave, do të shihen edhe mësimet që dalin nga sfida të tilla, sugjerimet nga autorë dhe sisteme arsimore, por edhe

parashikimet për zgjidhjet në nivel sistemesh për humbjet që janë shkaktuar, sidomos për nivelin akademik të nxënësve dhe të sistemeve arsimore.

### **3.1. *Konceptimi i humbjes mësimore***

Gjatë periudhës së pandemisë, por edhe pas saj, janë zhvilluar një varg analizash, trajtesash, simpoziumesh e konferencash, lidhur me pasojat e çrregullimit të procesit normal të mësimimit në shkollë. Ndër këto studime është edhe studimi i Institutit Pedagogjik të Kosovës, hulumtuesit e të cilit qysh gjatë periudhës së parë të ndërprerjes së procesit mësimor në shkollë (prill-maj 2020) zhvilluan një hulumtim gjithëpërfshirës me nxënës, mësimdhënës, prindër si dhe zyrtarë e njohës të arsimit. Rezultatet kanë ndriçuar një varg sfidash, problemesh, mangësish, në sistem, por edhe rezultatesh, siç ishte mobilizimi i shpejtë institucional për t'u dalë në ndihmë fëmijëve, prindërve dhe mësimdhënësve (IPK, 2020).

Në shumicën e trajtesave të shfletuara për këtë rast, humbjet mësimore konceptohen si ndryshimi midis asaj që është planifikuar për t'u realizuar dhe asaj që është realizuar. Ky konceptim, përvijim, i përket më shumë aspektit statistikor të humbjeve, sesa aspektit akademik dhe psiko-pedagogjik. Aspekti i parë, ai statistikor, është më lehtë i matshëm, por edhe për ta kompensuar në raport me humbjet në aspektin psiko-pedagogjik. Sa i përket mosprezencës në shkollë, humbjeve të orëve të mësimimit, kjo ishte horizontale, duke përfshirë gjithë sistemin, ndërsa sa i përket organizimit të mësimimeve bazuar në skenarët e MASHT, A B C, si dhe vendimit të MASHT për organizimin e mësimimit plotësues (MASHTI, 2021), ka shumë pikëpyetje. Raportimet tregojnë se pjesëmarrja e nxënësve në mësimin në distancë ishte e kënaqshme, por mbesin si raporte statistikore, pa u ditur pjesëmarrja reale. Gjithashtu, nëse krahasohen raportet e suksesit të nxënësve në vlerësimet e jashtme, Testi i Arritshmërisë dhe Testi i Maturës Shtetërore në Kosovë, nuk vërehen dallime domethënëse me rezultatet e viteve paraprahe. Nëse këto vlerësime janë reale për gjendjen akademike të nxënësve, atëherë shtrohet pyetja kishte apo jo humbje mësimore?

Koncepti humbje mësimore është më i gjerë sesa humbjet për shkak të epidemisë së gripit, siç ishte rasti i fundit. Sipas “Dictionary of Education

Reform” (2013), me konceptin humbje mësimore nënkuptohen humbjet e njohurive dhe shkathtësive, apo ngecjet e nxënësve në progresin akademik, që mund të jenë si rezultat i ndërprerjes së mësimit për arsye të ndryshme, përfshirë: pushimet verore, braktisjen e përkohshme të shkollimit, mungesat e shumta, si dhe mësimdhënien joefektive.

Meqenëse ndërprerja e mësimit dhe humbjet mësimore ishin të papritura, ky përkufizim i konceptit humbje mësimore mund të përfshijë shumicën e elementeve të dhëna në përkufizim.

Duke u bazuar në raportet e Bankës Botërore, si dhe të OBSH-së, pothuajse të gjitha vendet kanë punuar duke u bazuar në skenarët e aprovuar, A, B, C. Qasja ndaj skenarëve është bërë në koherencë me faktorët kontekstualë të vendeve.

### **3.2. Pasojat nga humbjet mësimore**

Ende nuk dihen pasojat e sakta dhe humbjet nga ndikimi i pandemisë në përgatitjen akademike të nxënësve. Pasojat më të rënda do të shfaqen sidomos te vendet me varfëri dhe tek ato në zhvillim, siç është Kosova. Bazuar në shkrimet e bëra për të gjitha çështjet e organizimit të mësimit gjatë pandemisë, pasojave, humbjeve dhe praktikave të mira, vërehet se afërsisht të ngjashme ishin problemet e shkaktuara, sidomos për nxënësit. Siç shprehet me të drejtë Deschaine (2021), me pak njoftim prindërit po futeshin në rolin e edukatorit, instruktorit, këshilltarit, trajnerit të teknologjisë dhe vlerësuesit të programit. Përgjegjësitë mësimore u hodhën në mënyrë reaktive mbi ta, me pak diskutime lidhur me gatishmërinë, aftësinë ose mundësinë për të ofruar këtë nivel shërbimi (Deschaine, 2021).

Nga një studim i bërë në Holandë, dalin të dhëna domethënëse sa u takon humbjeve mësimore. Engzell, Frey and & Verhagen (2021), në studimin e tyre pas mbylljes së shkollave, e shohin si sfiduese çështjen e matjes dhe të vlerësimit të humbjeve mësimore. Të dhënat mbi humbjen e të mësuarit gjatë pandemisë kanë qenë të ngadalta për t'u shfaqur, ndryshe nga sektorët shoqërorë, sistemet shkollore zakonisht nuk postojnë të dhëna në intervale me frekuencë të lartë. Shkollat dhe mësuesit janë përpjekur të miratojnë zgjidhje për mësimdhënie në internet, e lëre më për vlerësim dhe llogaridhënie (Engzell, Frey and & Verhagen, 2021, p.1). Afërsisht njëjtë ka

ndodhur edhe te ne, raportimi për humbjet është bërë zakonisht për fondin e orëve, ditëve të punës, dhe zakonisht është mbështetur në kërkesat e ardhura nga lart, institucionet vendimmarrëse. Analiza e humbjes mësimore në Holandë u mbështet në disa variabla, siç është niveli arsimor dhe social i familjes dhe krahasimi me rezultatet në tri vitet e fundit. Sipas rezultateve të tyre, shihet se humbjet gjatë pandemisë kanë qenë për 3.16% në krahasim me vitet paraprake (shih, Engzell, Frey and & Verhagen, 2021, p.2). Te nëngrupet e nxënësve, te humbjet mësimore, ose rezultatit më të ulët, 40% prej tyre kanë qenë fëmijë të familjeve me nivel të ulët shkollimi, që në përbërje të mostrës ishin rreth 8%. Duke u bazuar në analizat e suksesit në testin e Gjuhës dhe të Matematikës, sasia e humbjes mësimore në studimin e përmendur ishte e barabartë me javët e mbylljes së shkollës (Engzell, Frey and & Verhagen, 2021).

### ***3.3. Përvojat e mira nga mobilizimi***

Nga ngjarjet e tilla, siç ishte Covid-19, qoftë me karakter rajonal ose global, mund të nxirren mësim të mira për të ardhmen. Humbjet e shkaktuara nga ndërprerja e mësimave në shkollë vështirë mund të përmbushen me format në largësi, me emisione mësimore televizive, ose çfarëdo përkrahjeje tjetër, pa prezencën e nxënësve në klasë. Këto humbje janë adresuar në pjesën këtij hulumtimi, por edhe në hulumtimet e raportet e shqyrtuara.

Si anë të mira mund të konsiderohen disa momente, të cilat në kushtet normale nuk do të shënoheshin, si p.sh. mobilizimi i përgjithshëm institucional për ta adaptuar sistemin e rregullt në atë emergjent. Mobilizimi i prindërve për të krijuar kushte mësimore në shtëpi për fëmijët, si pajisje, internet, apo edhe materiale shtesë; ndërgjegjësim i prindërve për rolin, por edhe për sfidat e shkollës në edukimin e fëmijëve, ballafaqimi me vështirësitë “në rolin e mësuesit”; shfrytëzimi i teknologjisë edhe për mësimdhënie dhe për nxënie; ndërgjegjësimi i përgjithshëm mbi rolin e teknologjisë; ndërgjegjësimi i përgjithshëm se kompetenca të nxënësve për punë dhe jetë, etj. Kështu, për shembull, institucionet vendimmarrëse dhe profesionale, përveç udhëzimeve për siguri ndaj virusit, përgatitën dhe



dërguan te mësuesit edhe një varg udhëzimesh për qasje ndaj situatës së re. Sipas një raporti të KE (2020), “shkollave u janë dërguar rekomandime, sipas gjykimit të mësuesve, që orët e mësimit të alternohen me mësimin e njohurive të reja dhe të shfrytëzohen më mirë mundësitë e të nxënimit të bazuar në projekte” (EU, 2020, p. 31). Të nxënimit me projekte, promovimi i punës së pavarur, vetëvlerësimi dhe krijimi i rrjeteve të të nxënimit mes nxënësve, përmbushën në masë të mirë humbjet mësimore. Sipas të njëjtit raport, thuhet të gjitha vendet, sipas kontekstit, kanë organizuar forma dhe mjete të mundshme për të mos e shkëputur procesin e të nxënimit.

Një mobilizim i këtillë ndodh edhe në Kosovë. Edhe pse me pengesa e shkëputje në disa hallka të sistemit, megjithatë u vërejt një mobilizim i gjerë. Këtë e dëshmon studimi i Morina, Uka & Raza (2021), pasi gjetjet treguan se, përveç sfidave dhe këtyre besimeve, mësuesit zhvilluan një qëndrim pozitiv ndaj integritetit të teknologjive dhe komponentit online në klasat e tyre (Morina, Uka & Raza, 2021).

Sa u përket anëve të mira, ose nga të cilat rrethana ka përfituar edhe mësuesi kosovar, është konstatuar edhe nga hulumtimi paraprak i IPK (2020) dhe studimi i KEC (2021), ku shihet një ndërgjegjësim i gjerë i komunitetit të mësuesve dhe prindërve për rëndësinë e teknologjisë në mësuesi dhe nxënie. Gjithashtu, vlen të theksohet konstatimi i autorëve Morina et al. (2021) se ndikimi i kësaj situatë i ofroi një mundësi edhe Kosovës për të eksploruar rrugët e edukimit në distancë si pjesë e ndryshimit që po ndodh (Morina, Uka & Raza, 2021).

Studimet tregojnë se ndikimet e ndërprerjeve në mësim janë ende të panjohura. Kështu, sipas Mehmeti (2021), në nivel të institucioneve arsimore në Kosovë akoma nuk është bërë ndonjë studim i veçantë, i cili do të ishte si një pikënisje për të parë nivelin e humbjeve mësimore, ndërmarrjen e masave për evitimin e pasojave dhe përkrahjen e nxënësve në kompensimin e humbjeve mësimore. Në raport me skenarët e mësimit, me të cilët kanë punuar shkollat, pritet të reflektohen edhe nivelet dhe shkallët e humbjeve mësimore.

Sipas Gurr (2021), te nxënësit parashikohet të jetë i dëmshëm, ndërsa mësuesit kanë raportuar rritje të ngarkesës dhe intensifikimit të punës, pasiguri të dobët në punë dhe shqetësim për aftësinë e tyre për të përballuar dhe për të ofruar mësim dhe kujdes cilësor për nxënësit e tyre (Gurr, 2021). Autori ka bërë analizën e mbi 50 artikujve nga vende të ndryshme, duke konstatuar se dëmet dhe sfidat nga pandemia më tepër janë reflektuar në vendet e varfra, në të cilat edhe aspekti i mirëqenies dhe infrastrukturës janë nën nivel të kërkesave të organizimit të mësimit në distancë. Disa nga këto elemente i kemi konstatuar edhe me këtë hulumtim, të emërtuara si mangësi.

**Në disa vende**, si në Shqipëri për shembull, zbatimi i mësimit në distancë kishte telashe ligjore, pasi që asnjë normativë nuk e kishte paraparë një mësimdhënie të tillë. Sipas Erlis Çela (2021), kjo dallon nga vendet e tjera, në Shqipëri është paraparë vetëm për fëmijët e familjeve të ngujuara, mësimi në distancë paraqet një problematikë që duhet të adresohet (Çela, 2021). Në vendet tjera nuk e kanë pasur këtë zbraçësi ligjore, pasi që format e tilla kanë qenë të përligjura. E njëjta gjë është edhe në arsimin kosovar, por edhe qasja në internet është shumë e lartë nga familjet, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, ndërsa shtrirja e rrjetit të internetit në shkolla është e ulët. Gjithashtu, sa i përket përdorimit të aplikacioneve dhe platformave në mësimdhënie, ka ngjashmëri ndërmjet mësimdhënësve të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë. Sipas Çela (2021), mësimdhënësit shqiptarë gjatë mësimit në distancë kryesisht i kanë përdorur aplikacionet Viber, Watsap dhe Facebook (Çela, 2021) dhe ngjashëm kanë vepruar edhe mësimdhënësit në Kosovë. Sipas Bankës Botërore (2020), ‘asnjë vend nuk ka kurrikulë digjitale universale për mësimdhënien dhe nxënien në këtë mënyrë’ (Tonković et al 2020). Sipas këtyre autorëve, në Kroaci, por edhe në mbarë botën, pandemia ka shkaktuar afërsisht telashe të njëjta. Edhe vendet me traditë në përdorimin e teknologjisë i zuri të papërgatitur në adaptimin e teknologjisë dhe të pajisjeve teknologjike për mësimdhënie dhe nxënie. Prandaj, përveç investimeve në teknologji dhe inovacion, vëmendje e shtuar duhet t’i kushtohet krijimit të rrjeteve të të nxënësve, si mënyrë e pakapërcyeshme në situatën aktuale globale të pandemisë (Tonković, Pongračić & Vrsalović 2020). Kjo duhet t’u shërbejë të gjitha vendeve dhe sistemeve arsimore si një mësim për të reaguar në situata të ngjashme, pasi që edhe pas kalimit të

kësaj gjendjeje mund të ndodhin ndryshime të vazhdueshme në sistemin e arsimit, si rrjedhojë e kësaj përvoje globale (Tonković, Pongračić & Vrsalović (2020).

Shqyrtimi i burimeve të ndryshme lidhur me ndikimin e pandemisë në humbjet mësimore tregon se shumica e vendeve, në rajon dhe më gjerë, janë përballur dhe sfiduar me çështje afërsisht të njëjta. Situata e papritur, pengesat teknologjike, mungesa e traditës për përdorim të teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, shkëputja nga kolegët/et, dominimi i sektorit privat në furnizim me pajisje teknologjike, ndikimi më i theksuar në humbjet mësimore të nxënësit e familjeve me gjendje ekonomike jo të mirë, si dhe të fëmijët në nevojë, ishin pothuajse sfiduese për të gjitha vendet e rajonit. Kosova, sikurse edhe vendet tjera në rajon, ka qasje të lartë në internet, por kjo ishte më e lartë në familje sesa në institucionet arsimore. Sidomos në vendet e rajonit kryesisht janë përdorur aplikacione si Viber, Messenger dhe Fcb për komunikim me nxënësit, në vend të platformave të njohura për mësimdhënie. Me kohë, disa janë përmirësuar dhe avancuar, duke shfrytëzuar platformat si Zoom, Google Meet etj.

Me gjithë mobilizimin e të gjithë aktorëve, humbjet mësimore janë të pashmangshme. Shkalla dhe sasia e humbjeve ndryshojnë nga rajoni në rajon, por edhe brenda vetë rajonit. Një gjë e këtillë vërehet edhe në Kosovë, pasi dallimet në humbjet mësimore janë të dukshme në relacionin fshat-qytet, por edhe ndër komuna.

## 4. Qëllimi i studimit

Studimi ka për qëllim të analizojë ndikimin e COVID-19 në arsimin parauniversitar, ndikimin në humbjet mësimore dhe në thellimin e pabarazive në mësim. Studimi do t'u kontribuojë sqarimit të arritjeve dhe humbjeve mësimore, sfidave kryesore me të cilat janë përballur nxënësit, mësimdhënësit dhe institucionet arsimore parauniversitare në realizimin e mësimimit në këto rrethana. Ka për qëllim të ofrojë rekomandime për mundësitë që duhen shfrytëzuar për vazhdimin e mësimimit në këto rrethana, zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe ngritjen e cilësisë së mësimimit në arsimin parauniversitar.

### Objektivat e studimit

- Analizë e ndikimit të COVID-19 në humbjet mësimore në arsimin parauniversitar, me fokus të veçantë në klasat e dyta dhe të shtata;
- Analizë e qëndrimeve të subjekteve nga shkollat për organizimin e mësimimit në kushtet e pandemisë dhe efektivitetin e mësimimit në këto kushte;
- Analizë e kuadrit të masave të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimimit në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID-19;
- Identifikimi i zgjidhjeve të mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim.

### Pyetjet që udhëheqin studimin

- Cila është masa e humbjes së përgjithshme mësimore të nxënësve në arsimin parauniversitar?
- Cilat janë efektet e COVID-19 në arritjet e nxënësve në klasat e dyta dhe të shtata, krahasuar me kohën e qëndrimit në shkollë gjatë mësimimit - skenarët e mësimimit, vendndodhjen e shkollave (urbane dhe rurale),

numrin e nxënësve në klasa, moshën e mësimit dhe me të dhënat për karakteristikat socio-ekonomike të nxënësve?

- Cili është qëndrimi i subjekteve nga shkollat për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë dhe efektivitetin e mësimit në këto kushte?
- Sa janë treguar relevante masat e ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë COVID-19, krahasuar me arritjet e nxënësve?
- Cilat janë zgjidhjet e mundshme, afatshkurtra dhe afatmesme, për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim?

## 5. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Studimi është realizuar përmes qasjes hulumtuese të përzier, e cila përfshin zbatimin e metodave sasiore dhe cilësore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të nevojshme, për të marrë përgjigje në pyetjet kërkimore të këtij studimi.

Objekt studimi ishin humbjet mësimore të shkaktuara nga pandemia COVID-19, gjegjësisht arritjet e nxënësve gjatë mësimit në kushtet e pandemisë. Në ndërlidhje me objektin e studimit, trajtohen përgatitjet e institucioneve arsimore dhe organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë, përkrahja e mësimit gjatë pandemisë, planifikimi mësimor dhe zbatimi i kurrikulës gjatë pandemisë, mësimi online, si dhe angazhimi i nxënësve në mësim.

*Popullata dhe mostra.* Popullata e këtij studimi përbëhet nga drejtorë të shkollave të arsimit bazë, nxënës të klasës së 2-të dhe klasës së 7-të, mësimit gjatë pandemisë që japin mësim në këto klasa, si dhe prindër të nxënësve të këtyre klasave. Në raport me popullatën nga shkollat, numri i shkollave të përfshira në këtë studim është 52 shkolla publike të arsimit bazë, nga 15 komuna të Kosovës. Mostra e shkollave është përzgjedhur në bashkëpunim me DKA-të, sipas kritereve të vendosura nga ekipi hulumtues i IPK-së.

Kriteret e mostrës së shkollave ishin numri i nxënësve në shkolla dhe vendndodhja e shkollës (fshat – qytet). Numri i shkollave në nivel komune të përfshira në studim dallon varësisht nga madhësia e komunës dhe silltet nga një deri në pesë shkolla të përfshira. Në anën tjetër, mostra e respondentëve nga shkollat është e qëllimshme.

Mostra e nxënësve përbëhet nga nxënësit e klasës së 2-të dhe klasës së 7-të, të cilët i janë nënshtruar një testi të vlerësimit të arritjeve të rezultateve të nxënësve në fund të këtyre klasave. Mostra e nxënësve të klasës së 2-të përbëhet prej 1260 nxënësve (26% me vendbanim në fshat dhe 74% me vendbanim në zona urbane, prej tyre rreth 49% vajza dhe 51% djem). Ndërsa, mostra e nxënësve të klasës së 7-të përbëhet nga 1244 nxënës. Nxënësit e klasës së 7-të, krahas nënshtrimit të testit për vlerësimin e arritjeve të rezultateve të nxënësve në fund të klasës së 7-të, e kanë plotësuar edhe një pyetësor. Referuar gjinisë së nxënësve të klasës së 7-të të përfshirë në studim, rezulton të kemi një përfaqësim përafërsisht të njëjtë të të dy gjinive (F=49.8% dhe M=50.2%). Specifikuar në vendbanimin e nxënësve, kemi dominim në përfaqësim të nxënësve nga qyteti (71.5%), krahasuar nga nxënësit, të cilët me vendbanim e kanë fshatin (28.5%).

Mostra e drejtorëve të shkollave në këtë studim përbëhet nga 63 drejtorë të shkollave, 11 prej tyre janë përfshirë në studim në fazën e përzgjedhjes së shkollave dhe paraleleve ku do të realizohej testimi me nxënës. Nga mostra e drejtorëve, 26, ose 41.3 %, punojnë në fshatra, ndërsa 37, ose 58.7 %, punojnë në shkolla të qytetit. Mostra e mësimit nxënësve përbëhet prej 490 mësimit nxënësve.

Mostra e prindërve në këtë studim përbëhet nga 826 prindër, kryesisht prindër të nxënësve të klasës së dytë dhe të klasës së shtatë, (prindër të: klasës së dytë 378, të klasës së gjashtë 1 prind, të klasës së shtatë 435, të klasës së tetë 9 dhe 3 prindër nuk janë deklaruar se në secilën klasë i kanë fëmijët e tyre).

*Metodat dhe instrumentet e studimit.* Për realizimin e studimit janë përdorur metoda dhe instrumente që mundësuan të sigurohen të dhëna sasiore dhe cilësore, në ndërlidhje me pyetjet kërkimore. Me anë të desk research – studimit kabinetik, është bërë mbledhja dhe analiza e të gjitha dokumenteve

të përgatitura nga MASHTI për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë, që në fillimet e saj, si dhe analiza e dokumenteve dhe raporteve që lidhen me objektin e këtij studimi. Ndërsa, hulumtimi me nxënës dhe respondentët e tjerë nga komuniteti i shkollës është realizuar me metodat dhe instrumentet në vijim:

- a) *Testet e vlerësimit për nxënësit e klasave të dyta dhe të shtata.* Për vlerësimin e nxënësve në kuadër të këtij studimi, (nxënësit e klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe dhe nxënësit e klasës së shtatë në lëndën e Gjuhës shqipe dhe Matematikës), janë përdorur instrumentet e vlerësimit të nxënësve për shkallët kurrikulare 1 dhe 3, përkatësisht klasat e dyta dhe të shtata, të hartuara nga MASHTI / Divizioni i vlerësimit. Testet për shkallë kurrikulare, të hartuara nga Divizioni i vlerësimit, janë bërë me qëllim të mbështetjes së shkollave për të realizuar vlerësimin e arritjeve të nxënësve të tyre në shkallë të kurrikulës. Secili instrument i vlerësimit ka përbajtur nga 20 kërkesa (pyetje/detyra) dhe  $\frac{1}{4}$  e tyre kanë qenë kërkesa të tipit të hapur.
- b) *Anketimi me nxënës.* Pyetësi i anketës për nxënësit e klasës së shtatë (7) ka përfshirë pyetje demografike dhe të organizimit të punës së shkollave, për analiza të mëtejme të arritjeve të tyre në testet e realizuara në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë;
- c) *Anketimi me mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave.* Pyetësi i anketës ka përfshirë pyetje që lidhen me (i) përgatitjet dhe organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë; (ii) përkrahjen e mësimdhënësve, planifikimin mësimor dhe zbatimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë; dhe (iii) rezultatet e nxënësve dhe humbjet mësimore;
- d) *Anketimi me prindër.* Pyetësi i anketës ka përfshirë pyetje që lidhen me (i) mbështetjen nga prindërit ofruar për fëmijët e tyre gjatë mësimin në kushtet e pandemisë; (ii) kushtet ekonomike dhe sigurimin e teknologjisë fëmijëve për përdorim gjatë mësimin online;

*Mbledhja dhe analiza e të dhënave.* Të dhënat për këtë studim u mbledhën nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës gjatë muajit qershor 2021. Mbledhjes së të dhënave i ka paraprirë muaji maj ku janë përcaktuara të gjitha detajet rreth mostrës dhe janë zhvilluar instrumentet për përdorim në kuadër të këtij studimi. Të dhënat nga drejtorët e shkollave janë mbledhur në fillim të qershorit, në punëtorinë e përbashkët ku është prezantuar kalendari i vizitave hulumtuese dhe testimi të nxënësve në shkolla.

Ndërsa, të dhënat me nxënës, prindër dhe mësimdhënës, janë mbledhur në shkolla nga hulumtuesit e IPK, me përkrahje nga drejtorët e shkollave, në ditën e realizimit të testimeve me nxënës. Pyetësi për nxënësit e klasës së shtatë (7) ishte i integruar në instrumentin e testimi në lëndën e Gjuhës shqipe, dhe pas përfundimit të testit, nxënësit kanë plotësuar edhe pyetësin e zhvilluar për këtë studim. Vlerësimi i nxënësve është realizuar me organizim dhe administrim nga vetë shkollat pjesëmarrëse në studim, sipas udhëzimeve të IPK-së.

Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mbledhura me pyetësit përkatës dhe rezultatet nga testi i nxënësve të klasave të dyta dhe të shtata është realizuar sipas planit dinamik për analizën e të dhënave. Për analizën e të dhënave të mbledhura me pyetësit përkatës - të dhënat sasiore, kemi përdorur programin Paketa Statistikore për Shkencat Sociale. Ndërsa, analizën e të dhënave cilësore e bazuam në metodën e analizës së përmbajtjes, pasi kërkesat e hapura në pyetësit e përdorur dhe përgjigjet e nxënësve në testet e vlerësimit u interpretuan sipas pyetjeve udhëzuese, duke dhënë një përshkrim të detajuar të aspekteve të mbuluara. Kjo qasje mundësoi që të dhënat e mbledhura të grupohen në kategori tematike dhe të lidhen me pyetjet kërkimore, për të cilat pastaj u bënë interpretime dhe përshkrime brenda një strukture të temave që e karakterizojnë këtë studim.

*Besueshmëria e pyetësorit të realizuar me mësimdhënës/personelin e shkollës.* Analizën e besueshmërisë së instrumentit me drejtorë të shkollave dhe me mësimdhënës e kemi bërë përmes testimi të koeficientit të Alfës së Kronbahut (Cronbach's Alpha) dhe KMO and Bartlett's Test. Rezultati i testimeve në kuadër të programit SPSS për kërkesa që ndërlidhen me



aspektet e hulumtuara rezultoi të jetë ( $\alpha=.788$ ), ndërsa KMO Bartlett's Test =.694, Sig.=.000. Sipas kësaj del se pyetësori është i pranueshëm.

*Kufizimet.* Studimi është i përshkuar nga disa kufizime, të cilat duhet të merren parasysh në përgjithësimin e rezultateve në raport me pasqyrimin e humbjeve mësimore gjatë mësimin në kushtet e pandemisë. Së pari, periudha e realizimit të studimit në terren ka qenë në javët e fundit të përfundimit të vitit mësimor. Kjo periudhë përshkruhet me ngarkesa për shkollat dhe me përfundim të notave për nxënës, të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatet e nxënësve në testet e mbajtura në të njëjtën ditë në të gjitha shkollat, nën menaxhimin e vetë shkollave.

Së dyti, testet/instrumentet e vlerësimit të nxënësve janë zhvilluar për qëllime të vlerësimit për nivelin e arritjeve të nxënësve në fund të shkallëve kurrikulare, nuk janë bërë raportime për përdorimin e tyre dhe rezultatet e arritura, e rrjedhimisht rezultatet nuk kanë mundur të krahasohen për të nxjerrë disa dallime dhe përfundime në raport me matjet e bëra në kudër të këtij studimi.

Testimi i nxënësve është përqendruar vetëm në dy klasa, përkatësisht dy klasat e fundit të shkallës kurrikulare dhe nuk janë realizuar testime me nxënësit e klasave tjera, që janë klasa përfundimtare të shkallëve 2, 4, 5 dhe 6. Në testim nuk janë përfshirë nxënësit nga shkollat private në arsimin bazë në Kosovë dhe nxënësit e minoriteteve.

Përtej kufizimeve të përshkuara më sipër, mendojmë se ky studim mbetet një burim i mirë informacioni për të gjitha institucionet arsimore për ndikimin e COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit, si dhe i kontribuon nxitjes së debatit institucional e shoqëror lidhur cilësinë e arsimit parauniversitar, mundësitë për të përmirësuar dhe avancuar atë në nivele të zhvillimit, që do të mund t'u përgjigjet në mënyrë efektive kërkesave të shoqërisë, përtej situatave emergjente.

*Aspekti etik i studimit.* Studimi është kryer duke iu përmbajtur etikës hulumtuese për të marrë të dhëna relevante për objektin e studimit – humbjet mësimore nga ndikimi i pandemisë COVID-19. Para realizimit të vlerësimeve në shkolla, kemi mbajtur një punëtori të veçantë me të gjithë

drejtorët e shkollave, për të dhënë informacione lidhur me studimin dhe praktikën e realizimit të testimit me nxënës, kemi kontaktuar me drejtorët e shkollave përkatëse. Pastaj, përmes drejtorëve të shkollave, i kemi informuar mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit për studimin, përfshirjen dhe kontributin e tyre në këtë studim, dhe i kemi përfshirë në ditën e realizimit të testeve me nxënës.

Gjatë realizimit të vizitës hulumtuese në shkollë dhe realizimit të testeve me nxënës, janë dhënë edhe një herë informacionet e nevojshme për studimin dhe qëllimin e tij, si dhe janë siguruar shkollat se do të ruhet besueshmëria e plotësisht të pyetësorëve dhe nuk do të bëhen publike rezultatet e nxënësve dhe të shkollave. Informata kthyesë specifike do t'u kthehen vetëm shkollave pjesëmarrëse në studim, me qëllim që shkollat t'i përdorin rezultatet e nxënësve të tyre për qëllime të planifikimit dhe për veprime dhe masa në mbështetje të nxënësve, për kompensimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në të nxënës.

## **6. REZULTATET E STUDIMIT**

### **6.1. Masa e humbjeve mësimore të nxënësve në arsimin parauniversitar**

Përcaktimi i masës së humbjes të përgjithshme mësimore të nxënësve është proces i vështirë, pavarësisht rrethanave dhe arsyeve të ndërprerjes së mësimin, përfshirë pushimet verore, braktisjen e përkohshme të shkollimit, mungesat e shumta, mësimdhënien joefektive etj. Përcaktimi i masës së humbjeve mësimore të nxënësve nga ndikimi i pandemisë është proces edhe më i vështirë dhe më kompleks, sidomos për sistemin tonë arsimor, i cili nuk ka të zhvilluar një sistem standard të vlerësimit të nxënësve që do të mundësonte matjen dhe krahasimin e humbjeve mësimore në çfarëdo rrethane.

Në anën tjetër, raportet dhe studimet ndërkombëtare lidhur me humbjet mësimore, bazuar në vlerësimet dhe analizat e bëra në raport me vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare, shprehimisht thonë se pandemia COVID-19 pritet të ketë ndikim domethënës në performancën e nxënësve, të ndikojë në humbjet mësimore dhe në krijimin e pabarazive në mësim. Metodologjitë e përdorura në studimet ndërkombëtare për matjet e humbjeve mësimore mund të përdoren edhe për analiza të brendshme dhe për krahasime me sistemet e tjera arsimore.

Pavarësisht mundësive të shfrytëzimit të metodologjive të përdorura nga studimet ndërkombëtare për humbjet mësimore, është e vështirë të ketë matje të sakta me parametra statistikor për humbjet mësimore, megjithatë disa tregues mund të nxirren nga krahasime të ndryshme, si në raport me kohën mësimore të mësimin të rregull gjatë pandemisë, përqindjen e reduktimeve të programeve për klasat dhe nivelet e caktuar, arritjet e nxënësve bazuar në vlerësimet e shkollave dhe arritjet e nxënësve nga studime specifike që bëhen për këtë periudhë të pandemisë.

Arsimi parauniversitar në Kosovë, referuar rezultateve të studimit PISA 2015 dhe PISA 2018, përballë me sfida të shumta edhe përpara fillimit të pandemisë globale. Në PISA 2018 rreth 66% e nxënësve kosovarë nuk e

kanë arritur nivelin 2<sup>6</sup>, në shkallën e përgjithshme në tri fushat (lexim, matematikë, shkencë), në anën tjetër vetëm 0.10 % e nxënësve kanë arritje në nivelet e larta, 5 dhe 6. Përmbledhje të rezultateve kryesore të PISA 2018 për nxënësit kosovarë pasqyrohen në raportin e OECD-së 2019 për PISA 2018 Results (Volume I). Pjesë të tyre janë analizuar, krahasuar dhe përmbledhur edhe në studimin analitik Gjendja e arsimit kosovar bazuar në testin PISA 2018 (Osdautaj, 2020).

Sipas studimit të Bankës Botërore, nxënësit e Ballkanit Perëndimor, pjesë e të cilit është edhe Kosova, mesatarisht fitojnë rreth 40 pikë PISA për çdo vit shkollimi. Del të jetë se një nxënës brenda një jave të mësimit fiton mesatarisht 1.08 pikë të të nxënës PISA. Nisur nga kjo, nëse marrim për bazë punën e shkollave me orar të shkurtuar të orëve mësimore, punën me dy ndërrime me klasë të njëjta, kur orët mësimore janë mbajtur maksimumi 25-30 minuta, i bie që nxënësit tanë në numër të orëve të mbajtura kanë humbur kohë mësimore për rreth 33% - 38% të kohës mësimore (orës mësimore 40-45 minuta), rreth 14 javë të mësimit apo 70 ditë mësimi, përkatësisht 3.2 muaj kohë mësimi.

Kjo kohë mësimore mund të jetë mbuluar te pjesa e angazhimit individual të nxënësve, kur kemi parasysh se grupet e klasave kanë qenë me numër të nxënësve nga 15 – 20 nxënës dhe supozohet së është shfrytëzuar mundësia për mësim të individualizuar. Mirëpo, baza është aty-aty, kur kemi parasysh se gjatë gjithë vitit shkollor të gjitha shkollat kanë mbajtur mësim me prezencë fizike të nxënësve, me ndarje në grupe, dhe së paku një javë mësim online dhe supozimi se metodat e mësimdhënies në kushtet e pandemisë nuk janë aq efektive sa mësimdhënia në kushte të zakonshme, në mjediset e klasës.

Pra, referuar kohëzgjatjes së mësimit gjatë vitit shkollor 2020/2021 dhe kohëzgjatjes së orës mësimore, gjatë këtij viti mësimdhënësit kishin kohë minimale për mësimdhënie. Studimet thonë se koha mësimore është një nga përcaktuesit kryesor të të nxënës. Koha mësimore është gjithashtu thelbësore

---

<sup>6</sup> Niveli 2 është niveli bazë, niveli i kompetencës ku nxënësit fillojnë të demonstrojnë kompetenca që do t'u mundësojnë të marrin pjesë në mënyrë efektive në të ardhmen, si nxënës në vazhdimësi, punonjës dhe qytetarë, OECD 2017.

për të ndihmuar në mbështetjen e cilësisë së arsimit gjatë pandemisë (Banka Botërore, 2020).

Faktet dëshmojnë se humbja e orëve mësimore të nxënësve është shqetësuese për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, por te nxënësit e nivelit fillor (I-V) efektet mund të jenë afatgjate për vitet në vazhdim dhe, gjithashtu, kjo mund të shkaktojë ankth, stres edhe te stafi arsimor, fëmijët-nxënësit dhe familjet e tyre (MASHTI, 2021).

Humbjet mësimore të nxënësve të arsimit parauniversitar në Kosovë gjatë mësimin në kushtet e pandemisë nuk kanë ardhur vetëm si rezultat shkurtimit të kohës mësimore (orëve të mësimin, por edhe si rezultat i mbylljes së shkollave në periudhën mars-qershor 2020 dhe mësimin në distancë gjatë kësaj periudhe, reduktimit të rreth 25% të përmbajtjeve kurrikulare dhe metodave të mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë kundrejt mësimdhënies në kushte të zakonshme në mjediset e klasës.

Në anën tjetër, nëse marrim për bazë rezultatet e nxënësve të klasës së dytë dhe rezultatet e nxënësve të klasës së shtatë, në vlerësimet e realizuara në kuadër të këtij studimi, ato tregojnë për shkallë të lartë të humbjeve mësimore dhe rritje të lartë të pabarazisë në mësim. Mirëpo, vlerësimi i ndikimit të COVID-19 në shkallen e humbjeve mësimore është vështirë të përcaktohet vetëm me arritshmërinë e nxënësve në një lëndë/dy lëndë mësimore dhe në dy klasa. Prandaj, rezultatet e vlerësimeve të nxënësve në lëndët dhe klasat e përfshira në këtë studim janë përfshirje në metodologjinë për vlerësimin e humbjeve mësimore, por jo të vetme, së bashku me disa parametra të tjerë që lidhen me kohën mësimore dhe me specifika të tjera, të cilat i kemi adaptuar nga metodologjia e studimit të Bankës Botërore për vlerësimin e ndikimit të mbylljeve të shkollave, për shkak të COVID-19, në humbjet mësimore.

Metodologjia për vlerësimin e humbjeve mësimore në këtë studim bazohet në metodologjinë e Bankës Botërore, në raportin për humbjet mësimore në periudhën e parë të pandemisë në Ballkanin Perëndimor, në supozimet në vijim: (i) Arritjet e nxënësve janë lineare përgjatë kohës mësimore gjatë një viti mësimor; (ii) Planifikimi mësimor dhe realizimi i tij është bërë sipas shkurtimit të kohës mësimore dhe propozimit për reduktimin e rreth 25% të

përmbajtjeve kurrikulare; (iii) Baza e të dhënave të PISA-s 2018 për arritjet e nxënësve në Kosovë ofron një vlerësim të arsyeshëm për përcaktimin e pikëve për një vit shkollimi; (iv) Metodave të mësimdhënies në kushtet e pandemisë nuk janë aq efektive sa mësimdhëniet në kushte të zakonshme në mjediset e klasës.


Krahasuar me rezultatet e studimit PISA 2018, raportin e studimit të Bankës Botërore për humbjet mësimore në fazën e parë të pandemisë (për vitin shkollor 2019/2020) dhe rezultatet e analizës për humbjet mësimore për vitin shkollor 2020/2021, humbjet mësimore në raport me pikët në PISA reflektohen si në vijim, me përfshirje të periudhës nga mars 2020 dhe deri në përfundim të vitit mësimor 2020/2021.

Tabela 1. Krahasimi rezultatet PISA 2018 (Lexim) me Post Covid	Pikët PISA 2018 dhe Post Covid
Pikët e nxënësve kosovarë në lexim - PISA 2018	<b>353</b>
1. Pikët PISA të humbura nga nxënësit që nuk janë përfshirë në mësimin në distancë gjatë periudhës mars-qershor 2020 (sipas raportit të Bankës Botërore).	-16 = <b>337</b>
2. Pikët PISA të humbura nga nxënësit që kanë marrë pjesë në mësimin në distancë gjatë periudhës mars-qershor 2020 (sipas raportit të Bankës Botërore).	-9 = <b>344</b>
3. Pikët PISA të humbura për shkak të kohës mësimore të humbur gjatë vitit shkollor 2020/2021 (me zvogëlim të orëve të mësimin), reduktim të përmbajtjeve kurrikulare (heqje të orëve të mësimin) dhe metodave të mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë.	-25 = <b>328</b>
4. Pikët PISA të humbura për shkak të kohës mësimore të humbur gjatë vitit shkollor 2020/2021 (me zvogëlim të orëve të mësimin) dhe metodave të mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë.	-15 = <b>338</b>
Post Covid – përmbledhja 2 +4	-24 = <b>329</b>
Post Covid – përmbledhja 1 +3	-41 = <b>312</b>

Referuar tabelës më sipër, humbjet mësimore të nxënësve në Kosovë mund të jenë sipas dy skenarëve:

- Skenari 1: humbje mësimore të krahasuara me 41 pikë të të nxënit PISA, apo mbi një vit të shkollimit, si rezultat i mospjesëmarrjes së nxënësve në mësimin në distancë në periudhën mars-qershor 2020, kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta, reduktimit të kurrikulave (rreth 25%) në disa lëndë mësimore gjatë vitit shkollor 2020/2021 dhe metodave të mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë;
- Skenari 2: humbje mësimore të krahasuara me 24 pikë të të nxënit PISA, apo më shumë se 60% e një viti të shkollimit sipas pikëve të të nxënit PISA, si rezultat i metodave të mësimdhënies joefektive gjatë mësimin në distancë dhe kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta.

Krahasimi për rezultatet nga PISA 2018 dhe humbjet mësimore të krahasuara me pikë të të nxënit PISA, të ndikuara nga pandemia COVID-19, pasqyrohet në grafikun në vijim.



Grafiku 1: Humbjet mësimore të ndikuara nga pandemia COVID-19, krahasuar me pikë të të nxënit PISA

Këto vlerësime kanë gjasë të jenë më të ulëta se realiteti, për shkak të qasjeve në mësimdhënie në kushtet e pandemisë, mungesës së interaksionit në mësim, dhe për shkak të masave mbrojtëse, nivelit të kompetencave digjitale në nxënie dhe mësimdhënie, mjedisit të të nxënësve në kushtet e pandemisë etj. Duhet theksuar se shkalla dhe sasia e humbjeve mësimore dallojnë nga komuna në komunë, por edhe brenda shkollave të një komune, varësisht nga qasjet në organizimin e mësimin, kohëzgjatjet e orëve të mësimin dhe largimin e disa lëndëve dhe orëve mësimore nga orari i mësimin.

Kjo qasje në përlogaritje të humbjeve mësimore nuk e merr parasysh organizimin e mësimin plotësues për nxënësit që kanë shfaqur ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e COVID-19, të realizuar nga shkollat me orare dhe qasje të ndryshme në dy muajt e fundit të vitit mësimor 2020/2021.

Humbjet mësimore dalin në pah edhe në vlerësimet e organizuara në kuadër të këtij studimi me nxënësit e klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe, të realizuar me një mostër të nxënësve 1260 dhe me nxënësit e klasës së shtatë në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë, të realizuar me mostrën 1244 nxënës. Rezultatet e këtyre vlerësimeve pasqyrohen në pjesën në vijim të këtij raporti.

## **6.2. Rezultatet e nxënësve dhe humbjet mësimore gjatë pandemisë në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë**

### ***6.2.1. Rezultatet e nxënësve të klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe***

Testi i vlerësimit për klasën e dytë ka përfshirë gjithsej 20 kërkesa/pyetje për realizim nga nxënësit, me alternativa të përgjigjeve të sakta nga 1 (një) deri në 3 (tre) pikë maksimale për kërkesa/pyetje, me strukturë: Një pikë = 14 kërkesa/pyetje me alternativa të shumëfishta; Dy pikë = 5 kërkesa/pyetje të hapura; Tre pikë = 1 kërkesë/pyetje të hapur. Nga 20 kërkesa/pyetje, maksimumi i pikëve të mundshme për t'u arritur nga nxënësi ishte gjithsej 27 pikë.

Testi i Gjuhës shqipe me nxënësit e klasës së dytë është realizuar në kohën e orarit të mësimin të shkollave të përfshira në studim, pa bërë asnjë ndryshim në dinamikën e orarit dhe të aktiviteteve të shkollës. Koha e realizimit të



testit nga nxënësit ishte 45 minuta. Procesi i testimit është menaxhuar nga mësime dhënësit administrues të shkollës përkatëse, jo nga mësuesit e klasës/paraleles nxënësit e së cilës janë testuar.

Kërkesat e testit mbulojnë disa rezultate të të nxënësit, të klasave 1 dhe 2, kryesisht të klasës së dytë. Ato iu referohen aspekteve të veçanta të rezultateve të të nxënësit të programit mësuesor Gjuhë shqipe, që përfshijnë rezultatet në vijim:

- Zbaton rregullat e drejtshkrimit;
- Shkruan tekste të shkurtra sipas modeleve;
- Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe tek emrat e përveçëm;
- Zgjeron apo shkurton fjalinë;
- Shkruan drejt e qartë dhe përdor shenjat e pikësimit;
- Krahason poezinë me gjëgjëzën, përrallen me tregimin;
- Krahason tekstin me vizatimin/fotografinë;
- Përshkruan tekste sipas modeleve të dhëna;
- Ritregon/parafrazon tekste të lexuara dhe biseda të ndryshme;
- Dallon fjalët me kuptim të njëjtë dhe me kuptim të kundërt;
- Ritregon dhe komenton ngjarje të lexuara, të rrëfyera;
- Demonstron kulturën e të shprehurit dhe të menduarit e pavarur;
- Shprehet në forma të ndryshme për temë të njëjtë;
- Shpreh botën emocionale me fjalë të zgjedhura;
- Shpreh mendimet dhe emocionet personale rreth pjesës që lexon;
- Dallon idenë themelore nga detajet; dallon personazhet, ngjarjet dhe përfundimin.

Në këtë pjesë të raportit, *Rezultatet e nxënësve të klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe*, gjetjet lidhur me testimin e nxënësve prezantohen të përmbledhura, si vlera të të gjitha shkollave fillore të përfshira në studim. Specifikuar në shkollën përkatëse, rezultatet janë dokumentuar të përmbledhura në një tabelë të veçantë në programin Excel dhe do të ndahen me secilën shkollë veç e veç, si informacion shtesë, për t'i shërbyer

shkollave pastaj si pasqyrë për gjendjen dhe për analiza të mëtutjeshme për aspektet e trajtuara në studim.

Analiza One Sample Statistics ka treguar se në test janë përgjigjur gjithsej 1260 nxënës dhe mesatarja e arrirë e nxënësve të klasës së dytë në testin Gjuhë shqipe **gjithsej shënon 13.9 pikë, ose 51.5%**. Ekziston një dallim i rëndësishëm në mes të mesatares së fituar dhe asaj të pritur. Mesatarja e fituar është 13.10 pikë më e vogël se ajo e pritur. Vlera e Sig. (2 – tailed) me 91% interval besueshmërie është më e vogël se 0,05 ( $p=0.000$ ).


Referuar analizës së rezultateve sipas kërkesave/pyetjeve të veçanta në lëndën e Gjuhës shqipe, nxënësit kanë arritur rezultate më të larta në kërkesat/pyetjet me alternativa të shumëfishta, ku kërkohej përdorim i strategjive të memorizimit, ndërsa kanë rezultate tejet të ulëta në kërkesat/pyetjet që kërkohej nxënësit të shkruanin, të shprehin mendim të pavarur, krijues etj.

Në të gjitha kërkesat/pyetjet e hapura, arritjet e nxënësve janë nën 40%. Në shumicën e përgjigjeve të shkruara, si fjali, shkrimi i teksteve të shkurtra të kërkuara në kontekste të caktuara, përshkrimi i ndonjë ilustrimi të dhënë, etj., vërehet nivel tejet i ulët i shkrimit dhe leximit të tij. Rezultatet në këto kërkesa/pyetje tregojnë se nxënësit e klasës së dytë kanë probleme të theksuara në zbatimin e rregullave të drejtshkrimit, në të shkruarit drejt dhe në përdorimin e shenjave të pikësimit, shkrimit të një teksti të shkurtër në bazë të rregullave që lidhen me temën përkatëse, vendosjen e titullit, përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, përdorimin e emrave të përveçëm etj.

Krahasuar me kriteret e vlerësimit formal në shkollat e Kosovës, mesatarja e arritshmërisë së të gjithë nxënësve në vlerësimin e realizuar në këtë studim (13.9 pikë ose 51.5%) është: Arritje e mjaftueshme – kur nxënësit kanë nevojë për përmirësim, do të thotë që nxënësit kanë arritur vetëm minimumin bazë të rezultateve të të nxënësve dhe kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Kujtojmë se i gjithë procesi i vlerësimit të nxënësve në klasa gjatë testimit, në kuadër të këtij studimi, është administruar nga mësuesit e shkollës përkatëse.

Në anën tjetër, rezultatet e vlerësimit në këtë studim janë më të ulëta për rreth 28 %, krahasuar me vlerësimet e mësuesve të klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe, përkatësisht notën mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe në fund të vitit shkollor. Sipas raporteve të shkollave të përfshira në këtë studim, nxënësit në fund të vitit shkollor në lëndën e Gjuhës shqipe kanë notë mesatare (4), me arritje shumë të kënaqshme – shumë mirë ose 80% nga nota maksimale (5) / Arritje të shkëlqyera – shkëlqyeshëm.

Për çështje të nxjerrjes së dallimeve në raport me sistemin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë, ashtu si rezultatet e Gjuhës shqipe, edhe rezultatet e arritura në lëndën e Matematikës, përkatësisht 27 pikët maksimale, i kemi kategorizuar në gjashtë nivele/grupe të pikëve. Dy nivelet e para ( 1 dhe 2) prezantojnë arritje të ulëta, nën minimumin e pritshmërisë për të arritur nivelin minimal të rezultateve të të nxënësve. Kategorizimi është bërë si në vijim, për nivelet dhe pikët për secilin nivel të arritjeve: Niveli 1: 0 deri në 6 pikë; Niveli 2: 7 deri në 10 pikë; Niveli 3: 11 deri në 16 pikë; Niveli 4: 17 deri në 21 pikë; Niveli 5: 22 pikë deri në 24 pikë dhe Niveli 6: 25 pikë deri në 27 pikë. Grafiku në vijim pasqyron rezultatet në përqindje sipas niveleve të arritjeve.




*Grafiku 2: Pikët e arritura nga nxënësit e klasës së dytë në testin e Gjuhës shqipe, shprehur në %, sipas niveleve të arritjeve (1-6).*

Kujtojmë se, sipas sistemit të vlerësimit të nxënësve në Kosovë, dy nivelet e para (nivelet 1 dhe 2) tregojnë arritje të pamjaftueshme (nota 1), niveli i tretë referon arritje të mjaftueshme (nota 2), niveli katër referon arritje të

mirë (nota 3), niveli pestë referon arritje shumë të mirë (nota 4), niveli gjashtë referon arritje të shkëlqyeshme (nota 5). Rezultatet e grafikut më sipër tregojnë se rreth 23% e nxënësve të klasës së dytë nuk i kanë arritur as në nivelin minimal rezultatet e të nxënësve, të cilat janë matur me instrumentin e vlerësimit në këtë studim. Prej tyre, mbi 10% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të rezultateve, 0-6 pikë, nga 27 pikët maksimale. Rezultatet e nxënësve në këto dy nivele tregojnë për tendencën e rritjeve të pabarazive në mësim.

Në anën tjetër, numri i nxënësve që kanë arritje të larta, sipas sistemit të vlerësimit, nota 4 dhe 5, është tejet minimal, 110 nxënës ose 8.7% e gjithë nxënësve të klasës së dytë të përfshirë në këtë studim.


**Rezultatet sipas vendbanimit të nxënësve.** Referuar vendit ku jetojnë nxënësit, përfshirja e nxënësve në studim ka qenë jo e barabartë në raport me vendbanimin e tyre (Fshat= n= 328 apo 26% dhe Qytet = n = 932 apo 74 %), për faktin se numri i shkollave dhe nxënësve është më i madh në zonat urbane. Shprehur në përqindje të arritjeve të nxënësve (minimumi 0 dhe maksimumi 27), në 20 kërkesat/detyrat e testit të lëndës së Gjuhës shqipe për klasën e dytë, rezultatet tregojnë se ka dallime në arritshmëri, që mund të vërehet në raport me vendbanimin e nxënësve. Ato pasqyrohen në grafikun në vijim.



Grafiku 3: Pasqyra e pikëve të arritura shprehur në %, specifikuar në vendbanimin e nxënësve.

Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, nxënësit me arritje të ulët, në nivelet 1 dhe 2, janë në përqindje më të lartë nga vendbanimi në fshat, rreth 10 % më shumë, kundrejt nxënësve me vendbanim në qytet. Nga kjo përqindje, shkalla më e lartë është në nivelin e parë, me 0-5 pikë. Kurse, në nivelet 5 dhe 6 nxënësit me vendbanim në fshat janë në numër fare të vogël që kanë arritur vetëm në nivelin 5 dhe asnjë nxënës në nivelin 6. Këto përqindje, sidomos ato të niveleve të arritjeve 1 dhe 2, pasqyrojnë tendencën për rritje të pabarazisë në mësim.

**Rezultatet sipas gjinisë.** Referuar gjinisë së nxënësve të klasës së dytë, përfshirja e nxënësve në studim ka qenë afërsisht e barabartë (Vajza/F= n= 612 apo 48.57% dhe Djem/M = n = 648 apo 51.43 %). Shprehur në përqindje të arritjeve të nxënësve (minimumi 0 dhe maksimumi 27) në 20 kërkesat/detyrat e testit të lëndës së Gjuhës shqipe për klasën e dytë, rezultatet tregojnë se ka dallime në arritje, që mund të vërehen në raport me gjininë e nxënësve. Ato pasqyrohen në grafikun në vijim.



*Grafiku 4: Pasqyra e pikëve të arritura shprehur në %, specifikuar në gjininë e nxënësve të klasës së dytë.*

Sa i përket gjinisë së nxënësve të klasës së dytë të përfshirë në studim, në lëndën e Gjuhës shqipe, vërehet se ka dallime më shumë të theksuara në nivelet e arritjeve 4, 5 dhe 6, pasi kanë arritshmëri më të lartë në këto nivele të arritjeve, ndërsa djemtë kanë arritshmëri më të ulët. Këtë e tregojnë rezultatet e tyre në nivelet 1, 2 dhe 3, pasi rreth 67% e djemve kanë arritshmëri në këto nivele.

### ***6.2.2. Rezultatet e nxënësve të klasës së shtatë në lëndën e Gjuhës shqipe***

Testi i vlerësimit në lëndën e Gjuhës shqipe për nxënësit e klasës së shtatë ka përfshirë 20 kërkesa, të tipit të hapur dhe të mbyllur. Testi përbëhet nga kërkesa të cilat kishin pikë të ndryshme për përgjigje të sakta, nga 1 (një) deri në 3 (tre) pikë maksimale për kërkesë/pyetje, me strukturë: Një pikë = 15 kërkesa/pyetje; Dy pikë = 2 kërkesa/pyetje; Tre pikë = 3 kërkesa /pyetje.

Kërkesat e testit mbulojnë disa rezultate të nxënësve të klasave të gjashta dhe të shtata, kryesisht të klasës së shtatë. Ato u referohen aspekteve të veçanta të rezultateve të nxënësve, që përfshijnë:

- Dallimin e elementeve përbërëse në një tregim të shkurtër;
- Dallimin e elementeve të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si poezi, prozë, tekst dramatik;
- Identifikimin e ngjarjes që e reflekton tërësia e një teksti të lexuar;
- Dallimin e fjalëve me shumë kuptime etj.;
- Dallimin e subjektit dhe idesë kryesore në një tekst me nëntë paragrafë;
- Analizën e teksteve të ndryshme sipas qëllimit të shkrimit;
- Dallimin e tekstit të figurshëm nga teksti jo i figurshëm;
- Argumentimin, paraqitjen dhe renditjen e ideve në një përshkrim për një ngjarje apo situatë të lidhur me një tekst të lexuar;
- Përdorimin e figurave stilistike gjatë përshkrimit dhe ofrimin e burimeve gjatë përshkrimit;
- Gjetjen e kuptimit figurativ në fjali apo tekst të shkurtër të lexuar;
- Përdorimin e kryefjalës në fjali dhe të rrethanorit të vendit, sipas udhëzimeve të dhëna;
- Argumentimin e mendimit personal në një shkrim të shkurtër, i cili bazohet në leximin e figurave që paraqesin ngjarje të caktuara;
- Renditja e ideve në përshkrim;

- Të shkruarit e një shkrimi të shkurtër, duke u bazuar në tekstin e një poezie;
- Drejtshkrimin, përfshirë edhe drejtshkrimin e numërorëve.

Analiza One Sample Statistics ka treguar se në test janë përgjigjur gjithsej 1244 nxënës, mesatarja e arritur e nxënësve në gjithsej pikë në testin e Gjuhës shqipe shënon 10.58 ose 41%. Ekziston një dallim i rëndësishëm në mes të mesatares së fituar dhe asaj të pritur. Mesatarja e fituar është 15.42 pikë më e vogël se ajo e pritur. Vlera e Sig. (2 – tailed) me 95% interval besueshmërie është më e vogël se 0,05 (p=.000).


Në raport, gjetjet lidhur me testimin e nxënësve prezantohen të përmbledhura si vlera gjithsej për 52 shkollat e përfshira në studim. Specifikuar në shkollën përkatëse, rezultatet janë dokumentuar të përmbledhura në një tabelë të veçantë në programin Excel dhe do të ndahen me secilën shkollë veç e veç si informacion shtesë, për t'u shërbyer shkollave, pastaj si pasqyrë për gjendjen dhe për analiza të mëtutjeshme për aspektet e trajtuara në studim.

Referuar analizës së rezultateve sipas kërkesave/pyetjeve të veçanta në lëndën e Gjuhës shqipe, nxënësit kanë arritur rezultate më të larta në kërkesat/pyetjet ku kërkohej përdorim i strategjive të memorizimit, kundrejt kërkesave që kërkonin përdorim të strategjive elaboruese dhe të mendimit kritik.

Më tutje kemi vazhduar me analizën e numrit të pikëve të arritura gjithsej nga nxënësit e testuar në 20 pyetjet e testit (minimumi 0 dhe maksimumi 26). Për çështje të organizimit dhe prezantimit më të qartë të pasqyrës së pikëve të arritura nga nxënësit, 26 pikët maksimale i kemi kategorizuar në gjashtë nivele/grupe të pikëve: Niveli 1: 0 pikë deri në 5 pikë; Niveli 2: 6 pikë deri në 10 pikë; Niveli 3: 11 pikë deri në 15 pikë; Niveli 4: 16 pikë deri në 20 pikë; Niveli 5: 21 pikë deri në 23 pikë dhe Niveli 6: 24 pikë deri në 26 pikë.

Referuar rezultateve të nxënësve, shprehur në numër dhe në përqindje, përqindje më të larta të nxënësve, kemi te niveli dy: 6 pikë deri në 10 pikë (n=457 ose 36.7%) dhe niveli 3: 11 pikë deri në 15 pikë (n= 435 ose 35.0%).

Në nivelet në grupin e pikëve 21 pikë deri në 23 pikë dhe 24 pikë deri në 26 pikë vërehet një përqindje mjaft e ulët e nxënësve shprehur në (për të dy grupet: n=24 ose 2.1%). Grafiku në vijim i pasqyron rezultatet në përqindje sipas niveleve të arritjeve.



*Grafiku 5: Pikët e arrira nga nxënësit e klasës së shtatë në testin e Gjuhës shqipe, shprehur në përqindje.*

Rezultatet e grafikut më sipër tregojnë se rreth 51 % e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënësve të cilat janë matur me instrumentin e vlerësimit në këtë studim. Prej tyre, rreth 15% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të rezultateve.

Referuar rezultateve të të nxënësve, që janë synuar të maten me instrumentin e vlerësimit, nxënësit kanë treguar rezultate relativisht të mira në kërkesat e testit që lidhen me:

- Dallimin e elementeve përbërëse në një tregim të shkurtër;
- Dallimin e elementeve të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si poezi, prozë, tekst dramatik;
- Identifikimin e ngjarjes që e reflekton tërësia e një teksti të lexuar;
- Dallimin e fjalëve me shumë kuptime etj.



Në anën tjetër, rezultatet tregojnë se nxënësit kanë probleme të theksuara me:

- Dallimin e subjektit dhe idesë kryesore në një tekst me nëntë paragrafë;
- Analizën e teksteve të ndryshme sipas qëllimit të shkrimit;
- Dallimin e tekstit të figurshëm nga teksti jo i figurshëm.
- Argumentimin, paraqitjen dhe renditjen e ideve në një përshkrim për një ngjarje apo situatë të lidhur me një tekst të lexuar;
- Përdorimin e figurave stilistike gjatë përshkrimit dhe ofrimin e burimeve gjatë përshkrimit;
- Gjetjen e kuptimit figurativ në fjali apo tekst të shkurtër të lexuar;
- Përdorimin e kryefjalës në fjali dhe të rrethanorit të vendit, sipas udhëzimeve të dhëna;
- Argumentimin e mendimit personal në një shkrim të shkurtër, i cili bazohet në leximin e figurave që paraqesin ngjarje të caktuara;
- Renditja e ideve në përshkrim;
- Të shkruarit e një shkrimi të shkurtër duke u bazuar në tekstin e një poezie;
- Drejtshkrimin, përfshirë edhe drejtshkrimin e numërorëve;

### **Gabimet gjuhësore të nxënësve**

Gabimet gjuhësore të nxënësve janë analizuar në përgjigjet e tyre, në kërkesat/pyetjet e hapura të testit vlerësues dhe në përgjigjet të hapura në pyetjet e pyetësorit për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë. Në shumicën e përgjigjeve në kërkesat e hapura dhe, gjithashtu, në shumicën e vërejtjeve dhe sugjerimeve të nxënësve në pyetësorin e plotësuar prej tyre, vërehet nivel i ulët i përdorimit të gjuhës standarde. Në gjuhën e përdorur vërehen shkelje të shumta të normës së shkruar, veçanërisht të normës drejtshkrimore.

Në shumë përgjigje dhe komente nxënësit nuk e përdorin zanoren **ë**, apo e përdorin gabimisht, edhe të foljet ndihmëse kam dhe jam. Nuk i përdorin drejt kohët e foljeve, nuk e dinë përdorimin e lidhore, i ngatërrojnë trajtat e shkurtra, nuk i dallojnë ndajfoljet me mbiemrat, i ngatërrojnë shkronjat **ç** dhe **q**, nuk e përdorin apostrofin dhe shenjat e tjera të pikësimit etj.

Gjuha e përdorur nga nxënësit e klasave të shtata lë shumë për të dëshiruar.

### ***6.2.3. Rezultatet e nxënësve në testin e lëndës së Matematikës***

Testi i vlerësimit për lëndën e Matematikës kishte gjithsej 20 kërkesa/detyra për realizim nga nxënësit, me alternativa të përgjigjeve të sakta nga 1 (një) deri në 3 (tre) pikë maksimale për pyetje, me strukturë: Një pikë = 17 detyra; Dy pikë = 1 detyra; Tri pikë = 2 detyra. Nga 20 kërkesa/detyra, maksimumi i pikëve të mundshme për t'u arritur nga nxënësi ishte gjithsej 24 pikë.

Kërkesat e testit mbulojnë disa rezultate të nxënësve të klasave të gjashta dhe të shtata, kryesisht të klasës së shtatë. Ato u referohen aspekteve të veçanta të rezultateve të nxënësve, të cilat përfshijnë:

- Zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme, duke përdorur numra përpjesëtimorë dhe përqindje;
- Njehsimin e ndryshimit të numrave të plotë;
- Paraqitjen e të dhënave të grumbulluara në tabela;
- Përcaktimin e vlerave mesatare;
- Gjetjen e ndryshimit të numrave disa shifrorë;
- Zgjidhjen e detyrave problemore që lidhen me gjetjen e përqindjeve (%);
- Leximin dhe interpretimin e boshtit numerik;
- Mbledhjen dhe zbritjen e këndeve;
- Gjetjen e perimetrit të drejtkëndëshit;
- Ndërtimin e grafikut të funksionit duke bashkuar pikat në rrjetin koordinatave;

- Njehsimin e sipërfaqes së piramidës;
- Zgjidhjen e problemeve duke përdorur fuqitë;
- Caktimin e perimetrit të figurave dydimensionale me anë të formulave dhe me matje;
- Shkrimin e funksionit dhe përcaktimin e vlerave të argumentimit në situata nga jeta që lidhen me kosto të shpenzimeve.

Analiza One Sample Statistics ka treguar se në test janë përgjigjur gjithsej 1234 nxënës, mesatarja e arritur e nxënësve në gjithsej pikë në testin e Matematikës shënon 11.47, ose rreth 48%. Ekziston një dallim i rëndësishëm në mes të mesatares së fituar dhe asaj të pritur. Mesatarja e fituar është 12.52 pikë më e vogël se pikët maksimale. Vlera e Sig. (2 – tailed) me 95% interval besueshmërie është më e vogël se 0,05 (p=.000).

Edhe rezultatet në lëndën e Matematikës, për çështje të nxjerrjes së dallimeve në raport me sistemin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë, ashtu si rezultatet e Gjuhës shqipe, i kemi kategorizuar në gjashtë nivele/grupe të pikëve (24 pikë maksimale):

Niveli 1: 0 deri në 4 pikë;

Niveli 2: 5 deri në 9 pikë;


Niveli 3: 10 deri në 14 pikë;

Niveli 4: 15 deri në 19 pikë;

Niveli 5: 20 pikë deri në 21 pikë; dhe

Niveli 6: 22 pikë deri në 24 pikë.

Shprehur në numër dhe në përqindje, arritje më të larta kemi te Niveli 3: 10 pikë deri në 14 pikë (n=433 ose 35.1%) dhe Niveli 2: 5 pikë deri në 9 pikë (n= 357 ose 28.9%). Në nivelet 5 dhe 6 vërehet një arritje mjaft e ulët e nxënësve shprehur në numër dhe në përqindje të tyre për të dyja grupet: n=64 ose 5.2%. Grafiku në vijim pasqyron rezultatet në përqindje sipas niveleve të arritjeve.



*Grafiku 6: Pikët e arritura nga nxënësit në testin e Matematikës, shprehur në përqindje.*

Edhe në raport me rezultatet e arritura në lëndën e Matematikës rikujtojmë se, sipas sistemit të vlerësimit të nxënësve në Kosovë, dy nivelet e para tregojnë arritje të pamjaftueshme (nota 1), niveli i tretë referon arritje të mjaftueshme (nota 2), niveli i katër referon arritje të mirë (nota 3), niveli i pestë referon arritje shumë të mirë (nota 4), niveli i gjashtë referon arritje të shkëlqyeshme (nota 5). Rezultatet e grafikut më sipër tregojnë se rreth 36 % e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur as në nivelin minimal rezultatet e të nxënësve të cilat janë matur me instrumentin e vlerësimit në këtë studim. Prej tyre, mbi 7% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të rezultateve, 0-4 pikë nga 24 pikë maksimale. Në anën tjetër, numri i nxënësve që kanë arritje të larta, sipas sistemit të vlerësimit, nota 4 dhe 5, është tejet minimale, 64 nxënës apo 5.2%.

Referuar rezultateve të të nxënësve që janë synuar të maten me instrumentin e vlerësimit në lëndën e Matematikës, nxënësit kanë treguar rezultate relativisht të mira në kërkesat e testit që lidhen me:

- Zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme, duke përdorur numra përpjesëtimorë dhe përqindjet;
- Njehsimin e ndryshimit të numrave të plotë;
- Paraqitjen e të dhënave të grumbulluara në tabela;

- Përcaktimin e vlerave mesatare.

Në anën tjetër, rezultatet tregojnë se nxënësit kanë probleme të theksuara me:


- Gjetjen e ndryshimit të numrave disa shifrorë;
- Zgjidhjen e detyrave problemore që lidhen me gjetjen e përqindjeve (%);
- Leximin dhe interpretimin e boshtit numerik;
- Mbledhjen dhe zbritjen e këndeve;
- Gjetjen e perimetrit të drejtkëndëshit;
- Ndërtimin e grafikut të funksionit duke bashkuar pikat në rrjetin koordinatave;
- Njehsimin e sipërfaqes së piramidës
- Zgjidhjen e problemeve duke përdorur fuqitë;
- Caktimin e perimetrit të figurave dydimensionale me anë të formulave dhe me matje;
- Shkrimin e funksionit dhe përcaktimin e vlerave të argumentimit në situata nga jeta, që lidhen me kosto të shpenzimeve.

#### ***6.2.4. Rezultatet në testin e Gjuhës shqipe dhe të Matematikës, sipas gjendjes socio-ekonomike të nxënësve dhe disa specifikave të punës së shkollave gjatë pandemisë***

Në përgjithësi, rezultatet e nxënësve në Gjuhën shqipe dhe në Matematikë tregojë për dallime të vogla të arritshmërisë së nxënësve, sipas aspekteve të gjendjes socio-ekonomike të nxënësve dhe specifikave të punës së shkollave gjatë pandemisë, të trajtuara në kuadër të këtij studimi. Për këtë duhet të kihet parasysh se arritshmëria e nxënësve në këtë studim, në të dyja lëndët, është e ulët, në Gjuhë shqipe 42 %, ndërsa në Matematikë 48%. Megjithatë, për disa aspekte të gjendjes socio-ekonomike të nxënësve dhe specifikave të punës së shkollave gjatë pandemisë, të trajtuara në kuadër të këtij studimi,

ka disa dallime statistikore, që konsiderohen të rëndësishme dhe me ndikim në rezultatet e nxënësve.

**Rezultatet sipas vendbanimit të nxënësve.** Referuar vendit ku jetojnë nxënësit, përfshirja e nxënësve në studim ka qenë jo e barabartë në raport me vendbanimin e tyre (fshat= 28.5% dhe qytet =71.5%), kjo për faktin se numri i shkollave dhe nxënësve është më i madh në zonat urbane. Shprehur në përqindje të arritjeve të nxënësve (minimumi 0 dhe maksimumi 24) në 20 kërkesat/detyrat e testit të lëndës së Gjuhës shqipe, rezultatet tregojnë se ka dallime në arritshmëri, që mund të vërehet në raport me vendbanimin e nxënësve. Ato pasqyrohen në grafikun në vijim.




*Grafiku 7: Pasqyra e pikëve të arritura në lëndën e Gjuhës shqipe shprehur në %, specifikuar në vendbanimin e nxënësve.*

Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, nxënësit me arritshmëri të ulët, në nivelet 1 dhe 2, janë në përqindje më të lartë nga vendbanimi në fshat, mbi 15 % më shumë kundrejt nxënësve me vendbanim në qytet. Nga kjo përqindje shkalla më e lartë është në nivelin e parë, me 0-5 pikë.

Edhe rezultatet e Matematikës, sa i përket vendbanimit të nxënësve, tregojnë se nxënësit që jetojnë në fshat kanë arritshmëri më të ulët kundrejt nxënësve që jetojnë në qytet. Shprehur në përqindje të arritjeve të nxënësve (minimumi 0 dhe maksimumi 24), në 20 kërkesat/detyrat e testit të lëndës së


Matematikës, referuar vendbanimit të nxënësve, kemi pasqyrën si në grafikun në vijim.



*Grafiku 8: Pasqyra e pikëve të arritura në testin e Matematikës shprehur në %, specifikuar në vendbanimin e nxënësve.*

Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, përqindje më të larta të arritjeve nga nxënësit nga të dyja kategoritë e vendbanimeve (fshat dhe qytet) i kemi në Nivelin 3: 10 deri në 14 pikë (fshat = 43.5% dhe qytet = 31.7%). Referuar rezultateve më sipër, nxënësit me vendbanim në fshat, në përqindje mbi 7%, kanë arritshmëri tejet të ulët, kundrejt nxënësve me vendbanim në zonat urbane, dhe mbi 12% më shumë kanë pikë në nivelin e tretë (nota 2), me 10-14 pikë. Ata, gjithashtu, janë në numër dhe përqindje më të vogël në nivelet e pikëve 5 dhe 6 (apo në arritje sipas notave 4 dhe 5) kundrejt nxënësve me vendbanim në qytet.

**Rezultatet sipas gjinisë së nxënësve.** Sa i përket gjinisë së nxënësve të përfshirë në studim, përqindja e përfshirjes është përafërsisht e njëjtë (F=49.8% dhe M=50.2%). Në 20 kërkesat/pyetjet e testit të Gjuhës shqipe, përqindje më të larta të nxënësve të gjinisë femërore kemi te Niveli i tretë: 11 deri në 15 pikë (41.1%), përderisa tek ata të gjinisë mashkullore përqindje më të larta kemi te Niveli i dytë: 6 deri në 10 pikë (43.9%).



*Grafiku 9: Pasqyra e pikëve të arritura në lëndën e Gjuhës shqipe shprehur në %, specifikuar në gjininë e nxënësve.*

Sa i përket gjinisë së nxënësve të përfshirë në studim në lëndën e Gjuhës shqipe, ka dallime të theksuara. Vajzat kanë arritshmëri më të lartë në nivelet e arritjeve 3, 4, 5 dhe 6, ndërsa rreth 63% e djemve kanë arritshmëri në nivelet 1 dhe 2, nivelet që tregojnë se as në nivelin minimal nuk janë arritur rezultatet në lëndën e Gjuhës shqipe.

Në anën tjetër, në arritjet e nxënësve në testin e Matematikës, specifikuar në gjini, nuk kemi dallim domethënës statistikor, që dallon arritshmërinë e nxënësve në raport me gjininë.

**Rezultatet e nxënësve sipas numrit të anëtarëve në familje dhe numrit të fëmijëve në shkollë.** Numri i anëtarëve në familje dhe numri i fëmijëve të një familje në shkollë janë elemente të rëndësishme, që reflektohen edhe në arritjet e nxënësve, varësisht nga ofrimi i mundësive dhe përkrahjes në familje. Në raport me numrin e anëtarëve në familje, nga 3 anëtarë deri mbi 6 anëtarë të familjes nuk ka dallim domethënës statistikor. Vlen të veçohet një dallim i vogël të rezultatet e nxënësve me familje 6-anëtarësh. Këta nxënës për rreth 2% kanë rezultate më të larta se nxënësit e tjerë, si në Gjuhë shqipe ashtu edhe në Matematikë.

Edhe sa i përket numrit të fëmijëve në një familje që vijojnë shkollimin, nuk është se kemi ndonjë ndryshim të madh në arritje të nxënësve. Mirëpo, vlen të theksohet se rezultatet e nxënësve që në familje kanë vetëm një fëmijë në shkollë dhe familjet që kanë më shumë se 4 fëmijë në shkollë rezultatet janë



më të ulëta. Nxënësit nga këto familje kanë treguar arritshmëri në nivelet më të ulëta (nivelet 1 dhe 2) si:

- Në Gjuhë shqipe, 52% e nxënësve që kanë në familje vetëm një fëmijë në shkollë kanë arritje në nivelet 1 dhe 2, ndërsa në familjet me mbi 4 fëmijë në shkollë në këto dy nivele janë rreth 65% e nxënësve;
- Në Matematikë, mbi 51 % e nxënësve që në familje kanë mbi 4 fëmijë në shkollë kanë arritje në nivelet 1 dhe 2.

Marrë përgjithësi, rezultatet tregojnë se nxënësit me 5- 6 anëtarë të familjes dhe me 3- 4 nxënës në shkollë kanë arritje me të lartë, kundrejt familjeve me numër të vogël, apo më të madh se 6 anëtarë dhe kundrejt numrit minimal të fëmijëve në shkollë, apo më shumë se 4 fëmijë në shkollë. Këto të dhëna tregojnë për mundësinë më të madhe të familjes me përkrahje të fëmijëve të tyre gjatë pandemisë dhe për ndihmën në mësim që fëmijët nxënës të një familje mund t'i ofrojnë njëri-tjetrit.

**Rezultatet e nxënësve sipas kushteve për mësim në shtëpi.** Sa u përket kushteve shtëpiake për mësim gjatë pandemisë, nga nxënësit me kushte aspak të përshtatshme deri në kushte ideale për mësim, rezulton që mjedisi i të nxënësve në shtëpi, apo kushtet shtëpiake për mësim gjatë pandemisë, kanë ndikim në nivelet e arritjeve të nxënësve. Sipas rezultateve, mbi 75% e nxënësve që aspak nuk i kanë të përshtatshme kushtet shtëpiake për mësim, pa asnjë hapësirë të veçantë për mësim, qëndrojnë në nivelet 1 dhe 2 të arritshmërisë në lëndën e Gjuhës shqipe. Ndërsa, mbi 40 % e nxënësve që kanë kushte ideale për mësim – një dhomë të veçantë mësimi, qëndrojnë në nivelet 1 dhe 2 të arritshmërisë në këtë vlerësim.

Në raport me kushtet shtëpiake për mësim gjatë pandemisë, rezultatet e nxënësve në testin e Matematikës tregojnë dallime në arritshmëri më të vogla kundrejt rezultateve në Gjuhë shqipe. Diferenca e arritshmërisë së nxënësve në matematikë kundrejt në gjuhë shqipe, që nuk kanë asnjë hapësirë të veçantë për mësim apo që kanë një hapësirë fare e vogël për mësim në dhomën e qëndrimit ditor, është për 25% më e ulët, përkatësisht rreth 50 % e nxënësve që kanë mungesë të hapësirës së veçantë për mësim, kanë arritje në nivelet 1 dhe 2. Nxënësit me kushte më të mira për mësim në shtëpi qëndrojnë shumë më mirë në nivelet e arritjeve 3 dhe 4, mirëpo

kushtet nuk reflektohen mjaftueshëm në nivelet e larta të arritjeve, nivelet 5 dhe 6.

Edhe sa u përket dallimeve statistikore për arritjet e nxënësve në raport me kushtet për mësim në shtëpi duhet të kihet parasysh se arritshmëria e përgjithshme është e ulët, si në Gjuhë shqipe (42%) ashtu edhe në Matematikë (48%).

Sa i përket numrit të nxënësve në shkolla, rezultatet e nxënësve në testin e Gjuhës shqipe tregojnë dallime në arritshmëri, në raport me nivelet e arritjeve. Shkollat me 150 nxënës, shkollat me 151-250 nxënës dhe shkollat me mbi 1500 nxënës nuk kanë asnjë nxënës me arritje në nivelin 6. Në anën tjetër, shkollat me numër të nxënësve 251-500 dhe shkollat me numër të nxënësve 501–1000 kanë përqindjen më të lartë të nxënësve në nivelet 1 dhe 2, rreth 60 %, përkatësisht 52% e nxënësve të këtyre shkollave kanë treguar arritje në nivele të ulëta.


Në raport me numrin e nxënësve në shkolla, ka një dallim në rezultatet e lëndës së Matematikës. Rezultatet e Matematikës tregojnë se shkollat me numër të vogël të nxënësve dhe shkollat me numër të nxënësve mbi 1000 nxënës (*shkollat me numër të nxënësve deri në 150, deri në 250, 1001-1500 dhe shkollat me numër të nxënësve mbi 1500 nxënës*) kanë numër dhe përqindje më të vogël të nxënësve me arritshmëri në nivelet e arritjeve 5 dhe 6 (20 – 21 pikë dhe 22-24 pikë), më të ulëta se nxënësit e shkollave me 251-500 dhe nxënësit e shkollave me 501-1000 nxënës. Në anën tjetër, nxënësit e shkollave me numër të nxënësve 151-250 arritjet kryesisht i kanë në nivelet 3 dhe 4, ku sipas sistemit të vlerësimit formal nënkupton notat 2 dhe 3, prej tyre 67% me notën 2 të arritshmërisë.

**Rezultatet e nxënësve sipas skenarëve të mësimin dhe kohëzgjatjes së orës mësimore në kushtet e pandemisë.** Referuar arritjeve të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe dhe në lëndën e Matematikës, nxënësit kanë arritshmëri të ulët, pavarësisht skenarëve të mësimin, pra nuk kemi dallim domethënës statistikor që e dallon arritshmërinë e nxënësve në raport me skenarët e mësimin. Për këtë duhet të kemi parasysh dy aspekte:

- E para, arritshmëria e nxënësve është e përqendruar në nivele të ulëta të arritshmërisë dhe vetëm një përqindje relativisht e vogël e nxënësve kanë arritur nivelet më të larta, nivelet e arritshmërisë 4, 5 dhe 6;

- E dyta, shkollat që kanë punuar me skenarin C të mësimin nga 1-4 javë, apo në skenarin B të mësimin, kryesisht janë shkolla urbane dhe arritjet e nxënësve në shkollat urbane janë më të larta se arritjet e nxënësve në shkollat rurale.

Studimet tregojnë se kohëzgjatja e mësimin, orës mësimore, është një faktor ndikues në rezultatet dhe arritjet e nxënësve. Sa i përket kohëzgjatjes së orës mësimore gjatë pandemisë, rezultatet e nxënësve në testin e Gjuhës shqipe dhe Matematikës tregojnë dallime të vogla në arritshmëri, që mund të vërehen në përqindjet e arritshmërisë sipas kohëzgjatjes së orës mësimore, që do të thotë se diferenca në arritshmërinë e nxënësve që kishin kohëzgjatje më të vogël të orës mësimore dallon ndërmjet lëndëve Gjuhë shqipe dhe Matematikë. Në lëndën e Gjuhës shqipe, në shkollat ku kohëzgjatja e orës mësimore ishte 25 minuta, arritshmëria e nxënësve është më e lartë për 2-3% se në shkollat me kohëzgjatje tjera të mësimin. Ndërsa në lëndën e Matematikës arritshmëri më e lartë është shënuar te nxënësit e shkollave me kohëzgjatje të orës mësimore 35 minuta, nga 3-7% më e lartë se në kohëzgjatjet e tjera të orës së mësimin.



*Grafiku 10: Rezultatet e nxënësve në Gjuhën shqipe dhe në Matematikë sipas kohëzgjatjes së orës së mësimin në kushtet e pandemisë.*

Edhe në raport me kohëzgjatjen e orës mësimore duhet të kemi parasysh se arritshmëria e nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe është më e ulët se në


lëndën e Matematikës dhe se arritshmëria në të dyja lëndët është e koncentruar në nivele të ulëta të arritshmërisë, veçanërisht 1, 2 dhe 3, ndërsa vetëm një përqindje relativisht e vogël e nxënësve kanë arritur nivelet më të larta të arritshmërisë, nivelet e arritshmërisë 4, 5 dhe 6.

**Rezultatet e nxënësve sipas angazhimit të nxënësve në mësim.** Sa i përket angazhimit të nxënësve në mësim në rrethanat e pandemisë, nuk është vërejtur ndonjë ndikim i angazhimit të nxënësve në mësim, në raport me rezultatet e tyre në këtë studim. Referuar gjetjeve, rezulton që nivelet e arritshmërisë së nxënësve në testin e Gjuhës shqipe dhe të Matematikës nuk korrespondojnë me deklaratimet e nxënësve për angazhimin e tyre në mësim gjatë kohës së pandemisë. Kështu, nxënësit, të cilët kanë deklaruar se kanë qenë tejet pasivë në angazhimet rreth mësimave, në lëndën e Gjuhës shqipe në përqindje më të lartë kanë treguar arritje te niveli 2 (39% e nxënësve), ndërsa nxënësit me angazhim të lartë në mësim në përqindje më të madhe kanë treguar arritje te niveli 3 (45.7% e nxënësve). Në anën tjetër, në lëndën e Matematikës nxënësit që kanë deklaruar se kanë qenë tejet pasivë në angazhimet rreth mësimave, në përqindje më të lartë arritje kanë treguar rezultatet te niveli 4 (37% e nxënësve), ndërsa nxënësit me deklaratim për angazhim të lartë në mësim, në përqindje më të madhe, kanë treguar arritje në nivelin 3 (45.7% e nxënësve).

Situatë më ndryshe ka qenë lidhur me kohën e kaluar në kryerjen e obligimeve shkollore si nxënës gjatë këtij viti shkollor (orë mësimore, angazhime, projekte dhe detyra shtëpie). Nxënësit që kanë më shumë kohë në kryerjen e obligimeve shkollore, kanë arritshmëri më të lartë, si në Gjuhë shqipe ashtu edhe në Matematikë, kundrejt nxënësve të cilët kanë deklaruar se kanë kaluar më pak kohë në kryerjen e obligimeve shkollore apo kanë kaluar kohë të njëjtë. Dallimi më i madh vërehet në nivelet e arritjeve 1 dhe 2, ku 58 % e nxënësve që kanë deklaruar se janë angazhuar shumë më pak gjatë këtij viti shkollor janë në këto nivele, kundrejt 31% të nxënësve që janë në këto nivele, të cilët kanë deklaruar se gjatë këtij viti kanë qenë më shumë të angazhuar.

Situatë edhe më ndryshe reflektohet sa i përket deklaratimit të nxënësve për rezultatet e tyre në lëndën e Gjuhës shqipe dhe lëndën e Matematikës gjatë

vitit shkollor në rrethanat e pandemisë, në raport me arritjet e nxënësve në vlerësimin e tyre në këto lëndë mësimore në kuadër të këtij studimi. Për ilustrim u referohemi deklaratimeve të nxënësve që kanë thënë se kanë sukses në shkollë në këto dy lëndë mësimore, shumë të mirë (mbi 24 % e nxënësve) apo të shkëlqyeshëm (rreth 30% e nxënësve). Shumica e nxënësve kanë arritje në nivelet 2, 3 dhe 4, ndërsa minimale kanë arritje në nivelet 5 dhe 6, nivele që pasqyrojnë arritshmërinë sipas sistemit të vlerësimit shumë mirë dhe shkëlqyeshëm.



*Grafiku 11: Rezultatet e nxënësve në Gjuhë shqipe dhe në Matematikë sipas deklarimit të nxënësve për rezultatet e tyre në lëndën e Gjuhës shqipe dhe të Matematikës gjatë vitit shkollor.*

Rezultatet e grafikut më sipër tregojnë se arritjet e nxënësve në vlerësimin e realizuar në kuadër të këtij studimi janë shumë më të ulëta edhe te grupi i nxënësve që kanë suksese të larta në nivel shkolle. Në anën tjetër, deklaratimet e nxënësve për suksesin e tyre në shkollë reflektojnë trendët e notës mesatare të nxënësve në këto dy lëndë mësimore në fund të vitit shkollor 2020/2021, ku sipas raporteve të shkollave të përfshira në hulumtim nota mesatare e nxënësve të klasës së shtatë, paraleleve që ishin pjesë e studimit, në lëndën Gjuhë shqipe është 3.5 ose 70%, ndërsa në lëndën e Matematikës është 3.3 ose 66%. Mirëpo, këto rezultate dallojnë dukshëm me rezultatet e vlerësimit


të realizuar me nxënës në kuadër të këtij studimi, ku arritshmëria në lëndën e Gjuhës shqipe është 41%, ndërsa në lëndën e Matematikës është 48%.

Ndërlidhur me deklaratimet e nxënësve për suksesin në lëndën e Matematikës në vitin përkatës, ka rezultuar të kemi një ndërlidhje të këtij sukcesi me pikët e fituara në testin e Matematikës të nxënësit, të cilët deklaruan se kanë sukses të pamjaftueshëm. Mbi 65 % e nxënësve që deklaruan se kanë sukses të pamjaftueshëm, në vlerësimin e bërë në kuadër të këtij studimi kanë arritshmëri në nivelet 1 dhe 2, që sipas sistemit të vlerësimit formal janë notë e pamjaftueshme apo 1. Kjo e dhënë deri dikur tregon se një pjesë e madhe e nxënësve i njohin mangësitë e tyre në mësim në raport me lëndët specifike, por atyre u mungon angazhimi personal dhe përkrahja institucionale për përmirësim dhe avancim në mësim.

**Rezultatet e nxënësve sipas posedimit të pajisjeve të TIK-ut dhe përcjelljes së video-orëve mësimore në RTK.** Pavarësisht nga mungesat që nxënësit i kanë lidhur me pajisjen me teknologji të informacionit (laptop, kompjuter, rrjet interneti), arritjet e nxënësve janë të ulëta, nën mesatare. Nxënësit me mungesë të pajisjeve të teknologjisë kanë arritshmëri më të ulët për 5% se mesatarja e arritshmërisë në Gjuhë shqipe (42%) dhe për 3% më të ulët se mesatarja e arritshmërisë në lëndën e Matematikës (48%).

Sa i përket mësimin në distancë përmes shfaqjes së video-orëve mësimore në RTK, siç e kemi përshkruar më lart, MASHTI për shkak të rreziqeve të mëdha nga pandemia për të kaluar i gjithë arsimit parauniversitar në skanerin C të mësimin - mësim në distancë, gjatë gjithë vitit shkollor organizoi mësimin në distancë përmes RTK-së. Në analizën krahasuese të nxënësve që kanë përcjellë orët e mësimin në RTK me rezultatet e vlerësimit në këtë studim, shohim se nxënësit të cilët i kanë përcjellë më gjatë orët e mësimin në RTK kanë arritshmëri më të lartë, kundrejt nxënësve që i kanë përcjellë vetëm disa orë mësimore, apo asnjë orë mësimore nuk e kanë përcjellë.


Grafiku në vijim prezanton arritjet në lëndën e Gjuhës shqipe në raport me deklaratimet e nxënësve për përcjelljen e orëve mësimore të shfaqura në RTK.



Grafiku 12: Arritjet e nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe - sipas 6 niveleve të arritjeve në raport me deklaratimet e nxënësve për përcjelljen e orëve mësimore të shfaqura në RTK.

Rezultatet e grafikut më sipër tregojnë se rreth 75% e nxënësve që asnjëherë nuk i kanë përcjellë video-ligjëratat e orëve mësimore të shfaqura në RTK kanë arritshmëri në nivelet 1 dhe 2 në lëndën e Gjuhës shqipe. Ndërsa në këto dy nivele të arritjeve (nivelet 1 dhe 2) janë rreth 45% e nxënësve që i kanë përcjellë të gjitha video-ligjëratat e orëve mësimore të shfaqura në RTK. Në këtë rast të ilustruar, rreth 30% është numri më i madh i nxënësve që kanë arritshmëri të ulët dhe që nuk i kanë përcjellë asnjëherë orët e mësimimit në RTK, kundrejt nxënësve që i kanë përcjellë të gjitha orët e mësimimit në RTK.

Rezultate të përafërta pasqyrohen edhe në nivelet e arritjeve në lëndën e Matematikës, të cilat ilustrohen në grafikun në vijim.



Grafiku 13: Arritjet e nxënësve në lëndën e Matematikës - sipas 6 niveleve të arritjeve në raport me deklarimet e nxënësve për përcjelljen e orëve mësimore të shfaqura në RTK.

Referuar rezultateve të grafikut më sipër, asnjë nxënës që asnjëherë apo vetëm disa orë i ka përcjellë video-ligjëratat e orëve mësimore nuk ka arritje në nivelin e gjashtë. Ndërsa në nivelet e arritjeve 1 dhe 2 janë rreth 50% e nxënësve.

### 6.3. Mësimi në kushtet e pandemisë nga perspektiva e drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve

Rezultatet e studimit me drejtorë të shkollave dhe me mësimdhënës janë paraqitur brenda një strukture të temave të sistemuara, që mbulojnë përgatitjet dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, përkrahjen e mësimdhënësve, planifikimin mësimor dhe zbatimin e kurrikulës në këto kushte. Po ashtu mësimin online nga mësimdhënësit e shkollës dhe mësimin përmes RTK-së, si dhe angazhimin e nxënësve në mësim, rezultatet dhe humbjet mësimore. Përfshirja e drejtorëve dhe mësimdhënësve në këtë studim, por edhe e nxënësve dhe prindërve, është bërë me qëllim të krijimit



të një trekëndëshi për të shqyrtuar nevojat e politikave e praktikave, duke kërkuar integrimin e pikëpamjeve (Bradshw, J., 2014) të të gjithë aktorëve që lidhen me problemin e studimit.


### ***6.3.1. Përgatitjet e shkollave për fillimin e vitit shkollor 2020/2021 dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë***

Situata e pandemisë me Covid-19 në Kosovë ende vazhdon të jetë e pranishme. Në varësi të situatës epidemiologjike në vend, shkollat i kanë bërë përgatitjet e nevojshme për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021 dhe kanë ndërmarrë masa të ndryshme parandaluese, sipas protokolleve zyrtare, për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, të përshkruara në kapitullin e dytë.

Sa u përket përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor, drejtuesit e shkollave dhe mësime të cilët janë shprehur se janë përgatitur në masë të mirë për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë. Kështu, për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë rreth 23.8% e drejtorëve pohojnë se janë përgatitur plotësisht, 61.9% pohojnë se janë përgatitur në masë të mirë, 12.7% janë përgatitur deri në njëfarë mase dhe 1.6% e drejtorëve pohojnë se janë përgatitur pak për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë. Në anën tjetër, edhe pjesa më e madhe e mësime të cilët janë anketuarve, apo 62.8%, janë deklaruar se në masë të mirë kanë arritur të përgatiten për të organizuar mësimin në kushtet e pandemisë, 26.4% prej tyre këtë e bëjnë deri në njëfarë mase, kurse 9.5% plotësisht.

Nga këto të dhëna shohim se në pjesën më të madhe të shkollave nuk është arritur që plotësisht të bëhen përgatitjet për fillimin dhe organizimin e vitit shkollor. Po ashtu, shohim se ka një dallim ndërmjet drejtorëve të shkollave dhe mësime të cilët në raport me perceptimin e tyre për zhvillimin e përgatitjeve të plota, pasi drejtorët janë shprehur në përqindje më të lartë se kanë arritur që plotësisht të përgatiten, kundrejt mësime të cilët në përqindje më të vogël e ndajnë këtë mendim. Në anën tjetër mësime të cilët në përqindje më të lartë janë shprehur se deri në njëfarë mase janë përgatitur për fillimin dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë. Këto dallime dhe përgjithësisht niveli i qëndrimeve të drejtorëve dhe mësime të cilët

lidhur me përgatitjet dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë pasqyrohen në grafikun në vijim.



*Grafiku 14. Qëndrimi i drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve lidhur me përgatitjet për fillimin dhe organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021.*

Këto të dhëna tregojnë se ka dallime ndërmjet shkollave në përgatitjet e tyre për fillimin dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë. Statistikisht nuk ka dallime të theksuara në nivelin e qëndrimeve të drejtorëve dhe mësimdhënësve lidhur me përgatitjet dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, për sa i përket komunës, sipas shkollës ku punojnë, fshat apo qytet, apo edhe nivelit të arsimit fillor dhe ShMU-së.

Për të mësuar se sa drejtorët e shkollave janë informuar dhe përkrahur nga institucionet gjegjëse (DKA, MASHTI dhe IKShPK) për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021, kemi shtruar një pyetje lidhur me vlerësimin e përkrahjes dhe informacioneve të marra nga secili institucion me të cilin shkollat kanë bashkëpunuar në përgatitjet dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë. Vlerësimet e drejtorëve prezantohen në tabelën në vijim.

**Tabela 2:** Vlerësimi i drejtorëve të shkollave për përkrahjen dhe informacionet që kanë marrë nga DKA, MASHTI dhe IKShPK për fillimin dhe organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021.


Institucionet	Tejet të shpërndara dhe të paqarta		Të pamjaftueshme		Deri diku të mjaftueshme		Të mjaftueshme		Të plota dhe praktike		M	SD
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%		
DKA	1	1.6	2	3.2	9	14.3	23	36.5	28	44.4	4.19	.913
MASHTI	1	1.6	8	12.7	10	1.6	36	57.1	8	12.7	3.69	.934
IKShP	1	1.6	2	3.2	13	20.6	27	42.9	20	31.7	4.05	.865

Referuar rezultateve të dhëna në tabelën numër 2, në përgjithësi vlerësohen pozitivisht përkrahja dhe informacionet që i kanë marrë nga institucionet gjegjëse. Vlerësime më të larta janë dhënë për përkrahjen dhe informacionet që kanë marrë nga DKA-ja dhe IKSh, kundrejt vlerësimeve për MASHTI-n.

Pjesë e përgatitjeve dhe organizimit të mësimit në kushtet e pandemisë ishin edhe ndarja e nxënësve në grupe, me qëllim të zvogëlimit të numrit të nxënësve në klasa për kujdes më të shtuar nga pandemia, si dhe mësimi sipas tre skenarëve të mësimit të miratuar nga IKShPK-ja dhe të përshkruar në udhëzuesit për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021.

Sa i përket masës së ndarjes së nxënësve në dy grupe, ishte masë e vendosur për shkollat që mbanin mësim me prani fizike, sipas skenarëve të mësimit A dhe B. Kështu, referuar mësimdhënësve të përfshirë në këtë hulumtim, në mungesë të hapësirës së mjaftueshme të paraparë për nxënës në kushte pandemie, në shumicën e shkollave, ata janë ndarë në grupe me 11–15 dhe 16-20 nxënës, në varësi të numrit të nxënësve në klasat gjegjëse. Këtë e pohojnë 72.8% e mësimdhënësve të anketuar, kurse 27.2% prej tyre deklarojnë se nuk i ndajnë në grupe, sepse klasat e tyre nuk kanë numër të madh të nxënësve. Kjo e fundit kryesisht është e shprehur në zonat rurale.

Referuar informacioneve të marra nga drejtorët e shkollave dhe mësimeve të përfshirë në këtë hulumtim, gjatë vitit shkollor 2020/2021, rreth 84 % e shkollave kanë punuar sipas skenarit A të mësimit, me prani fizike të nxënësve dhe mësimeve të tyre. Shkollat e tjera kanë punuar sipas skenarit B dhe sipas skenarit C të mësimit, në rastet kur janë mbyllur si shkollë apo të mbylljes në shkallë vendi, për shkak të situatës epidemiologjike në shkallë vendi. Kjo e dhënë është e përafërt me raportin e Inspektoratit të Arsimit për mbarëvajtjen e mësimit sipas skenarëve A, B dhe C për secilën komunë në nivel vendi, nga dt. 14.09.2020-26.03.2021, pasqyrohen të dhëna për numrin e shkollave në secilën komunë që gjatë kësaj periudhe kanë punuar me skenarin A, skenarin B dhe skenarin C të mësimit.




Grafiku 15. Organizimi i mësimit sipas skenarëve, sipas niveleve të arsimit.

Nxënësit e arsimit fillor kryesisht i kanë ndjekur skenarin A të mësimit dhe skenarin C të mësimit, për shkak të mbylljes si shkollë apo të mbylljes së përgjithshme në shkallë vendi.

Në anën tjetër, me gjithë përpjekjet, nuk kemi arritur që të sigurojmë të dhëna të sakta se sa javë të mësimit ka punuar secila shkollë e përfshirë në këtë hulumtim me skenarin C të mësimit, për shkak të mbylljes si shkollë dhe mbylljes së përgjithshme.

Lidhur me efektivitetin e organizimit të mësimit sipas skenarëve të mësimit, mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave të përfshirë në hulumtim kanë qëndrime të përafërta, me disa dallime të vogla, ku nga perspektiva e mësimitdhënësve kemi një nuancë më të lartë të vlerësimit për efektivitetin e mësimit. Kështu, rreth 9% të mësimitdhënësve deklarohen se ky organizim është plotësisht efektiv, kurse 23.7% shprehen se është shumë efektiv. 62.7% deri diku është efektiv, 4.9% prej tyre mendojnë se ishte pak ose aspak efektiv.

Në anën tjetër, rreth 4.8% e drejtorëve pohojnë se organizmi i mësimit gjatë këtij viti shkollor, në kushtet e pandemisë, ishte plotësisht efektiv, 19% e tyre pohojnë se ishte shumë efektiv, 74.6% e drejtorëve pohojnë se ishte deri diku efektiv dhe 1.6% pohojnë se organizmi i mësimit gjatë këtij viti shkollor, në kushtet e pandemisë, ishte pak efektiv. Mesatarja e rezultateve,  $M=3.22$ , ndërsa  $DS=0.522$ . Në përgjithësi drejtorët e shkollave shprehin mendimin se mësimi ishte mesatarisht efektiv në kushtet e pandemisë dhe devijimi standard tregon për një grupim rreth vlerës mesatare. Këto dallime dhe përgjithësisht niveli i qëndrimeve të drejtorëve dhe mësimitdhënësve lidhur me efektivitetin e organizimit të mësimit sipas skenarëve të mësimit pasqyrohen në grafikun në vijim.



Grafiku 16. Qëndrimi i drejtorëve të shkollave dhe mësimitdhënësve lidhur me efektivitetin e organizimit të mësimit sipas skenarëve të mësimit.

Sipas drejtorëve të shkollave, organizimi i mësimit gjatë këtij viti shkollor ka qenë tejet sfidues dhe në vazhdimësi është përcjellë me shqetësime të shumta. Sfidat, shqetësimet kryesore që lidhen me organizimin e mësimit dhe efektivitetin e mësimit në kushtet e pandemisë, të cilat theksohen nga një pjesë e madhe e mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave janë si në vijim:

- Mungesa e mjeteve të TIK-ut për zhvillimin e mësimit në distancë, mungesa e trajnimeve për E-mësim, mungesa e pajisjeve të TIK-ut, rrjeti i dobët i internetit, mungesa e një platforme unike për mësim etj.
- Ndryshimi i qasjes në mësim, ndarja e nxënësve në grupe, orët mësimore të shkurtra;
- Mbajtja e maskave gjatë mësimit;
- Ngarkesa e mësimitdhënësve, kalimi nga skenari A në skenarin C;
- Pamundësia për zëvendësimin e mësimitdhënësve, të cilët janë infektuar me virusin COVID-19 gjatë vitit shkollor;
- Frika nga infektimi me virusin COVID-19, udhëtimi i mësimitdhënësve dhe nxënësve dhe rreziku nga virusi;
- Mungesa të shpeshta të nxënësve dhe mësimitdhënësve për shkak të infektimeve dhe rreziqeve nga virusi;
- Lodhja e mësimitdhënësve dhe stafit;
- Kriza emocionale - psikologjike e nxënësve, përgjegjësia e komunitetit të shkollës, frika...;
- Performanca e nxënësve.


### ***6.3.2. Përfshirja e mësimitdhënësve në aktivitetet e zhvillimit profesional gjatë pandemisë***

Në kuadër të Udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021, janë dhënë orientime lidhur me trajnimin e mësimitdhënësve, personelit menaxherial dhe përkrahës të shkollave dhe aktorëve të tjerë, orientime të cilat më shumë i referohen rolit të MASHTI-t

dhe DKA-ve për trajnimin e mësimit dhe të personelit menaxhues të shkollave. Pra, në Udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021 nuk janë përvijuar udhëzime specifike për rolin e shkollave në ZhPM gjatë pandemisë, pavarësisht faktit se shkollat kanë autonomi dhe përgjegjësi të veçanta në mbështetjen e proceseve për ZhPM dhe në zhvillimin profesional me bazë në shkollë.

Për qëllime të hulumtimit, mësimit dhe të personelit menaxhues u është kërkuar që të tregojnë pjesëmarrjen e tyre në trajnime gjatë vitit shkollor 2020/2021, ndërsa drejtorëve të shkollave, përveç të dhënave për përfshirjen e mësimit dhe të personelit menaxhues në trajnime, u është kërkuar që të përshkruajnë shkurtimisht çfarë ka bërë shkolla e tyre për përkrahjen e mësimit dhe të personelit menaxhues – ZhPM gjatë këtij viti shkollor.

Të dhënat e dala nga hulumtimi, referuar përgjigjeve të mësimit dhe të personelit menaxhues, tregojnë se zhvillimi profesional i mësimit dhe të personelit menaxhues të një shkolle edhe në kushtet e pandemisë ndryshon shumë, nga mundësia e përfshirjes së një mësimit dhe të personelit menaxhues në disa programe dhe aktivitete të zhvillimit profesional, deri te mospjesëmarrja e mësimit dhe të personelit menaxhues në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional. Kështu, sipas deklarimeve të mësimit dhe të personelit menaxhues të përfshirë në hulumtim, 34.6% e mësimit dhe të personelit menaxhues kanë qenë të përfshirë vetëm në një program trajnimi gjatë periudhës së pandemisë, 28% në dy programe trajnimi, 17.8% në tri programe trajnimi, 9.1% më shumë se tri programe. Pjesa tjetër, rreth 5%, kanë marrë pjesë vetëm në aktivitetet profesionale të zhvilluara me bazë në shkollë, kurse rreth 6% nuk kanë marrë pjesë në asnjë formë të zhvillimit profesional gjatë periudhës së pandemisë. Grafiku në vijim prezanton përfshirjen e mësimit dhe të personelit menaxhues në trajnime gjatë periudhës së pandemisë, sipas deklarimeve të vetë mësimit dhe të personelit menaxhues të përfshirë në hulumtim.



*Grafiku 17. Përfshirja e mësimitdhënësve në trajnime gjatë periudhës së pandemisë, sipas deklaramëve të vetë mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim.*

Hulumtimi me drejtorët tregon se një përqindje e drejtorëve të shkollave, rreth 3%, nuk kanë pasur informata për trajnimet që i kanë ndjekur mësimitdhënësit në kushtet e pandemisë. Mungesa e evidencës së mësimitdhënësve për pjesëmarrje në zhvillim profesional gjatë pandemisë vërehet edhe në përqindjet që drejtorët ofrojnë për numrin e pjesëmarrjes së mësimitdhënësve në trajnime, ku sipas drejtorëve të shkollave, në bazë të evidencave të tyre, rreth 12 % e mësimitdhënësve nuk kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara gjatë periudhës së pandemisë.

Sipas përshkrimeve të drejtorëve të shkollave lidhur me përkrahjen e mësimitdhënësve për zhvillim profesional nga shkolla, ka dallime në mes të shkollave në mënyrën se si janë përkrahur mësimitdhënësit gjatë kësaj periudhe. Kështu, rreth 13% e drejtorëve nuk kanë dhënë përgjigje për asnjë formë të përkrahjes nga shkolla, 4.8% pohojnë se janë mbajtur punëtori me bazë në shkollë dhe të organizuara nga GIZ, 3.2% pohojnë se mësimitdhënësit janë përkrahur lidhur me mbajtjen e mësimit online, platformat ZOOM, Google Clasroom etj., 3.2% pohojnë se i kanë mbështetur që të zbatohen masat e IKShPK-së, 19.2% pohojnë se kanë organizuar trajnime me bazë në shkollë, me SBASHK-un, DKA-të dhe Bankën Botërore, GIZ, 9.6% kanë bërë përgatitje teknike dhe përkrahje teknike në aspektet e digjitalizimit,



3.2% pohojnë se kanë organizuar punëtori e trajnime, temat e punëtorive dhe trajnimeve, 3.2% pohojnë se kanë bërë sigurimin e infrastrukturës, 4.8% kanë organizuar takime javore online, punëtori, përkrahje mësimdhënësve të moshuar, 16% kanë organizuar trajnime online për platformat online dhe TIK. Ndërsa përqindja tjetër e drejtorëve i referohen mbështetjes në informim për trajnime, krijimin e masave lehtësuese, vendosjen e internetit, zëvendësimet e mësimdhënësve që kanë munguar, mbështetje me materiale mësimore etj.

Referuar mendimeve të drejtorëve të shkollave, bashkëpunimi në mes të mësimdhënësve për realizimin e mësimi në kushte pandemie është rritur, si për konsultime profesionale ashtu edhe për aspektet organizative. Rreth 14 % e drejtorëve pohojnë se mësimdhënësit janë mobilizuar shumë për bashkëpunim me kolegët në nivel shkolle, 69.8% e tyre pohojnë se mësimdhënësit çdo ditë e më shumë po bashkëpunojnë ndërmjet vete, rreth 14 % e drejtorëve pohojnë se mësimdhënësit deri diku po bashkëpunojnë, ndërsa rreth 2% e drejtorëve pohojnë se disa mësimdhënës nuk po shprehin interesim për bashkëpunim me kolegët në nivel shkolle.

### ***6.3.3. Planifikimi mësimor dhe zbatimi i kurrikulës gjatë pandemisë***


Udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimi në vitin shkollor 2020/2021 parasheh që arritja e kompetencave dhe rezultateve të nxënësit të fushës (RNF) dhe të lëndëve të caktuara (RNL) është e mundshme të bëhet edhe me numër të reduktuar të njësive mësimore (deri në 80%), sipas një plani mësimor të organizuar mirë dhe me qasjen e mësimi të integruar. Mirëpo, nuk ofrohen udhëzime specifike se si shkollat, gjegjësisht mësimdhënësit, duhet t'u qasen planifikimeve për zbatimin e kurrikulës, cilat tema duhet hiqen nga 20 % i reduktimit të përmbajtjeve programore, kush duhet ta bëjë dhe kur, si të merren për bazë zhvillimet e vitit shkollor paraprak në raport me realizimin e kurrikulave në këtë vit etj.

Për qëllime të hulumtimit, me pyetësorët e administruar për mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave të përfshira në hulumtim, kemi diskutuar aspektin e udhëzimeve të marra në forma të ndryshme për planifikimet mësimore dhe

modelet e planifikimeve të përdorura nga mësimitdhënësit gjatë këtij viti shkollor.

Lidhur me udhëzimet për planifikimet mësimore dhe realizimin e kurrikulave/programeve mësimore, 44.30% të mësimitdhënësve shprehen se kishin udhëzime të mjaftueshme, 34% deri diku të mjaftueshme, 8.50% të pamjaftueshme, kurse 7.90% mendojnë udhëzimet që i kanë marrë kanë qenë të plota dhe praktike. Ndërsa, 5.40 e mësimitdhënësve kanë deklaruar se nuk kanë marrë kurrfarë udhëzimi. Nuk ka dallime domethënëse në mes qëndrimeve të mësimitdhënësve të nivelit të parë nga ata të nivelit të dytë e as nga mësimitdhënësit që punojnë në vendbanime rurale me ata të vendbanimeve urbane.


Grafiku në vijim prezanton qëndrimet e mësimitdhënësve lidhur me udhëzimet për planifikimet mësimore dhe realizimin e kurrikulave gjatë periudhës së pandemisë.



*Grafiku 18. Qëndrimi i mësimitdhënësve lidhur me udhëzimet që kanë marrë për planifikimet mësimore dhe realizimin e kurrikulave.*

Mësimitdhënësit udhëzimet për planifikimet mësimore dhe realizimin e kurrikulave gjatë pandemisë i ndërlidhin me të drejtën për t'i marrë të gatshme apo për t'i adaptuar planifikimet mësimore të zhvilluara nga ekipet profesionale të Komunës së Prishtinës. Në raport me planifikimet mësimore, sipas të dhënave nga hulumtimi, rezulton se pjesa dërmuese e mësimitdhënësve apo më saktësisht, 83.9% punojnë me planet e Komunës së


Prishtinës, të shpërndara në gjithë Kosovën, 8.6% me plane të hartuara në fillim të vitit nga aktivet profesionale, kurse 5.4% punojnë me plane të hartuara në mënyrë individuale. Vetëm 1.7% prej tyre punojnë me planet e vitit paraprak.



Grafiku 19. Informimi i mësimit të punës së tyre lidhur me planifikimet mësimore

Faktin se pjesa më e madhe e mësimit të punës gjatë vitit shkollor 2020/2021 kanë punuar me planifikimet mësimore të hartuara nga ekipet profesionale të mësimit të Komunës së Prishtinës e vërtetojnë edhe drejtorët e shkollave, të cilët ishin pjesë e këtij hulumtimi.

Sfidat, shqetësimet kryesore me të cilat mësimit janë ballafaquar në zbatimin e kurrikulës gjatë këtij viti shkollor, sipas deklarimeve të vetë mësimit, janë të shumta. Ndër to, kryesore mbeten cilësia e mësimit në kushtet e pandemisë, cilësia e qasjeve të mësimit që i praktikojnë mësimit gjatë mësimit në distancë, pastaj vlerësimi i nxënësve, mungesa e teknologjisë të mësimit dhe të nxënësve etj. Ajo që dominon më së shumti, sipas mësimit, është realizimi i diskutimit, punëve në grup, punëve të pavarura etj., me 66.0%, pastaj realizimi i vlerësimit të shkallës së përvetimit të njohurive me 38.7%, si dhe planifikimi për orët mësimore me 27.7%. Me një përqindje më të vogël përfaqësohen realizimi i shpjegimit të njohurive teorike dhe dhënia e detyrave të klasës dhe të shtëpisë me 18.7%, përkatësisht 14.3%.



Grafiku 20. Qëndrimi i mësimeve lidhur me sfidat me të cilat janë ballafaquar gjatë punës me nxënës.

Sfidën që lidhet me realizimin e diskutimit në mësim, punë në grup, punë të pavarura me nxënës, mësimeve lidhur me kohëzgjatjen e orës mësimore, e cila në numrin më të madh të shkollave është sa gjysma e orës së rregullt mësimore dhe brenda kësaj kohë është e pamundur të bëhen të gjitha. “Koha e orës mësimore është e shkurtër. Arritja e qëllimeve për një njësi mësimore, organizimi i grupeve, kontrollimi i detyrave të shtëpisë dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve brenda 30 minutave, ishte e pamundur”, thekson një mësimeve. “Koha e pamjaftueshme me orët prej 25 minutash paraqet sfidë për realizim dhe shpjegim të njohurive teorike e ushtrimeve, si dhe për vlerësim”, shton tjetri. *Funksionimi i klasës si tërësi - prania fizike e tërë klasës, kohëzgjatja e pamjaftueshme e orës mësimore, pamundësia e realizimit të diskutimit, punës në grupe, planifikimi i orëve mësimore për 3 etapat e orës, përvetësimi i njohurive, realizimi i vlerësimit të shkallës së përvetësimit të njohurive, janë sfida të përditshme me të cilat ballafaqohemi*”, shprehet një tjetër mësimeve.

Bazuar në të dhënat e dala nga hulumtimi rreth aspektit të ngarkesës së mësimeve gjatë mësimit në kushtet e pandemisë, del se ata ishin shumë të ngarkuar gjatë gjithë vitit mësimor.

“Mësimeve kanë qenë mjaft të ngarkuar në aspektin psikologjik dhe fizik, sepse ishin shumë faktorë që ndërlihdeshin mes veti si, stresi pastaj,

*përqendrimi i nxënësve në mësim, frika nga infektimi në masë të madhe, forma për realizimin e plan programit etj.”, shprehet një mësimdhënës.*

*“Puna me dy grupe e ka rritur numrin e orëve mësimore, puna gjatë ditëve të vikendit për të kompensuar orët e humbura, si dhe mbajtja e mësimit plotësues po ashtu kanë ndikuar në rritjen e ngarkesës së mësimdhënësve”, shton një mësimdhënës tjetër.*

Mësimdhënësit theksojnë edhe faktorë e tjerë që e ngarkojnë edhe më shumë punën e tyre. *“Krahas preokupimit për realizimin e plan-programit dhe arritjen e rezultateve të të nxënësve, mësimdhënësit këtë vit ishin të ngarkuar edhe me shqetësimin për mbrojtjen e mirëqenies personale dhe kolektive”, deklaron një mësimdhënës.*


*“Përkundër ngarkesës psikologjike gjatë pandemisë, ne po ashtu kemi qenë të ngarkuar edhe me çështje administrative, pasi përveç mësimëve është kërkuar me detaje plotësimi i shumë dokumenteve në lidhje me njësitë mësimore, pasi që ne më tepër jemi ngarkuar me letra ‘koti’, që na merrnin kohë, sesa me mësimdhënie”, vazhdon tjetri.*

Ngarkesën e mësimdhënësve gjatë mësimit në kushte të pandemisë e theksojnë edhe drejtorët e shkollave të përfshira në hulumtim. Në kërkesën që të përshkruajnë shkurtimisht si e shohin aspektin e ngarkesës së mësimdhënësve gjatë mësimit në kushtet e pandemisë, rreth 80% e drejtorëve të shkollave në përshkrimet e tyre për këtë aspekt ngarkesën e mësimdhënësve e ndërlidhin me aspektet emocionale, psikike, shëndetësore, fizike, orarin e zgjatur gjatë punës me dy grupe të nxënësve. Disa drejtorë të shkollave mungesën e teknologjisë, mungesën e kompetencës digjitale të mësimdhënësve, mungesën e mjeteve të konkretizimit për mësim në kushtet e pandemisë, si dhe mospërputhjen e teksteve shkollore me programet mësimore, i paraqesin si ngarkesë të mësimdhënësve gjatë mësimit në kushtet e pandemisë.

#### ***6.3.4. Mësimi online dhe mësimi përmes RTK-së gjatë pandemisë***

Në pyetjen drejtuar mësimdhënësve se sa shpesh e kanë praktikuar mësimin online gjatë këtij viti shkollor (2020/2021), rreth 19 % e mësimdhënësve

janë shprehur se mësimin online e kanë praktikuar shpesh ose shumë shpesh, rreth 40 % ndonjëherë, 18% rrallë, kurse 22.6% nuk e kanë përdorur asnjëherë. Figura në vijim pasqyron shpeshhtësinë e aplikimit të mëimit online gjatë këtij viti shkollor nga ana e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim.



*Grafiku 21. Qëndrimi i mësimdhënësve lidhur me aplikimin e mëimit online gjatë vitit shkollor 2020/2021.*


Mësimdhënësit, të cilët janë shprehur se mësimin online e kanë praktikuar shpesh ose shumë shpesh, kryesisht janë mësimdhënës që gjatë këtij viti shkollor kanë mbajtur mësim me skenarët e mëimit B dhe C, në faza të caktuara të vitit shkollor. Përveç mëimit online në TV dhe në kanalën “YouTube”, disa mësimdhënës janë shprehur se i kanë përdorur platformat Zoom, Google classroom, Teams, Skype, Moodle etj. Platformat më të përdorura për mbajtjen e mëimit online nga mësimdhënësit janë Zoom me 78.6% dhe Google classroom me 23.7%. Ndërsa, platformat Google Meet, Microsoft Teams janë një përqindje e vogël e mësimdhënësve që kanë deklaruar se ia kanë përdorur gjatë mëimit online me nxënësit e tyre.

Mësimi online dhe përgjithësisht mësimdhënia digjitale kërkojnë në radhë të parë zhvillim të kompetencave digjitale të mësimdhënësve. Edhe këtë aspekt e kemi hulumtuar duke marrë mendimet e drejtorëve të shkollave për kompetencat digjitale të mësimdhënësve dhe vetëvlerësimet e mësimdhënësve për kompetencat e tyre digjitale.

Rreth 1.6% e drejtorëve pohojnë se mësimitdhënësit kanë kompetenca të avancuara digjitale, 33.3% pohojnë se mësimitdhënësit kanë kompetenca të mjaftueshme, 54% pohojnë se mësimitdhënësit kanë deri diku kompetenca të mjaftueshme, 3.2% e drejtorëve pohojnë se mësimitdhënësit kanë mungesë në kompetenca dhe 7.9% pohojnë se mësimitdhënësit kanë kompetenca minimale për zbatimin e mësimit online.

Mesatarja e rezultateve,  $M=3.22$ ,  $DS=0.75$ . Rezultatet treguan se drejtorët e shkollave në përgjithësi kanë një qëndrim, se mësimitdhënësit i zotërojnë në nivel mestar kompetencat digjitale në mësimitdhënie. Qëndrimi i drejtorëve vërehet edhe në rezultatet e frekuencës, pasi mbi gjysma e drejtorëve konsiderojnë se mësimitdhënësit kompetencat digjitale i kanë deri diku të mjaftueshme.

Në anën tjetër, mësimitdhënësit kanë një vlerësim më të lartë për nivelin e kompetencave të tyre digjitale në mësimitdhënie. Rreth 63% e mësimitdhënësve janë shprehur se kanë nivel të mjaftueshëm ose të avancuar të kompetencave digjitale në mësimitdhënie, rreth 33% janë shprehur se kanë deri diku kompetenca të mjaftueshme, ndërsa më pak se 5% janë shprehur se kanë kompetenca minimale ose mungesë të kompetencave digjitale për mësimitdhënie. Figura në vijim prezanton vlerësimet e drejtorëve të shkollave dhe vetëvlerësimet e mësimitdhënësve për kompetencat digjitale për mësimitdhënie.



Grafiku 22. Vlerësimi i drejtorëve të shkollave dhe vetëvlerësimet e mësimitdhënësve për kompetencat digjitale në mësimitdhënie.

Mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim janë pyetur për përcjelljen nga ana e tyre të orëve mësimore që janë shfaqur në RTK dhe sa kanë ndihmuar orët mësimore të shfaqura çdo ditë në RTK që nxënësit e tyre të mësojnë më shumë. Sa i përket përcjelljes së orëve mësimore në RTK, mësimdhënësit përgjigjen se 17% e kanë përcjellë së paku një orë mësimi në ditë, 32.8% disa herë në javë, 12.2% disa herë në muaj, kurse 26.1% prej tyre kanë përcjellë vetëm disa orë në RTK. Nga të gjithë mësimdhënësit e anketuar, 11.8% nuk e kanë përcjellë as edhe një orë të vetme. Të dhënat tregojnë se një pjesë e madhe e mësimdhënësve nuk i kanë shikuar orët mësimore të shfaqura në televizionin publik dhe rrjedhimisht nuk kanë bërë ndërlidhje të mësimave me pritjet që nxënësit i përcjellin orët e mësimi të shfaqura përmes televizionit. Në anën tjetër, sipas mësimdhënësve orët mësimore që shfaqen në RTK nuk kanë ndihmuar shumë që nxënësit e tyre të mësojnë dhe të jenë më të mirë në mësim.

E-mësimi përmes shfaqjeve të orëve mësimore në RTK4 dhe në kanalën e MASHTI-t në 'YouTube' është zhvilluar gjatë gjithë vitit shkollor 2020/2021. E-mësimi gjatë këtij viti shkollor ishte në funksion të cilitdo skenar të mësimi, për shkollat që punonin me skenarin A të mësimi (mësimi në shkollë) si mundësi për t'i përdorur video-ligjëratat gjatë mësimi në klasë – ndonjë pjesë të tyre; për shkollat të cilat punonin me skenarin B të mësimi (mësim i kombinuar – prani fizike në shkollë dhe online/nga shtëpia) dhe veçanërisht për shkollat dhe nxënësit që punonin me skenarin C të mësimi (mësim online / nga shtëpia).

E-mësimi përmes video-ligjëratave të orëve mësimore ishte një prej mundësive për mësim online, në anën tjetër periudha e pandemisë tregoi se mësimi online duhet të shihet si një mundësi që të praktikohet jo vetëm në situata krize, siç ishte dhe vazhdon të jetë pandemia, por edhe në procese të rregullta të mësimi, për përmbajtje të caktuara, ngase lehtëson procesin e të nxënësit të nxënësve, racionalizon kohën, mjetet e konkretizimit dhe mundëson lidhjen e situatave me shembuj nga jeta dhe puna praktike.



### ***6.3.5. Angazhimi i nxënësve në mësim, bashkëpunimi me prindër, rezultatet e nxënësve dhe humbjet mësimore gjatë pandemisë***

**Angazhimi i nxënësve në mësim** gjatë periudhës së pandemisë perceptohet në mënyra të ndryshme nga ana e mësimitdhënësve. Referuar rezultateve të hulumtimit me mësimitdhënës, interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar gjatë këtij viti shkollor, në kushtet e pandemisë, reflektohet të jetë ndikuar nga organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë, qasja e punës së mësimitdhënësve me nxënës, niveli i bashkëpunimit me prindër, mjedisi i të nxënësve në shkollë dhe në shtëpi.


Marrë në përgjithësi punën e nxënësve gjatë këtij viti shkollor, pjesa më e madhe e mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim, 63% e mësimitdhënësve, janë shprehur se interesimi dhe angazhimi i nxënësve për mësim gjatë këtij viti ka qenë i mirë, në pajtim me rrethanat me të cilat është punuar. Një përqindje e mësimitdhënësve, rreth 9 %, janë shprehur se interesimi dhe angazhimi i nxënësve kanë qenë të lartë, ndërsa rreth 28 % e mësimitdhënësve janë shprehur se interesimi dhe angazhimi i nxënësve për mësim gjatë këtij viti shkollor kanë qenë jo në nivelin e pritur.

Krahasuar me vitet para pandemisë, sipas mësimitdhënësve, nxënësit kishin më pak kohë në kryerjen e obligimeve shkollore gjatë këtij viti shkollor, si angazhime në klasë, detyra në klasë, projekte, aktivitete interaktive etj. Në anën tjetër, nxënësit ishin më të ngarkuar me detyra të shtëpisë, për të cilat janë bërë përpjekje të ndryshme në menaxhimin e tyre, përfshirë platformat online dhe përmes bashkëpunimit me prindër.

**Bashkëpunimi me prindër për çështjet e mësimit.** Mësimitdhënësit ndajnë mendimin se prindërit kanë rol të rëndësishëm në mbështetjen e fëmijëve të tyre, organizimin e jetës shkollore, aktivitetet me nxënës në shkollë, si dhe për përmirësimin e punës në shkollë. Sipas mësimitdhënësve, jo të gjithë prindërit kanë bashkëpunuar me ta gjatë këtij viti shkollor dhe këtë mendim e ndajnë mbi 23% e mësimitdhënësve. Kurse, rreth 48% e mësimitdhënësve janë shprehur se prindërit deri diku po bashkëpunojnë me ta, ndërsa rreth 28% shprehen se kanë një bashkëpunim të mirë dhe në ngritje me prindërit e nxënësve të tyre. Në anën tjetër, bashkëpunimi i prindërve me udhëheqjen

e shkollës, këshillat e prindërve në nivel të shkollës, sipas rreth 51% drejtorëve të shkollave, ka shënuar rritje.

Grafiku në vijim pasqyron qëndrimin e mësimitdhënësve për bashkëpunimin e tyre me prindër për çështjet e mësimit në kushtet pandemisë dhe qëndrimin e drejtorëve të shkollave për bashkëpunimin e tyre me prindërit në nivel shkolle, të cilët kanë role të veçanta në nivel klase dhe shkolle.




Grafiku 23. Qëndrimi i mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave për bashkëpunimin me prindër gjatë mësimit në kushtet e pandemisë.

Bashkëpunimi me prindër për çështje të procesit mësimor dhe arritjet e nxënësve, sipas qëndrimeve të mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave, është më i mirë në shkollat urbane, kundrejt shkollave rurale, si dhe është më i shpeshtë në nivelin fillor krahasuar me arsimin e mesëm të ulët.

**Pabarazitë në mësim dhe humbjet mësimore.** Rezultatet e nxënësve kosovarë në PISA 2015 dhe PISA 2018 ishin ndër më të ulëtat nga vendet pjesëmarrëse në këtë studim. Ato, përveç tjerash, treguan edhe për pabarazi në arritjet e nxënësve, duke lënë të nënkuptohet se statusi socio-ekonomik në Kosovë ka ndikim në arritjet e nxënësve. Pandemia COVID-19 pritet të thellojë më tej pabarazitë në arritjet e nxënësve, si pasojë e kushteve socio-ekonomike, mungesës së pajisjeve dhe qasjes në internet, kur kemi parasysh se një pjesë e konsiderueshme e nxënësve kanë mbajtur mësim me skenarët B dhe C të mësimit. Drejtorët e shkollave dhe mësimitdhënësit e përfshirë në hulumtim nuk raportuan ndonjë të dhënë lidhur me pabarazitë në mësim të

nxënësve gjatë këtij viti shkollor, por një pjesë e relativisht e madhe e tyre, rreth 22% e mësimitdhënësve dhe rreth 18% e drejtorëve të shkollave, kanë qëndrim se pandemia ka ndikuar në rritjen më të madhe të pabarazive në mësim, të cilat reflektohen edhe në arritjet e nxënësve.

Mjedisi i të nxënit vlerësohet të jetë njëri prej faktorëve ndikues në rezultatet e nxënësve në kushtet e pandemisë. Në pyetjen drejtuar mësimitdhënësve, se sa vlerësoni se ka ndikuar mjedisi i të nxënit/mësuarit në kushtet e pandemisë në rezultatet e nxënësve, kemi dallime të theksuara në qëndrimet e mësimitdhënësve. Kështu, mbi 24 % e mësimitdhënësve shprehin qëndrim se mjedisi i të nxënit gjatë kësaj kohe ka ndikuar shumë në rezultatet e nxënësve, rreth 54% kanë qëndrim se ndikimi ka qenë deri diku (duke lënë të nënkuptohet se faktorët e tjerë kanë ndikuar më shumë), ndërsa mbi 22% kanë qëndrim se mjedisi mësimor ka pasur pak ndikim ose aspak në rezultatet e nxënësve. Figura në vijim pasqyron qëndrimin e mësimitdhënësve lidhur me ndikimin e mjedisit të të nxënit/mësuarit në rezultatet e nxënësve.



Grafiku 24. Qëndrimi i mësimitdhënësve lidhur me ndikimin e mjedisit të mësimin në rezultatet e nxënësve.

Referuar mendimeve të mësimitdhënësve dhe drejtorëve të përfshirë në hulumtim, gjatë periudhës së pandemisë humbjet në mësim kanë qenë mesatare, këtë e thonë mbi 59% e mësimitdhënësve dhe mbi 60% e drejtorëve të shkollave. Një pjesë e tyre, rreth 15% e mësimitdhënësve dhe rreth 10% e drejtorëve të shkollave, kanë mendim se humbjet e nxënësve në mësim janë shumë të mëdha. Kurse, pjesa tjetër e mësimitdhënësve dhe e drejtorëve të shkollave janë shprehur se nxënësit gjatë pandemisë nuk kanë humbur

shumë në mësim. Humbjet do të kompensohen shpejt, gjatë vitit vijues, por ka edhe një përqindje që nuk e kanë idenë për humbjet mësimore nga ndikimi i pandemisë, apo për humbje mësimore tejet të mëdha, të cilat nuk do të mund të kompensohen kurrë. Për këtë të fundit janë shprehur rreth 10 % e drejtorëve të shkollave.

Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave të përfshirë në hulumtim, edhe pse nuk i referohen ndonjë analize gjithëpërfshirëse, të bërë në shkollat e tyre lidhur me humbjet mësimore, ata i veçojnë disa lëndë mësimore për të cilat vlerësojnë se humbjet mësimore do të jenë më të mëdha. Dominojnë vlerësimet se humbjet do të jenë më të mëdha në gjuhë, matematikë dhe shkencat natyrore, si dhe në lëndët për të cilat gjatë pandemisë janë zvogëluar orët mësimore, përkatësisht në lëndët mësimore ku ka pasur më shumë humbje të orëve të mësimi, duke veçuar lëndët e shkathtësive.

Masat e planifikuara nga shkollat për zvogëlimin dhe eliminimin e humbjeve mësimore, sipas drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve, duhet të janë të shumta. Mbajtja e mësimi plotësues, shtues, aktivitetet individuale me nxënës, zëvendësimi i orëve të humbura, janë disa prej masave që sipas tyre janë planifikuar nga shkollat për zvogëlimin, eliminimin e humbjeve mësimore. Mirëpo, ata nuk ofrojnë ndonjë të dhënë më specifike për mënyrën e jetësimit të këtyre masave, kohëzgjatjen e tyre, përfshirjen e nxënësve etj.

Referuar mendimeve të drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve, në një numër të madh shkollash gjatë këtij viti shkollor janë ndërmarrë masa, të cilat vlerësojnë se i kanë kontribuar në masë të caktuar zvogëlimit të humbjeve mësimore, siç janë angazhimi i stafit të shkollës për masat anti-covid, planifikimi i rregullt i mësimi, bashkëpunimi ndërmjet aktiveve profesionale në zëvendësimin e njëri-tjetrit, bashkëpunimi me prindërit e nxënësve, bashkëpunimi nxënës-mësimdhënës nga shtëpia (sqarimi rreth mësimve të ndryshme nga ana praktike dhe teorike). Masa të tjera që janë ndërmarrë nga shkollat janë trajnimet rreth menaxhimit të pandemisë dhe përdorimit të teknologjisë informative, krijimi i kushteve në shkollë për përdorimin e teknologjisë në mësim, pajisja me mjete teknologjike e

fëmijëve me raste të rënda ekonomike, zgjatja e orëve mësimore në dy muajt e fundit të vitit mësimor etj. Mbetet të shihet se si shkollat nga viti i ri shkollor (2021/2022) do t'i qasen adresimit të humbjeve mësimore.

#### **6.4. Roli i prindërve në përkrahjen e fëmijëve në mësim gjatë pandemisë**

Rrethanat e krijuara nga pandemia krijuan një dimension të ri edhe sa i përket rolit të prindërve për përkrahjen e tyre në mësim. Referuar raportit të Bankës Botërore (2020), edhe në rrethanat më të mira, shumë prindër nuk janë të përgatitur për t'u përballur me të nxënit në distancë dhe mësimin në shtëpi, veçanërisht ata që nuk kanë njohuri mbi teknologjinë, kanë arsim e burime të kufizuara, kanë shumë fëmijë për të mbajtur, dhe që duhen të marrin vendime për shpërndarjen e një numri të pamjaftueshëm pajisjesh të teknologjisë së informacionit. Pjesa në vijim pasqyron pikëpamjet e prindërve për punën e tyre në përkrahjen e fëmijëve në mësim gjatë pandemisë.

**Puna e prindërve dhe përkrahja e fëmijëve.** Edhe puna e prindërve, sidomos e dy prindërve, ka ndikuar që një numër i konsiderueshëm i tyre të përballen me pamundësinë e përkrahjes së fëmijëve në mësim, përkatësisht qëndrimin afër fëmijëve, sidomos gjatë fazave të mësimin në distancë, mësimin nga shtëpia. Përqindja e prindërve të mostrës së hulumtimit që kanë deklaruar se kanë fëmijë në shkollë dhe që punojnë të dy prindërit është rreth 32%, që punojnë vetëm njëri prind është rreth 60% dhe dominon kryesisht babai (mbi 56 %). Ndërsa, rreth 8% e prindërve kanë deklaruar se nuk punon asnjëri prej tyre.

Në pyetjen *cili nga prindërit është marrë me përkrahjen e fëmijës gjatë procesit mësimor në kushte pandemie?*, përqindja e prindërve që janë deklaruar se janë marrë të dy prindërit me fëmijët e tyre është më e larta (mbi 48%), por me pak diferencë me ata që kanë deklaruar që me fëmijët janë marrë vetëm nënat (mbi 46%). Vlen të theksohet se vetëm babai kanë dhënë përgjigje 3.9% dhe që nuk janë marrë asnjëri prind janë deklaruar 1.2% (ose

10 prindër janë deklaruar se nuk janë marrë asnjëri me fëmijët e tyre gjatë procesit mësimor në kohën e pandemisë). Shih tabelën në vijim.

*Tabela 3. Përkrahja e fëmijëve nga prindërit gjatë procesit mësimor në kushte të pandemisë*

Cili nga prindërit është marrë me përkrahjen e fëmijës gjatë procesit mësimor në kushte të pandemisë?	Numri i prindërve	Përqindja
Nëna	381	46.1
Babai	32	3.9
Të dy	400	48.4
Asnjëri	10	1.2
Kujdestarja e shtëpisë	2	.2
Total	825	99.9
Missing	1	.1
Total	826	100.0

**Sigurimi i pajisjeve teknologjike për mësim.** Në rrethanat e mësimit në kushtet e pandemisë, sigurimi i pajisjeve teknologjike për mësim ishte nevojë dhe domosdoshmëri. Referuar deklaratave të prindërve, rreth 94 % e tyre janë shprehur se ata kanë pasur së paku një telefon të mençur, të cilin kanë pasur mundësi ta ndajnë me fëmijën e tyre për mësim në kushtet e pandemisë. Mirëpo, më shumë se gjysma e prindërve janë deklaruar se nuk kanë pasur kompjuter apo laptop që do të mund ta përdornin fëmijët e tyre për mësim. Në anën tjetër, mbi 6% e prindërve janë deklaruar se nuk kanë poseduar mjete teknologjike të mençura para situatës së krijuar me pandeminë COVID-19, që tregon se fëmijët e tyre nuk kanë pasur mundësi të ndjekin mësimet online pa së paku një mjet teknologjik.

Sa i përket sigurimit të pajisjeve teknologjike për mësim, 94.4% ose 780 prindër deklaruan se vetë i kanë siguruar pajisjet teknologjike, kryesisht telefona të mençur për të ndjekur nxënësit mësimet online, të cilët paraprakisht mbi 50% e fëmijëve e tyre i posedonin. Në anën tjetër, 9 prindër deklarohen që pajisjet teknologjike për fëmijët e tyre i ka siguruar shkolla, 2 prindër janë deklaruar se i ka mbështetur DKA-ja, 7 prindër deklaruan se

u mbështetën nga donatorët dhe 14 prindër u deklaruan se nuk i mbështeti askush dhe se fëmijët e tyre nuk kanë mundur të ndjekin mësimin online për mungesë të pajisjeve.

*Tabela 4. Deklarimi i prindërve për sigurimin e pajisjeve të TIK-ut për fëmijë/nxënës.*

		Numri i prindërve	Përqindja
Valid	Vetë	780	94.4
	Shkolla	9	1.1
	DKA-ja	2	.2
	Ministria	1	.1
	Donatorët	7	.8
	Askush	14	1.7
	Total	813	98.4
Missing		13	1.6
Total		826	100.0

Këto shifra na tregojnë për fillimin e mobilizimit të DKA-së, MAShTI-it dhe të donatorëve për të ofruar pajisje teknologjike për mësim aty ku ka nevojë, por që tregon se nuk ishin të mjaftueshme, për arsye se pjesa më e madhe e nxënësve gjatë mësimin online kanë mbajtur mësim kryesisht me telefona të mençur, në mungesë të kompjuterëve dhe laptopëve. Gjithashtu, këto të dhëna tregojnë se akoma nuk kemi një sistem gjithëpërfshirës për sigurimin e pajisjeve teknologjike për mësim online, me një barrë dhe angazhim kryesisht të prindërve.

Sigurimi i pajisjeve të TIK-ut për fëmijë/nxënës nga ana e prindërve shihet si një mundësi e mirë e përkujdesjes për fëmijët e tyre. Mirëpo, vetëm sigurimi i pajisjeve nuk siguron edhe përdorimin e drejtë dhe efikas të tyre. Në pyetjen drejtuar prindërve *si kanë qenë njohuritë dhe shkathtësitë tuaja për përdorimin e teknologjisë për t'i ofruar fëmijës ndihmë gjatë mësimin në distancë?*, sipas deklarimeve të vetë prindërve, shohim se një përqindje relativisht e madhe e tyre kishin vështirësi të theksuara në përkrahjen e fëmijëve. Këtë e thonë rreth 33% e prindërve dhe një pjesë e tyre deklaruan se kanë vështirësi të mëdha në këtë drejtim. Ndërsa, rreth 67 % e prindërve janë deklaruar se nuk kanë pasur probleme dhe kanë pasur njohuri për

përdorimin e teknologjisë për t'i ofruar fëmijës ndihmë gjatë mësimit në distancë.

**Ndryshimi i mënyrës së mësimit nga fëmijët, gjendja emocionale dhe raporti prindër-fëmijë.** Rrethanat e pandemisë ndikuan në shumë procese, përfshirë edhe ndryshimin në mënyrën e organizimit të punës në shkollë dhe të mësimit. Pas fazës së parë të pandemisë, kthimi në shkollë i nxënësve nga prindërit përshkruhet të ketë qenë me frikë dhe shqetësim nga virusi dhe përhapja e infeksioneve.

Organizimi i mësimit sipas skenarëve të mësimit në kushtet e pandemisë, mbajtja e distancës sociale nga fëmijët, mbajtja e maskave gjatë procesit mësues, mësimi online, orari i shkurtër i mësimit etj., sipas shumicës së prindërve (rreth 67% e tyre), kanë bërë që fëmijët e tyre të kenë vështirësi të theksuara për t'u adaptuar në mësim, të jenë të shqetësuar për ndryshimin e mënyrës së mësimit nga fëmijët e tyre dhe me frikë për rezultatet në mësim. Në anën tjetër, një përqindje relativisht e madhe e prindërve (rreth 33% e tyre) deklaruan se të fëmijët e tyre nuk kanë vërejtur shqetësime të tilla dhe se ata gradualisht po adaptohen me ndryshimet në mënyrën e mësimit.

Mirëqenia dhe ruajtja e shëndetit ishin primare me rastin e kthimit në shkollë, pas fazës së parë të pandemisë. Masat mbrojtëse, si distanca sociale, mbajtja e maskave dhe kujdesi higjienik, ishin masa për të cilat prindërit kanë kontribuar në informimin e fëmijëve të tyre për t'i respektuar ato gjatë gjithë vitit shkollor. Rreth 57 % e prindërve deklarojnë se këtë e kanë bërë vetë, sepse, sipas tyre, shkollat dhe mjetet e informimit publik nuk e kanë bërë mjaftueshëm një gjë të tillë. Pjesa tjetër e prindërve kanë deklaruar se nuk kanë pasur nevojë ta bëjnë një gjë të tillë, pasi që fëmijët e tyre vazhdimisht kanë marrë informacione nga shkolla për masat mbrojtëse nga covid-19.

Gjendja emocionale e fëmijëve gjatë qëndrimit në shtëpi, për shkak të rrethanave të imponuara nga pandemia, referuar prindërve të përfshirë në hulumtim, përshkruhet të ketë qenë e shprehur në mënyra të ndryshme. Rreth 29% e prindërve kanë deklaruar se fëmijët e tyre gjatë kësaj periudhe janë ndier shumë të vetmuar dhe e kanë shprehur dukshëm mungesën e



shoqërizimit. Një pjesë relativisht e madhe e prindërve deklarojnë se fëmijët e tyre gjatë qëndrimit në shtëpi shpesh kanë komunikuar me shokë/shoqe, që tregojnë se deri diku është mirëmbajtur pjesa e emocionale e qëndrueshme dhe e shoqërizimit, këtë e thonë rreth 41% e prindërve. Pjesa tjetër e prindërve, rreth 30%, janë shprehur se te fëmijët e tyre edhe gjatë qëndrimit në shtëpi nuk kanë vërejtur ndonjë shqetësim që lidhet me gjendjen emocionale apo mungesën e shoqërizimit.

Marrë në përgjithësi, përgjigjet e mostrës së prindërve  $N=797$  prindër, në pyetjen *si ka qenë gjendja emocionale e fëmijës gjatë qëndrimit në shtëpi?*, qojnë te mesatarja  $M= 1.99$ , Devijimi Standard  $SD=.762$ ., ku mesatarja e përgjigjeve të prindërve është rreth treguesit që fëmijët shpesh kanë komunikuar me shokë/shoqe, tregues i cili tregon se fëmijët kanë pasur nevojë të komunikojnë me shokë/shoqe, për arsye të gjendjes emocionale që u shkaktua nga qëndrimi në shtëpi dhe pamundësia e vijimit të mësimin në kushte normale.

Referuar deklarimeve të prindërve, raporti i prindërve me fëmijët e tyre gjatë mësimin në kushtet e pandemisë ka ndryshuar për të mirë. Rreth 82% e prindërve janë shprehur që ka ndryshuar raporti i tyre me fëmijët për të mirë, pasi që po punojnë bashkë me fëmijët e tyre rreth mësimin dhe po kalojnë kohë më të gjatë me ta. Është një përqindje e prindërve relativisht jo e vogël, rreth 15%, të cilët nuk janë shprehur fare për raportin e tyre me fëmijët gjatë mësimin në kushtet e pandemisë.

**Angazhimi i fëmijëve në mësim sipas prindërve.** Angazhimi i fëmijëve në mësim gjatë periudhës së pandemisë, për kohën pas mësimin në shkollë apo mësimin në distancë, nga prindërit përshkruhet të jetë me dallime të mëdha, nga një grup i fëmijëve të cilët mesatarisht gjatë një dite janë angazhuar për mësim dhe detyra vetëm deri në një orë mësimore gjatë një dite, deri te grupi i fëmijëve të cilët janë angazhuar rreth mësimin më shumë se tri orë mësimore gjatë ditës.


Për kohën e angazhimit të fëmijëve në mësim, më shumë se gjysma e prindërve, rreth 32%, janë shprehur se fëmijët e tyre kanë qenë të angazhuar mbi tri orë në mësim gjatë një dite, mbi 52% janë deklaruar se fëmijët e tyre

kanë qenë të angazhuar në mësim rreth dy orë gjatë ditës. Ndërsa, 13.8% u shprehën se janë angazhuar *deri në një orë*. Marrë parasysh angazhimin e fëmijëve në mësim dhe kohën e qëndrimit në shkollë gjatë një dite, në kushte normale dhe krahasuar me qëndrimin deri në një orë, si dhe rreth dy orë, kjo tregon sfidat e mësimin dhe angazhimit të nxënësve në kohë pandemie, e krahas kësaj edhe humbjet që kanë pësuar nxënësit në mësim, me shfaqjen e kësaj situate. Tabela në vijim pasqyron angazhimin e fëmijëve në mësim gjatë ditës, sipas prindërve, në numër dhe përqindje.

*Tabela 5. Angazhimi i fëmijëve në mësim gjatë ditës.*

		<i>Numri i prindërve</i>	<i>Përqindja</i>
Valid	Deri në 1 orë	114	13.8
	2 orë	436	52.8
	Mbi 3 orë	265	32.1
	Total	815	98.7
Missing		11	1.3
Total		826	100.0

**Ndihma e prindërve për fëmijët e tyre gjatë mësimin në distancë.** Këtë aspekt e kemi hulumtuar përmes pyetjes drejtuar prindërve në këtë hulumtim: *Cila ka qenë ndihma juaj për fëmijët gjatë organizimit të mësimin në distancë?* Nga përgjigjet që kemi marrë, shohim se pjesa më e madhe e prindërve, rreth 53% e tyre, sigurimin e pajisjeve dhe mjeteve tjera për mësim e konsiderojnë si ndihmën kryesore që e kanë ofruar gjatë mësimin. Aspekti i dytë, që më shumë konsiderohet ndihmë për fëmijët nga prindërit, ishte kontrollimi i detyrave para se fëmija t'i dërgonte te mësimdhënësit. Këtë e thonë mbi 44% e prindërve, përqindje e cila afërsisht lidhet me përqindjen e prindërve të cilët u ndihmojnë fëmijëve të tyre në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Figura në vijim pasqyron shpërndarjen e deklarimeve të prindërve për alternativat e ndihmës së fëmijëve të tyre gjatë mësimin në distancë.



Grafiku 25. Përqindja e prindërve që ndihmuar fëmijët e tyre gjatë mësimin në distancë.

Figura më sipër tregon se prindërit pak kujdesën që t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre të caktojnë një orar mësimi në shtëpi, të mbajnë kontaktet me mësimdhënësit për të marrë informacione për nevojat e mbështetjes për fëmijët e tyre etj.

**Raporti i prindërve me shkollën gjatë pandemisë.** Prindërit ndajnë mendimin se raporti i tyre me shkollën gjatë mësimin në kushtet e pandemisë kryesisht lidhet me informimin e vazhdueshëm, për çdo ndryshim të bërë rreth organizimit të procesit mësimor në kushtet e pandemisë, dhe këtë e thonë rreth 68% e prindërve. Ndërsa, mbi 13% e prindërve u referohen kërkesave të shkollës për ndihmën e prindërve për të ndihmuar në angazhimin e nxënësve/fëmijëve të tyre në mësim. Në anën tjetër, rreth 5% e prindërve janë shprehur se shkolla asnjëherë nuk i ka konsultuar për çështjet e mësimin gjatë pandemisë, kurse një përqindje relativisht e larë, mbi 14%, nuk janë deklaruar për raportin e tyre me shkollën gjatë pandemisë. Tabela në vijim i përmbledh rezultatet e raportit të prindërve me shkollën gjatë pandemisë për tri aspekte të diskutuara me prindër.

Tabela 6. Qëndrimi i prindërve për raportin e tyre me shkollën gjatë periudhës së pandemisë.

	Numri i prindërve	Përqindja
Shkolla na ka informuar vazhdimisht për çdo ndryshim	560	67.8
Kërkonte ndihmën tonë, të prindërve, për angazhimin e nxënësve në mësim	111	13.4
Asnjëherë nuk na kanë konsultuar për çështjet mësimore.	37	4.5
Total	708	85.7
Missing	118	14.3
Total	826	100.0

Referuar këtyre të dhënave, shohim se shkollat në Kosovë kanë shumë punë për të bërë për të ndërtuar raporte me prindër, për çështje përmbajtjesore të organizimit të mësimin, arritjet e nxënësve, dhe përfshirjen aktive të prindërve në këto procese.

**Vlerësimi i prindërve për skenarët e organizimit të mësimin.** Siç është përshkruar në kapitullin e dytë të këtij raporti, organizimi i mësimin u realizua sipas tre skenarëve të mësimin, me qëllim që të ndihmohet ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve, si dhe realizimi i procesit edukativo-arsimor të përshtatet sipas kushteve specifike të institucioneve shkollore. Rreth 60 % e prindërve ndajnë mendimin e tyre se të tre skenarët e mësimin për këtë vit kanë qenë të domosdoshëm. Mbi 8 % e prindërve vlerësojnë se skenarët e mësimin B dhe C nuk kanë qenë të nevojshëm për fëmijët e tyre, meqë në shkollat ku vijojnë mësimet fëmijët e tyre ka numër të vogël të nxënësve. Ndërsa rreth 4 e prindërve, fëmijët e të cilëve kanë punuar me skenarin C në periudha të caktuara të mësimin, kanë vlerësim se skenari C i mësimin nuk ka funksionuar fare. Në anën tjetër, një përqindje e lartë e prindërve, rreth 20%, nuk e kam idenë se çfarë kanë përfshirë skenarët e mësimin. Kjo e dhënë tregon se, edhe pse raporti shkollës me prindër lidhet më shumë me

informimin, një përqindje e madhe e prindërve vazhdojnë të mbesin të painformuar për çështjet më kryesore të organizimit të mësimi.

*Tabela 7. Vlerësimi i prindërve për skenarët e organizimit të mësimi.*

		<i>Numri i prindërve</i>	<i>Përqindja</i>
Valid	Të tre skenarët kanë qenë të domosdoshëm	493	59.7
	Skenari B dhe C nuk kanë qenë të nevojshëm për shkollën në të cilën janë fëmijët tanë	69	8.4
	Skenari C nuk ka funksionuar fare	32	3.9
	Nuk e kam idenë se çfarë kanë përfshirë skenarët arsimorë	163	19.7
	Total	757	91.6
Missing		69	8.4
Total		826	100.0

Në përgjithësi prindërit kanë vlerësim se të tre skenarët e mësimi kanë qenë të domosdoshëm për organizimin e mësimi në kushtet e pandemisë, gjatë vitit shkollor 2020/2021. Ndërsa, devijimi standard tregon për një shpërndarje më të madhe nga vlera mesatare.

**Mendimi i prindërve për ndikimin e COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit.** Referuar përgjigjeve të prindërve në kërkesën drejtuar atyre, që të përshkruajnë shkurtimisht se si i shohin humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimi të humbjeve mësimore, mësojmë se prindërit akoma nuk kanë ndërtuar mendim apo qëndrim për këtë temë, nuk janë në gjendje të ndajnë mendimin e tyre etj. Kjo reflektohet me mospërgjigje të 66% të prindërve të përfshirë në hulumtim.

Përqindja tjetër e prindërve, rreth 44% që kanë përshkruar mendimet e tyre për humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimi të humbjeve mësimore, prekin aspekte të ndryshme, të cilat më pak iu referohen aspekteve të kërkuara dhe më shumë

menaxhimit të dobët të arsimit në këto kushte. Po ashtu, mungesës së teknologjisë, mësimdhënësve joefektivë, vështirësive për mbajtjen e mësimit online, orarit të shkurtër të mësimit, organizimit të mësimit vetëm në disa lëndë mësimore etj. Të gjitha këto shqetësime të ngritura, në një mënyrë, reflektojnë ndikimin e tyre në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, mbi 5% e prindërve janë shprehur se fëmijët e tyre gjatë kësaj periudhe kanë humbur shumë në mësim.

Mënyra se si prindërit u janë qasur përgjigjeve në këtë kërkesë tregon se institucionet arsimore nuk i kanë shpalosur në masë të duhur rreziqet për thellimin e humbjeve mësimore nga ndikimi i pandemisë, pabarazitë në mësim dhe nevojat për të koordinuar veprimet me prindër, me qëllim të kompensimit të humbjeve mësimore dhe eliminimit të pabarazive në mësim.

#### **6.5. *Mësimi në kushtet e pandemisë nga perspektiva e nxënësve të klasës së shtatë***

Siç është përshkruar në pjesën e metodologjisë së hulumtimit, nxënësit e klasës së shtatë, të cilët ishin pjesë e mostrës së testimit në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë, të realizuar në kuadër të këtij studimi, kanë plotësuar një pyetësor, i cili ka përmbajtur disa pyetje lidhur me organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, mësimin online dhe angazhimin e tyre dhe rezultatet në mësim. Pjesa në vijim pasqyron pikëpamjet e nxënësve për këto aspekte.

**Organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë.** Referuar gjetjeve të studimit me nxënës, ashtu si edhe me subjektet tjera të shkollës, rezulton që të gjitha shkollat e përfshira në studim, në periudhën që mbulon hulumtimi (viti shkollor 2020/2021), kanë aplikuar të tre skenarët e mësimit (A, B dhe C) dhe kohëzgjatje të orëve të mësimit sipas specifikave të shkollave dhe protokolleve të mësimit në kushtet e pandemisë. Pjesa më e madhe e shkollave kanë mbajtur orë mësimi me kohëzgjatje rreth 30 minuta.

Sa i përket ndarjes së nxënësve në grupe sipas kërkesave të Udhëzuesit të MASHT, në përqindje më të lartë nxënësit kanë deklaruar se gjatë vitit shkollor 2020/2021 janë ndarë në grupe të nxënësve për vijim të mësimit qoftë me skenarin A apo me skenarin B të mësimit (n=929 ose 76.5%). Mirëpo, edhe pse ata janë ndarë në grupe, pjesa më e madhe e tyre kanë mbajtur mësim me prani fizike në shkollë, por me orar të shkurtuar të mësimit.


Kohëzgjatja e orëve mësimore është një aspekt, i cilit pritet të ndikojë në humbjet mësimore. Nxënësit konfirmojnë se shkollat kanë punuar me orare të ndryshme të mësimit dhe me kohëzgjatje të ndryshme të orëve të mësimit në të tre skenarët e zbatuar, dominon kohëzgjatja e orëve mësimore prej 25 deri në 30 minuta. Shkollat që kanë punuar me këtë kohëzgjatje të mësimit kanë humbur nga 33% deri në 44% të kohës mësimore për një orë të mësimit. Kjo kohë, deri diku, mund të jetë kompensuar me numër të vogël të nxënësve në klasë – deri në 15 nxënës, mirëpo pjesa më e madhe e saj llogaritet të jetë e pambuluar, kur kemi parasysh strukturën e orës mësimore dhe kohën e angazhimit të nxënësve. Tabela 6 paraqet një pasqyrë më të plotë rreth skenarëve të zbatuar dhe kohëzgjatjes së orëve mësimore në rrethanat e pandemisë covid-19.

*Tabela 8: Mendimi i nxënësve për kohëzgjatjen e orëve mësimore sipas skenarëve të mësimit.*

Skenarët e mësimit	Kohëzgjatja e orës mësimore sipas nxënësve					Gjithsej
	Deri në 25 min	25 - 30 min	30 - 35 min	35 - 40 min	Mbi 40 min	
Skenarin A (mësim me prani fizike në klasë/shkollë)	23.9%	42.7%	20.1%	8.9%	4.5%	314 ose 28.3%
Skenarin B (mësim i kombinuar – prani fizike në shkollë dhe online/nga shtëpia)	18.6%	46.1%	22.1%	8.6%	4.6%	371 ose 33.5%
Skenarin C (mësim online / nga shtëpia)	17.3%	45.2%	20.1%	12.3%	5.2%	423 ose 38.2%
Gjithsej	217	496	230	112	53	1108

Duke e ditur se organizimi i mësimi gjatë vitit shkollor 2020/2021 ishte i imponuar nga rrethanat e pandemisë dhe përpjekjet bëheshin që mësimi të jetë sa më efektiv edhe në këto kushte, morëm mendimin e nxënësve *sa ishte efektiv mësimi gjatë këtij viti shkollor, në kushtet e pandemisë?* Referuar përqindjeve më të larta, nxënësit vlerësojnë se mësimi në kushtet e pandemisë covid-19 ishte deri diku efektiv (n=639 ose 53.8%) dhe aspak ose pak efektiv (n= 317 ose 27.6%). Pjesa tjetër janë përgjigjur se mësimi në këto rrethana ishte në masë të madhe apo plotësisht efektiv (n=232 ose 19.5%). Te nxënësit e deklaruar më aspak dhe pak efektiv, mungesë më e madhe vërehet të ketë qenë kompjuteri (29,9% dhe 30.6%), përderisa te nxënësit e deklaruar me deri diku efektiv, mungesë rezulton të ketë diçka tjetër (31.5%), përveç laptopit, kompjuterit, telefonit, apo rrjetit të internetit.

Grafiku në vijim sjell një pasqyrë të plotë të qëndrimeve të nxënësve për efektivitetin e mësimi në rrethanat e pandemisë, në raport me mungesat në pajisje dhe aspekte të tjera për realizimin e e-mësimi në këto rrethana.



Grafiku 26: Mungesat në pajisje dhe qëndrimet e nxënësve për efektivitetin e mësimi në rrethanat e pandemisë.



Sa i përket kohëzgjatjes së mësimin në kushtet e pandemisë, shumica e nxënësve në komentet e tyre janë ankuar për kohën, orët e shkurtuara, duke theksuar se nuk u kanë mjaftuar orët 25 minuta. Sipas tyre, në disa lëndë është e pamundur të zhvillohen njësitë mësimore dhe nxënësit të arrijnë të kuptojnë mësimet me orë të shkurtuara.

Ndërsa, lidhur me respektimin e rregullave për mësim në klasë, në kushtet e pandemisë, edhe pse ekziston udhëzimi për mbrojtjen nga pandemia, nxënësit në disa shkolla nuk kanë qenë mjaft të kënaqur me respektimin e rregullave. Në disa shkolla, sipas nxënësve, kanë munguar mjetet mbrojtëse, nuk ka pasur dezinfektues të mjaftueshëm dhe nuk është bërë matja e temperaturës rregullisht. *“Mungojnë mjetet mbrojtëse, si dezinfektues në klasë. Mungon distanca dhe matja e temperaturës ka zgjatur shumë pak”*, ka theksuar një nxënës.

**Mësimi online nga mësimdhënësit e shkollës dhe mësimi përmes RTK-së, sipas mendimit të nxënësve.** Pandemia vlerësohet se ka reflektuar pozitivisht në fillimet e praktikimit të mësimin online. MASHTI, për shkak të rreziqeve të mëdha nga pandemia për të kaluar i gjithë arsimit parauniversitar në skanerin C të mësimin, mësim në distancë, gjatë gjithë vitit shkollor organizoi mësimin në distancë, përmes RTK-së. Për këto zhvillime, në kuadër të hulumtimit me nxënës, morëm mendimin e tyre.

Mësimi online nga mësimdhënësit, sipas një përqindjeje të lartë të nxënësve, është ofruar në të gjitha lëndët mësimore (32.5%). Në 5-6 lëndë mësimore (29.1%) dhe në 1-4 lëndë mësimore (33.3%). E ulët është përqindja e nxënësve që deklarojnë se mësimi online nga mësimdhënësit nuk është realizuar në asnjë lëndë mësimore (5.1%). Këto të dhëna tregojnë se ka një zhvillim të mirë sa i përket praktikimit të mësimin online nga mësimdhënësit.

Mirëpo, kompetencat digjitale të mësimdhënësve, sipas nxënësve, janë një sfidë, ndaj të cilës sistemi duhet t'i përgjigjet me masa mbështetëse për mësimdhënësit në zhvillimin e kompetencave digjitale. Rreth 63 % e nxënësve vlerësojnë se mësimdhënësit e tyre kanë kompetenca digjitale të pamjaftueshme dhe deri diku të mjaftueshme, ndërsa rreth 37% e nxënësve

vlerësojnë se mësimdhënësit e tyre kanë kompetenca digjitale të mira dhe shumë të mira/të shkëlqyera.

Edhe pse i nevojshëm, për shumicën e nxënësve mësimi online ka qenë më i vështirë, pasi nuk kanë arritur të kuptojnë shumë gjëra dhe e kanë pasur të vështirë të adaptohen.

Më shumë se gjysma e nxënësve që kanë komentuar, kanë thënë se nuk janë të kënaqur me mësimin online, ngase disa nxënës kanë qenë aktivë, por disa jo. Edhe pse kanë frikë nga infektimi dhe janë të stresuar, kërkojnë të kthehen në shkollë, në mësim të rregullt *“Në pandemi kam pasur disa probleme me teste, sepse u stresojsha”*, thekson nxënësi.

Sipas nxënësve, mësimdhënësit gjatë pandemisë nuk kanë qenë mjaft të qartë dhe sa duhet efektivë. Disa arsimtarë kanë munguar, nuk kanë mbajtur mësim online, kurse disa të tjerë janë angazhuar pak, nuk i kanë sqaruar si duhet detyrat.

*“Ka qenë shumë vështirë, shpresoj të mos jemi kurrë në atë gjendje”*, shprehet një nxënës.

*“Disa mësimdhënës kanë qenë shumë pasivë dhe nuk kemi mbajtur asnjëherë online (Zoom)”*, ka thënë një tjetër nxënës.

Për disa nxënës kushtet për mësim kanë qenë të mira, por në disa lëndë ka qenë më vështirë, si në Matematikë dhe në Fizikë. Një numër i madh i nxënësve kanë thënë se kanë humbur shumë orë, për shkak të problemeve që kishin disa mësimdhënës me teknologjinë, disa kanë shpjeguar shpejt dhe nuk kanë arritur të kuptojnë mësimet, prandaj kanë mbetur mbrapa. Po ashtu, ka munguar bashkëpunimi i nevojshëm ndërmjet nxënësve.

Shumë nxënës kanë thënë se u kanë munguar shumë shkollë, mësimdhënësit, shokët dhe argëtimi. Nuk kishte shumë ndërveprim përmes platformës dhe nxënësit ngarkoheshin shumë me detyra.

*“Gjatë kohës së pandemisë më kanë munguar shoqëria, mësimi i rregullt. Kemi qenë shumë të ngarkuar nga platforma Zoom. Kemi qenë të ngarkuar me detyra, gjatë gjithë ditës kemi bërë detyra”*, shprehet një nxënës tjetër.

Disa nxënës kanë treguar për problemet që i kanë pasur me rrjetin-internetin, sidomos në fshatra, por edhe mungesë të mjeteve teknologjike (kompjuter, laptop, telefon). Kishte nga ata që kanë pasur probleme edhe me energjinë elektrike - ndërprerje të rrymës, por edhe me hapësirën për mësim në shtëpi - mungesë të dhomave të veçanta për mësim.

Kështu janë shprehur disa nxënës: *“Në kohën e pandemisë nuk kemi mujtur për të pas mësim online sepse skam patur telefon e as rrjet sepse atëherë qendronim në fshat te gjysherit”*.

*“Unë nuk kam dërguar asnjë detyrë për shkak te telefonit dhe te gjithë arsimtaret me kane qortuar pse skam dërguar asnjë detyrë”*.

*“Në zoom nuk më pëlqen, sepse shumicën e kohës nuk kisha rrjet dhe nuk kisha mundësi të kyqem. Po ashtu në klasë nuk më pëlqeu, sepse kishte orar të shkurtuar”*.

*“Gjatë mësimin online kemi pasur 50% mungesë të mësimin”*.

Në anën tjetër, orët mësimore që janë shfaqur në programin e RTK-së, në përqindje më të lartë, janë përcjellë të gjitha nga nxënësit e klasës së shtatë, këtë e thonë mbi 50% e nxënësve të përfshirë në hulumtim. Ndërsa, sipas 21% të nxënësve janë përcjellë pjesa më e madhe e orëve mësimore të shfaqura në RTK, rreth 25 % e nxënësve kanë deklaruar se vetëm disa orë/disa herë në javë i kanë përcjella gjatë gjithë vitit. Përqindja tjetër e nxënësve, rreth 4 %, deklaruan se asnjëherë nuk i ndjekin orët që shfaqen në programin e RTK-së.

Se sa efektive kanë qenë orët mësimore që shfaqen në programin e RTK -së dhe ndihma e tyre në mësim, nxënësit kanë deklaruar ndërlidhje të të dyja aspekteve. Sa më i lartë që ka qenë vlerësimi i nxënësve për efektivitetin e orëve mësimore që shfaqen në programin e RTK-së, aq më i lartë ka qenë edhe vlerësimi për ndihmën e këtyre orëve në mësim, siç pasqyrohet në tabelën 7.

Tabela 9: Vlerësimi i nxënësve për efektivitetin e orëve mësimore të shfaqura në RTK dhe ndihma në mësim që kanë marrë prej tyre


		<i>Sa kanë ndihmuar orët mësimore që po shfaqen çdo ditë në RTK që nxënësit të mësojnë më shumë?</i>					Gjithsej
		<i>Fare nuk më kanë ndihmuar</i>	<i>Pak më kanë ndihmuar</i>	<i>Deri diku më kanë ndihmuar</i>	<i>Në masë të madhe më kanë ndihmuar</i>	<i>Shumë më kanë ndihmuar</i>	
Vlerësimi i efektivitetit të orëve mësimore:	1	35.0%	31.7%	31.4%	18.9%	9.5%	60
1 (minimal) - 5 (maksimal)	2	10.5%	45.1%	38.3%	4.5%	1.5%	133
	3	2.5%	21.7%	64.7%	7.4%	3.7%	323
	4	1.0%	8.8%	53.2%	29.6%	7.3%	385
	5	0.5%	5.3%	29.2%	27.8%	37.3%	209
Gjithsej		48	194	537	208	123	1110

Sipas një pjese të madhe të nxënësve, nuk ka qenë lehtë i kuptueshëm mësimi i shfaqur në RTK, pasi nga televizori nuk i kanë kuptuar mësimet njëjtë si në shkollë. Për shumë nxënës, mësimet ishin të shkurtra dhe jo shumë të kuptueshme, pasi shpjegoheshin shpejt dhe nuk jepeshin shembuj të mjaftueshëm, por më tepër janë dhënë detyra.

*“Ka qenë pakëz e vështirë për mua. Ndjekja në RTK nuk ka qenë shumë e mirë. Shumë detyra”*, shprehet një nxënës për mësimin në RTK.

**Reflektimi i nxënësve për angazhimin e tyre në mësim dhe rezultatet e arritura.** Nga nxënësit morëm mendimin edhe për angazhimin e tyre në mësim dhe rezultatet e arritura gjatë vitit shkollor 2020/2021. Në përqindje më të lartë, nxënësit deklarojnë se angazhimi i tyre gjatë pandemisë ka qenë i mirë (64.4%) dhe i lartë (24.4%), përderisa një përqindje më e ulët deklarojnë se ata kanë qenë tejet pasivë (3%), apo me interesim të ulët (8.2%). Ata gjithashtu deklarojnë se kanë kaluar tepër shumë /më shumë kohë në kryerjen e obligimeve shkollore gjatë këtij viti shkollor krahasuar me vitin para pandemisë (orë mësimore, angazhime, projekte dhe detyra të shtëpisë etj.), (42.8%) kanë kaluar kohë të njëjtë sikurse gjatë mësimin para pandemisë (33.8%) dhe shumë më pak/më pak (23.4%). Referuar kohës/orëve në ditë që nxënësit kanë kaluar duke mësuar në shtëpi, vërehet se dominon mësimi në 1-2 orë në ditë. Te nxënësit që kanë deklaruar se kanë

kaluar tepër shumë kohë në kryerjen e obligimeve të mësimit, përqindje më të lartë të kohës të shpenzuar për këtë angazhim rezulton të kemi me angazhim 2-3 orë në ditë (36.9%) dhe më shumë se 3 orë në ditë (31.5%).



Grafiku 27: Mendimi i nxënësve për angazhimin e tyre në kryerjen e obligimeve mësimore dhe koha e shpenzuar në këtë angazhim.

Lidhur me rezultatet e arritura në mësim në rrethanat e pandemisë, referuar përgjigjeve të nxënësve të përfshirë në studim, në përqindje më të lartë rezulton të kemi rezultate *shumë të mira* dhe *të shkëlqyera*, në lëndën e Gjuhës shqipe (57.5%), ndërsa në lëndën e Matematikës rezultate të mira (52.5%). Tabela prezanton rezultatet e nxënësve sipas deklarimeve të tyre:

Tabela 10: Rezultatet në lëndët Gjuhë shqipe dhe në Matematikë sipas deklarimeve të nxënësve.

Rezultatet:	Gjuhë shqipe	Matematikë
Të pamjaftueshme	35 ose 3%	49 ose 4.2%
Të mjaftueshme	129 ose 10.9%	154 ose 13.1%
Të mira	339 ose 28.7%	355 ose 30.2%
Shumë të mira	290 ose 24.5%	286 ose 24.3%
Të shkëlqyera	390 ose 33%	332 ose 28.2%
Gjithsej	1183	1176

Rezultatet nga tabela më sipër reflektojnë trendët e notës mesatare të nxënësve në këto dy lëndë mësimore në fund të vitit shkollor 2020/2021. Sipas raporteve të shkollave të përfshira në hulumtim, nota mesatare e nxënësve të klasës së shtatë, paraleleve që ishin pjesë e studimit, në lëndën Gjuhë shqipe është 3.50, ndërsa në lëndën Matematikë është 3.32. Mirëpo, këto rezultate dallojnë dukshëm me rezultatet e vlerësimit të realizuar me nxënës në kuadër të këtij studimi.

Angazhimi i nxënësve në mësim në kushtet e pandemisë dhe rezultatet e nxënësve, në masë të madhe, janë ndikuar edhe nga kushtet e nxënësve për punë në shtëpi dhe nga posedimi i pajisjeve të TIK-ut për mësim gjatë skenarëve B dhe C të mësimin. Sa u përket kushteve në shtëpi, në të cilat nxënësit kanë mbajtur mësimin online gjatë pandemisë, në përqindje më të lartë rezultojnë të kemi deklaratim të kushteve të përshtatshme për mësim – mundësi për mësim në një dhomë me vëllezër/motra (n=427 ose 35.4%) dhe kushte ideale për mësim – një dhomë e veçantë mësimi vetëm për mua (397 ose 32.9%). Pjesa tjetër e nxënësve kanë deklaruar kushte deri diku të përshtatshme – një hapësirë e përshtatshme për mësim në dhomën e qëndrimit ditor (n=233 ose 19.3%), kushte pak dhe aspak të përshtatshme - pa asnjë hapësirë, apo me një hapësirë fare të vogël për mësim në dhomën e qëndrimit ditor (n=150 ose 12.4%). Ato që më së shumti nxënësve u kanë munguar për realizimin e mësimin në rrethanat e pandemisë rezultojnë të jenë kompjuteri apo laptopi, pastaj interneti i qëndrueshëm dhe pajisjet e tjera. Mësimi online përmes telefonit, i cili sipas nxënësve del të jetë bërë nga rreth 48% e nxënësve, ishte alternativë e imponuar nga mungesa e kompjuterit apo laptopit dhe joefektive për angazhim dhe rezultate në mësim.

## 7. DISKUTIMI I REZULTATEVE

Diskutimi i rezultateve ndërlidhet me çështjet kryesore të studimit, si qëllimi, objektivat dhe pyetjet kërkimore, siç janë realizimi i qëllimit dhe pyetjeve kërkimore të studimit, lidhur me ndikimin e COVID-19 në humbjet mësimore të nxënësve kosovarë, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit.

Objektivi i parë i studimit ishte të përshkruhet ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore në arsimin parauniversitar, me fokus të veçantë në klasat e dyta dhe të shtata.

Pyetjet kërkimore për këtë objektiv ishin:

*Cila është masa e humbjeve të përgjithshme mësimore të nxënësve në arsimin parauniversitar?*

*Cilat janë efektet e COVID-19 në arritjet e nxënësve në klasat e dyta dhe të shtata, krahasuar me kohën e qëndrimit në shkollë gjatë mësimit, skenarët e mësimit, vendndodhjen e shkollave (urbane dhe rurale), numrin e nxënësve në klasa, moshën e mësimdhënësve dhe me të dhënat për karakteristikat socio-ekonomike të nxënësve?*

Objektivi i dytë i studimit ishte të analizohen dhe të përshkruhen qëndrimet e përfaqësuesve të shkollave lidhur me organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar në kushtet e pandemisë dhe efektivitetin e mësimit në kushte të tilla.

Pyetja kërkimore për këtë objektiv ishte:

*Cili është qëndrimi i subjekteve nga shkollat për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë dhe efektivitetin e mësimit në këto kushte?*

Objektivi i tretë i studimit ishte të analizohet dhe të përshkruhet kuadri i masave të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë, me theks të veçantë nga MASHTI, për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID-19.

Pyetja kërkimore për këtë objektiv ishte:

*Sa janë treguar relevante masat e ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë COVID -19, krahasuar me arritjet e nxënësve?*

Objektivi i katërt i studimit ishte të identifikohen dhe të përshkruhen zgjidhjet e mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim.

Pyetja kërkimore për këtë objektiv ishte:

*Cilat janë zgjidhjet e mundshme, afatshkurtra dhe afatmesme, për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim?*

### ***7.1. Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore dhe në rritjen e pabarazive në mësim***

Studimet tregojnë se ndikimet e ndërprerjeve në mësim janë ende të panjohura. Ende nuk dihen pasojat e sakta dhe humbjet nga ndikimi i pandemisë COVID-19 në përgatitjen akademike të nxënësve. Një është e qartë, pandemia ka përkeqësuar sistemet arsimore, ka ndikuar në zvogëlimin e qasjes në mësim dhe rritjen e pabarazive në mësim, ka ndikuar në të nxënësit social dhe emocional, si dhe ndërveprimin dhe mbështetjen sociale. Pasojat më të rënda do të shfaqen sidomos te vendet me varfëri dhe tek ato në zhvillim, siç është Kosova.

Mungesa e një sistemi të standardizuar për vlerësimin e humbjeve nga ndërprerja e mësimin dhe ndryshimit të qasjeve në mësim e bën edhe më të vështirë gjetjen e pasojave të sakta dhe masën e humbjeve mësimore nga ndikimi i pandemisë. Me një problem të tillë jemi ballafaquar edhe në këtë studim tematik për humbjet mësimore.

Mungesa e një sistemi të standardizuar të vlerësimit për shkallë kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, si dhe mungesa e një sistemi për



informata kthyeje në formën elektronike për arritjet e nxënësve, për të krahasuar arritjet e rezultateve të nxënësve në raport me klasë dhe lëndë mësimore të caktuara, ka pamundësuar një vlerësim të saktë të humbjeve mësimore dhe njëkohësisht pamundëson planifikimin dhe orientimin e qartë të çfarëdo nisme për kompensim të humbjeve mësimore.

Pavarësisht kësaj, referuar analizës së kontekstit të organizimit të mësimin në arsimin parauniversitar në Kosovë, humbjet mësimore të nxënësve në Kosovë, nga ndikimi i pandemisë COVID-19, vijnë nga faktorë të ndryshëm, si: mbyllja e shkollave dhe mësimi në distancë, shkurtimi i kohës mësimore standarde (orëve të mësimin), reduktimi i orëve mësimore dhe përmbajtjeve kurrikulare në disa lëndë mësimore dhe metodat e mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë, kundrejt mësimdhënies në kushte të zakonshme në mjediset e klasës.

Në ndërlidhje me këta faktorë dhe duke marrë për bazë metodologjinë e studimit të Bankës Botërore për humbjet mësimor në fazën e parë të pandemisë (për vitin shkollor 2019/2020), analizën e kontekstit të organizimit të mësimin në arsimin parauniversitar në Kosovë gjatë periudhës së pandemisë, ndikimi i pandemisë në humbjet mësimore të nxënësve në Kosovë është i mundshëm të jetë sipas dy skenarëve: **Skenari 1:** humbje mësimore të krahasuara me 41 pikë të të nxënësve PISA, apo mbi një vit të shkollimit, si rezultat i mospjesëmarrjes së nxënësve në mësimin në distancë në periudhën mars-qershor 2020, kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta, reduktimit të kurrikulave (rreth 25%) në disa lëndë mësimore gjatë vitit shkollor 2020/2021 dhe metodave të mësimdhënies joefektive në kushtet e pandemisë; dhe **Skenari 2:** humbje mësimore të krahasuara me 24 pikë të të nxënësve PISA, apo më shumë se 60% e një viti të shkollimit sipas pikëve të të nxënësve PISA, si rezultat i metodave të mësimdhënies joefektive gjatë mësimin në distancë dhe kohës mësimore të humbur me kohëzgjatje të orëve mësimore 25-30 minuta.

Edhe rezultatet e studimit nga Kristof De Witte & Joana Elisa Maldonado (shtator, 2020), të kryer me nxënësit e klasave të gjashta, në Flanders dhe rajonin e Brukselit, me teste të standardizuara (validuara) nga Edukimi

Katolik Flanders (IDP), për të përshkruar ndryshimin në arritjet e nxënësve dhe pabarazinë për shkak të krizës COVID-19, tregojnë për shkallë të lartë të humbjeve mësimore dhe rritje të lartë të pabarazisë në mësim:

- Për shkak të krizës COVID-19, grupi i analizuar i nxënësve pësoi humbje të konsiderueshme të të nxënësve në vitin 2020, të krahasuara me gjashtë muaj shkollë.
- Për shkak të krizës COVID-19, pabarazia në rezultatet e testeve brenda shkollave u rrit 17% për Matematikën dhe 20% për Holandishten. Ndërmjet shkollave pabarazia u rrit 7% për Matematikën dhe 18% për Holandishten.
- Humbjet e të mësuarit dhe rritja e pabarazisë janë më të mëdha në shkollat me nxënës nga grupet e cenueshme.

Në anën tjetër, të dhëna interesante pasqyrohen në studimin e bërë nga autorët zviceranë: Martin J. Tomasik, Laura A. Helbling, Urs Moser (nëntor 2020), lidhur me fitimet arsimore nga mësimi në distancë në shkollat fillore dhe të mesme në Zvicër. Në kuadër të këtij studimi janë krahasuar arritjet mësimore në 8 javët e mbylljes së shkollës për shkak të COVID-19 në Zvicër me arritjet mësimore në 8 javët para mbylljes në lëndën e Matematikës dhe të Gjuhës gjermane (lexim dhe gramatikë). Për këtë studim janë përdorur të dhëna nga sistemi i informatave kthyes formative/formuese në formën elektronike (computer-based formative feedback system), duke përfshirë analizat statistikore të përdoruesve aktivë të sistemit MINDSTEPS, të cilët përfunduan të paktën një vlerësim të gjeneruar.

Gjetjet nga ky studim tregojnë se, përderisa nxënësit e shkollës së mesme mbetën kryesisht të paprekur nga mbyllja e shkollës për sa u përket arritjeve të të nxënësve, për nxënësit e shkollës fillore të nxënësve ngadalësohet dhe në të njëjtën kohë rritet ndryshimi ndërindividual në arritje. Format e mësimimit në distancë duken si një mjet efektiv për të zëvendësuar mësimin me prezencë në institucione arsimore, të paktën në një situatë emergjente, por jo të gjithë nxënësit përfitojnë në të njëjtën shkallë.

Në kontekstin e arsimit në Kosovë nuk është ndërtuar një sistem i informatave kthyese formative/formuese në formën elektronike për arritjet e nxënësve, për të krahasuar arritjet mësimore të nxënësve për disa javë ose muaj para pandemisë dhe disa javë ose muaj pas fillimit të pandemisë. Nuk është ndërtuar as sistemi i vlerësimeve kombëtare për të krahasuar arritjet e rezultateve të nxënësve në raport me klasat dhe lëndët mësimore të caktuara.

Në mungesë të një sistemi të informatave kthyese për arritjet e rezultateve të të nxënësve, vlerësimi i nxënësve për këtë studim, me qëllim matjen e humbjeve mësimore në raport me nivelin e arritshmërisë në dy vitet e pandemisë, është bërë me testet e vlerësimit për shkallë kurrikulare të hartuara nga MASHTI në mbështetje të shkollave për këtë lloj të vlerësimit. Referuar rezultateve nga vlerësimi i nxënësve, humbjet mësimore dhe pabarazitë në mësim në rritje dalin në pah si të nxënësit e klasës së dytë ashtu edhe të nxënësit e klasës së shtatë.

Nxënësit e klasës së dytë në këtë vlerësim, me mesataren e arritshmërisë 51.5 % në lëndën e Gjuhës shqipe, kanë arritur vetëm minimumin bazë të rezultateve të të nxënësve dhe kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Prej tyre, rreth 23% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të arritshmërisë. Rezultatet e nxënësve të klasës së dytë të përfshirë në këtë studim janë më të ulëta për rreth 28%, krahasuar me notën mesatare të këtyre nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe në fund të vitit shkollor. Sipas raporteve të shkollave të përfshira në këtë studim, nxënësit në fund të vitit shkollor në lëndën e Gjuhës shqipe kanë notë mesatare mbi (4) - me arritje shumë të kënaqshme – shumë mirë, ose 80% të zotërimit të rezultateve të të nxënësve.

Në të gjitha kërkesat/pyetjet e hapura të instrumentit të vlerësimit të përdorur në këtë studim, arritjet e nxënësve janë nën 40%. Në shumicën e përgjigjeve të shkruara, si fjali, shkrimi i teksteve të shkurtër të kërkuara në kontekste të caktuara, përshkrimi i ndonjë ilustrimi të dhënë etj., vërehet nivel tejet i ulët i shkrimit dhe leximit. Rezultatet në këto kërkesa/pyetje tregojnë se nxënësit e klasës së dytë kanë probleme të theksuara në zbatimin e rregullave të drejtshkrimit, në të shkruarit drejt, në përdorimin e shenjave të pikësimit, në shkrimin e një teksti të shkurtër në bazë të rregullave që lidhen me temën


përkatëse, vendosjen e titullit, përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, përdorimin e emrave të përveçëm etj.

Nxënësit e klasës së shtatë në lëndën e Gjuhës shqipe, me mesataren e arritshmërisë 41.%, kanë arritur vetëm minimumin e rezultateve bazë të të nxënimit dhe kanë nevojë për përkrahje dhe përmirësim të vazhdueshëm. Rezultatet e përgjithshme në lëndën e Gjuhës shqipe tregojnë se rreth 51 % e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënimit në lëndën e Gjuhës shqipe, të cilat janë matur me instrumentin e vlerësimit në këtë studim, as në nivelin minimal të pritjeve. Prej tyre, rreth 15% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të rezultateve.

Rezultate të përafërta janë arritur edhe në lëndën e Matematikës. Nxënësit e klasës së shtatë në lëndën e Matematikës, me mesataren e arritshmërisë 48.%, kanë arritur vetëm minimumin e rezultateve bazë të të nxënimit. Ashtu si në lëndën e Gjuhës shqipe, edhe në lëndën e Matematikës nxënësit kanë nevojë për mbështetje dhe përmirësim të vazhdueshëm. Rezultatet e përgjithshme në lëndën e Matematikës tregojnë se rreth 36 % e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënimit në lëndën e Matematikës, të cilat janë matur me instrumentin e vlerësimit në këtë studim. Prej tyre, rreth 8% e nxënësve kanë nivel tejet të ulët të rezultateve.

Referuar analizës së rezultateve sipas kërkesave/pyetjeve të veçanta në lëndën e Gjuhës shqipe dhe në lëndën e Matematikës, nxënësit kanë arritur rezultate më të larta në kërkesat/pyetjet në të cilat kërkohej përdorim i strategjive të memorizimit, kundrejt kërkesave që kërkonin përdorim të strategjive elaboruese dhe të mendimit kritik.


Dallimet në arritjet e nxënësve në vlerësimet e realizuara në kuadër të studimit, të konvertuara në notë mesatare sipas sistemit të vlerësimit, në raport me notën mesatare të nxënësve të njëjtë në fund të vitit mësimor 2020/2021 – nga vlerësimi i mësimdhënësve, janë tejet të larta.



*Grafiku 28: Rezultatet e vlerësimit në kuadër të studimit, të krahasuara me notën mesatare në fund të vitit shkollor 2020/2021.*

Si vlerë e notës mesatare nuk është arritur në asnjë nga vlerësimet e realizuara në kuadër të studimit niveli i notës së plotë mesatare 2.00. Në anën tjetër, nota mesatare nga vlerësimet në shkollë shkon nga 3.3 në Matematikë klasa e shtatë si notë mesatare e klasës, deri në notën mesatare 4 në lëndën e Gjuhës shqipe në klasën e dytë.

Për çështje të nxjerrjes së dallimeve në raport me sistemin e vlerësimit të nxënësve në Kosovë, rezultatet e arritura në lëndën e Gjuhës shqipe - klasa e dytë, në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë – klasa e shtatë, përkatësisht pikët maksimale i kemi kategorizuar në gjashtë nivele/grupe të pikëve. Sipas sistemit të vlerësimit të nxënësve në Kosovë, dy nivelet e para tregojnë arritje të pamjaftueshme (nota 1), niveli i tretë referon arritje të mjaftueshme (nota 2), niveli i katërt referon arritje të mirë (nota 3) niveli i pesë referon arritje shumë të mirë (nota 4), niveli i gjashtë referon arritje të shkëlqyeshme (nota 5).



Grafiku 29:Përmbledhje e rezultateve në Gjuhë shqipe dhe në Matematikë sipas klasave dhe gjatë niveleve të arritjeve.

Referuar rezultateve të grafikut më sipër, përqindja e nxënësve me arritje në të dyja nivelet e para që nuk kanë arritur rezultatet minimale (nivelet 1 dhe 2) është tejet e lartë, në anën tjetër përqindja e nxënësve me arritje në dy nivelet e fundit, që nuk kanë arritur rezultatet në nivele të larta (nivelet 5 dhe 6, apo notat e vlerësimit 4 dhe 5), është tejet e ulët.

Mësimdhënia joefektive në kushtet e pandemisë është e reflektuar në rezultatet e nxënësve. Një nga hulumtueset e IPK-së, e cila gjatë periudhës prill–maj 2021 ka vëzhguar 18 orë mësimore (18 mësimdhënës të ndryshëm), në kuadër të studimit *Shkathtësitë gjuhësore të nxënësve të grupmoshave 9-13 dhe 14-18 dhe ndikimi i tyre në cilësinë e përgjithshme në arsim, me fokus në rezultatet e testimit ndërkombëtar PISA 2018*, kështu e përshkruan situatën e mësimin në klasë dhe sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit:

- *Shumica e mësimdhënësve i kanë përgatitjet ditore dhe realizimin e aktiviteteve e bëjnë në përputhje me planifikimin. Çka bie në sy dhe vërehet në masë të madhe është një nguti nga ana e mësimdhënësve në realizimin e aktiviteteve, por që duket nxënësit janë adaptuar tashmë me një gjë të tillë.*

- *Në të gjitha vëzhgimet (18 orë mësimore/18 mësimdhënës të ndryshëm) të gjitha orët ishin zhvillim. Një gjë të tillë mësimdhënësit e pohojnë edhe gjatë bisedave se për shkak të kohës së pamjaftueshme që kanë në dispozicion janë të detyruar të fokusohen vetëm në zhvillim të njëjësive të reja për të arritur sa më shumë realizimin e programit/kurrikulës lëndore. Janë reduktuar orët mësimore, sidomos lëndët e shkathësive janë të rralla. Fokusi është në lëndët bazë.*
- *Dominon forma frontale e punës. Diskutimet me nxënës (pyetje-përgjigje të shkurtra) bëhen sidomos në pjesën hyrëse dhe përfundimtare të orës mësimore, ndërsa në pjesën kryesore të orës mësimore kombinohet puna frontale me punën individuale, e që fokusi kryesor është puna me tekstet mësimore. Në raste shumë të rralla ka mendim kritik. Edhe rezultatet mësimore janë hartuar në nivelin njohjes, nuk ka argumentim dhe reflektim kritik.*
- *Pjesa e vlerësimit është lënë anash. As nuk është e paraparë në përgatitjet ditore mënyra e vlerësimit formativ, përveç kritereve të suksesit, të cilat në pjesën dërmuese nuk janë përcaktuar qartë, por që edhe këto nuk respektohen në aktivitetet me nxënës, pasi në shumicën e rasteve ndryshojnë me kërkesat që parashtrihen te nxënësit.*

Rezultatet e studimit, sipas gjashtë niveleve të arritjeve, tregojnë për pabarazinë në të nxënit, e cila referuar rezultateve të studimit PISA ishte e madhe edhe para pandemisë. Edhe në vlerësimet e realizuara në kuadër të studimit shpërfaqen dallime në rezultate/arritje të nxënësve, të cilat tregojnë për pabarazinë në të nxënit e nxënësve.

Referuar rezultateve, nxënësit me arritshmëri të ulët në lëndën e Gjuhës shqipe, klasa e shtatë, në nivelet 1 dhe 2, janë në përqindje më të lartë nga vendbanimi në fshat, mbi 15 % më shumë kundrejt nxënësve me vendbanim në qytet. Edhe rezultatet e Matematikës sa i përket vendbanimit të nxënësve tregojnë se nxënësit që jetojnë në fshat kanë arritje më të ulët kundrejt nxënësve që jetojnë në qytet, dallimi është për 7% me arritje më të ulët.

Sipas rezultateve të studimit, nxënësit kanë arritshmëri të ulët pavarësisht skenarëve të mësimi dhe numrit të nxënësve në shkolla. Pra, nuk kemi dallim domethënës statistikor që e dallon arritshmërinë e nxënësve në raport me skenarët e mësimi dhe numrin e nxënësve në shkolla. Kjo për faktin se arritshmëria e nxënësve është e përqendruar në nivele të ulëta të arritshmërisë dhe vetëm një përqindje relativisht e vogël e nxënësve kanë arritur nivelet më të larta, nivelet e arritshmërisë 4, 5 dhe 6. Argumenti tjetër është se shkollat që kanë punuar me skenarin C të mësimi, nga 1-4 javë, apo në skenarin B të mësimi, kryesisht janë shkolla urbane, dhe arritjet e nxënësve në shkollat urbane janë më të larta se arritjet e nxënësve në shkollat rurale.

Mësimi në kushtet e pandemisë, gjithashtu, ka gjasë të sjellë ndikim të ndryshëm te djemtë dhe vajzat. Në kuadër të studimit, dallimet më të theksuara janë në lëndën e Gjuhës shqipe. Vajzat kanë arritshmëri më të lartë në nivelet e arritjeve 3, 4, 5 dhe 6, ndërsa rreth 63% e djemve kanë arritshmëri në nivelet 1 dhe 2, nivelet që tregojnë se as në nivelin minimal nuk janë arritur rezultatet në lëndën e Gjuhës shqipe. Në anën tjetër, në arritjet e nxënësve në testin e Matematikës, specifikuar në gjini, nuk kemi dallim domethënës statistikor, që e dallon arritshmërinë e nxënësve në raport me gjininë.

Kushtet shtëpiake për mësim gjatë pandemisë kanë ndikim në nivelet e arritjeve të nxënësve. Sipas rezultateve, mbi 75% e nxënësve që aspak nuk i kanë të përshtatshme kushtet shtëpiake për mësim – pa asnjë hapësirë të veçantë për mësim, qëndrojnë në nivelet 1 dhe 2 të arritshmërisë në lëndën e Gjuhës shqipe. Gjithashtu, numri i anëtarëve në familje dhe numri i fëmijëve në shkollë kanë ndikim në shkallën e arritshmërisë së nxënësve. Mbi 65% e nxënësve që vijnë nga familje me mbi 4 fëmijë në shkollë kanë arritshmëri kryesisht në nivelet 1 dhe 2 të arritjeve. Këtë e tregojnë rezultatet e rreth 65% të nxënësve në Gjuhë shqipe, klasa e shtatë, dhe mbi 51 % e nxënësve në Matematikë, klasa e shtatë, që vijnë nga këto familje.



## **7.2. Mësimi në kushtet e pandemisë nga perspektiva e qëndrimeve të subjekteve të shkollave (drejtorëve, mësime dhënësve, prindërve dhe nxënësve)**

Në përgjithësi, përgatitjet e shkollave për fillimin e vitit shkollor 2020/2021 dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë mund të konsiderohen të mirëqena, kur kemi parasysh qëndrimet e shprehura nga drejtorët e shkollave dhe nga mësime dhënësit e përfshirë në këtë studim. Nga pozita udhëheqëse, drejtorët e shkollave i kanë vlerësuar më lart përgatitjet e shkollave dhe organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, kundrejt mësime dhënësve, të cilët krahas me organizimin e mësimit, gjatë këtij viti, në një pjesë të madhe të shkollave janë detyruar të merren edhe me matjen e temperaturës së nxënësve para se të fillojë orari mësimor.

Sikurse është paraqitur në kapitullin për rezultatet e studimit me respondentët e studimit, shkollat kanë punuar në përputhje me protokollet sipas skenarëve të mësimit. Referuar informacioneve të marra nga drejtorët e shkollave dhe mësime dhënësit e përfshirë në këtë hulumtim, gjatë vitit shkollor 2020/2021 rreth 84 % e shkollave kanë punuar sipas skenarit A të mësimit, me prani fizike të nxënësve dhe të mësime dhënësve. Shkollat e tjera kanë punuar sipas skenarit B dhe sipas skenarit C të mësimit, në rastet kur janë mbyllur si shkollë, apo në rast të mbylljes në shkallë vendi për shkak të situatës epidemiologjike. Në anën tjetër, raportohet se në disa komuna, në periudhën e tretë të mësimit, kanë vazhduar të punojnë vetëm me skenarin A, prezencë fizike në shkollë dhe me bashkim të grupeve të nxënësve. Me gjithë këtë, ndikimi në suksesin e nxënësve ka qenë i vogël.

Lidhur me *efektivitetin e organizimit të mësimit sipas skenarëve të mësimit në kushtet e pandemisë*, mësime dhënësit dhe drejtorët e shkollave të përfshirë në hulumtim kanë qëndrime të përafërta, me disa dallime të vogla. Nga perspektiva e mësime dhënësve kemi një nuancë më të lartë të vlerësimit për efektivitetin e mësimit, për 8% më e lartë se vlerësimet e drejtorëve të shkollave. Gjetjet e tilla në aspektin e dallimeve në mes të mësime dhënësve dhe drejtorëve të shkollave janë në linjë me rolet dhe përgjegjësitë që kanë, pasi mësime dhënësit më shumë i referohen punës se tyre personale apo ndërrimit të shkollës me të cilin punojnë, kundrejt drejtorëve të shkollave që

pasqyrojnë zhvillimet në shkollë nga një perspektivë më e gjerë. Në anën tjetër, kjo dallon nga nxënësit, ata për të cilët është organizuar mësimi në kushtet e pandemisë. Sipas vlerësimeve të 53.8% të nxënësve mësimi në kushtet e pandemisë COVID-19 ishte deri diku efektiv, 27.6% kanë thënë se nuk ishte aspak ose pak efektiv dhe sipas 19.5% të nxënësve mësimi në kushtet e pandemisë në masë të madhe apo plotësisht ishte efektiv.

Në përgjithësi, organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë, referuar qëndrimeve të respondentëve nga shkollat, mund të konsiderohet i suksesshëm. Vështirësitë e hasura gjatë periudhës së pandemisë në masë të madhe janë menaxhuar mirë, mirëpo procesi përshkruhet me sfida dhe shqetësime të shumta. Sa u përket sfidave dhe shqetësimeve kryesore që lidhen me organizimin e mësimit dhe efektivitetin e mësimit në kushtet e pandemisë, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave kanë pikëpamje afërsisht të njëjta. Sipas tyre, sfidat dhe shqetësimet kryesore gjatë kësaj periudhe ishin mungesa e pajisjeve të TIK-ut dhe e kompetencës digjitale të mësimdhënësve, planifikimi mësimor dhe zbatimi i kurrikulës ndryshimi i qasjes në mësim, ngarkesa emocionale dhe psikologjike e nxënësve, lodhja dhe ngarkesa e mësimdhënësve, performanca e nxënësve etj.

Prindërit kanë raportuar se organizimi i mësimit sipas skenarëve të mësimit në kushtet e pandemisë, mbajtja e distancës sociale nga fëmijët, mbajtja e maskave gjatë procesit mësimor, mësimi online, orari i shkurtër i mësimit, etj., kanë bërë që fëmijët e tyre të kenë vështirësi të theksuara për t'u adaptuar në mësim, të jenë të shqetësuar për ndryshimin e mënyrës së mësimit nga fëmijët e tyre dhe me frikë për rezultatet në mësim. Këtë qëndrim e kanë shprehur rreth 67% e prindërve. Në anën tjetër, një përqindje relativisht e madhe e prindërve (rreth 33% e tyre) deklaruan se te fëmijët e tyre nuk kanë vërejtur shqetësime të tilla dhe se ata gradualisht po adaptohen me ndryshimet në mënyrën e mësimit.

*Përfshirja e mësimdhënësve në trajnime gjatë periudhës së pandemisë* raportohet të jetë relativisht e mirë në aspektin sasior. Deklarimi i mësimdhënësve që kanë marrë pjesë vetëm në një trajnim gjatë pandemisë (rreth 35% e mësimdhënësve) tregon se pjesa më e madhe e trajnimeve disa orësh të mësimdhënësve lidhen me qasjet në platformat ZOOM, Google

Classroom etj. Në anën tjetër, rreth 11% e mësimeve nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim, ose kanë marrë pjesë vetëm në një aktivitet profesional në nivel shkolle. Përqindja tjetër e mësimeve (rreth 54%) raportojnë se kanë marrë pjesë në dy e më shumë programe të trajnimit. Mbetet sfida cilësia e trajnimeve gjatë periudhës së pandemisë, e cila edhe para pandemisë është vënë në pikëpyetje.

Në ndërlidhje me trajnimet e mësimeve gjatë pandemisë, të gjeturat me drejtorët e shkollave tregojnë që ka mungesë të evidencës në shkolla për përfshirjen e mësimeve në trajnime. Mungesa e evidencave vë në pikëpyetje gjithëpërfshirjen e mësimeve në trajnime, por edhe shkëmbimin e përvojave, mësimeve nga trajnimet.

*Planifikimi mësimor dhe zbatimi i kurrikulës gjatë pandemisë* raportohet nga drejtorët e shkollave dhe mësuesit si një nga sfidat kryesore. Të gjeturat tregojnë se nuk kishte udhëzime të mjaftueshme për mësuesin lidhur me planifikimet mësimore dhe realizimin e kurrikulave/programeve mësimore dhe se shumica e shkollave (rreth 84% e shkollave) kanë punuar me planet mësimore të hartuara nga ekipi profesional i mësimeve të komunës së Prishtinës. Gjithashtu, të gjeturat tregojnë se sfidat, shqetësimet kryesore me të cilat mësuesit janë ballafaquar në zbatimin e kurrikulës gjatë këtij viti shkollor ishin: orët e mësimit të shkurtra, cilësia e mësimit në kushtet e pandemisë, cilësia e qasjeve të mësimit që i praktikojnë mësuesit gjatë mësimit në distancë, pastaj vlerësimi i nxënësve, mungesa e teknologjisë të mësimit dhe të nxënësve etj.

*Pratikimi i mësimit online gjatë mësimit me prezencë fizike në shkollë* (skenarët e mësimit A dhe B) shihet si një mundësi për mësuesin për ta avancuar këtë qasje në mësim. Të gjeturat tregojnë se është e evidente që një pjesë e mësimeve nuk e kanë aplikuar mësimin online gjatë këtij viti shkollor, si një mundësi që të praktikohet edhe në procese të rregullta të mësimit, për përmbajtje të caktuara mësimore që lehtësojnë procesin e të nxënësve dhe mundësojnë lidhjen e situatave me shembuj nga jeta dhe puna praktike.

Lidhur me *kompetencat digjitale të mësimitdhënësve*, ka disa dallime se si i shohin vetë mësimitdhënësit kompetencat e tyre dhe si i shohin drejtorët e shkollave dhe nxënësit kompetencat digjitale të mësimitdhënësve të tyre. Mësimitdhënësit kanë një vlerësim më të lartë për nivelin e kompetencave të tyre digjitale në mësimitdhënie, pasi rreth 63 % e mësimitdhënësve janë shprehur se kanë nivel të mjaftueshëm ose të avancuar të kompetencave digjitale në mësimitdhënie, ndërsa këtë e thonë rreth 35% e drejtorëve të shkollave.

*E-mësimi përmes video-ligjëratave të orëve mësimore në RTK* ishte një prej mundësive për mësim në skenarin C të mësimit, por edhe mundësi për t'i shfrytëzuar video-ligjëratat e orëve mësimore, si nga mësimitdhënësit në punën me nxënë, ashtu edhe nga nxënësit për të nxënëit e tyre. Të gjeturat tregojnë se një pjesë e madhe e mësimitdhënësve nuk i kanë shikuar orët mësimore të shfaqura në televizionin publik dhe rrjedhimisht nuk kanë bërë ndërlidhje të mësimave me pritjet që nxënësit i përcjellin orët e mësimit të shfaqura përmes televizionit. Në anën tjetër, orët mësimore që janë shfaqur në programin e RTK-së, në përqindje më të lartë janë përcjellë nga nxënësit e klasës së shtatë, këtë e thonë mbi 50% e nxënësve të përfshirë në hulumtim. Ndërsa, sa i përket efektit të orëve mësimore dhe përfitimeve të nxënësve në të nxënë, ka dallime në mesin e nxënësve. Sa më i lartë që ka qenë vlerësimi i nxënësve për efektivitetin e orëve mësimore që shfaqen në programin RTK-së, aq më i lartë ka qenë edhe vlerësimi pozitiv për ndihmën e këtyre orëve në të nxënëit e tyre.

*Angazhimi i nxënësve në mësim gjatë periudhës së pandemisë* perceptohet në mënyra të ndryshme nga mësimitdhënësit, prindërit dhe nxënësit. Sipas mësimitdhënësve, interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar gjatë këtij viti shkollor në kushtet e pandemisë ishte relativisht i mirë, reflektohet të jetë ndikuar nga organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë, qasja e punës së mësimitdhënësve me nxënë, niveli i bashkëpunimit me prindër, mjedisi i të nxënëit në shkollë dhe në shtëpi. Nga prindërit përshkruhet të ketë qenë me dallime të mëdha, nga një grup i fëmijëve të cilët mesatarisht gjatë një dite janë angazhuar për mësim dhe detyra vetëm deri në një orë mësimore gjatë një dite, deri te grupi i fëmijëve të cilët janë angazhuar rreth mësimave më shumë se tri orë mësimore gjatë ditës. Në anën tjetër, nxënësit e klasës

së shtatë në përqindje të lartë, rreth 89%, deklarojnë se angazhimi i tyre gjatë pandemisë ka qenë i mirë dhe i lartë, kurse rreth 11% deklarojnë se ata kanë qenë tejet pasivë apo me interesim të ulët. Ky deklaram i nxënësve, lidhur me angazhimin e tyre në mësim, reflektohet në vlerësimet e mësimdhënësve, në notën mesatare të nxënësve në nivel shkolle, por nuk reflektohet në vlerësimin e bërë në kuadër të këtij studimi.

*Pabarazitë në mësim dhe humbjet mësimore* perceptohen në mënyra të ndryshme nga drejtorët e shkollave, mësimdhënësit dhe prindërit. Drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim nuk raportuan ndonjë të dhënë lidhur me pabarazitë në mësim të nxënësve gjatë këtij viti shkollor, por një pjesë relativisht e madhe e tyre, rreth 22% e mësimdhënësve dhe rreth 18% e drejtorëve të shkollave, kanë qëndrim se pandemia ka ndikuar në rritjen më të madhe të pabarazive në mësim, të cilat reflektohen në arritjet e nxënësve. Ata nuk kanë bërë ndonjë analizë që do të mund të ilustrohej me ndonjë të dhënë statistikore, mirëpo dominojnë vlerësimet se humbjet do të jenë më të mëdha në gjuhë, matematikë dhe shkencat natyrore, si dhe në lëndët ku ka pasur më shumë humbje të orëve të mësimin, duke veçuar lëndët e shkathtësive.

Tjetër çështje e ngritur nga shkollat (drejtorët dhe mësimdhënësit) janë masat e planifikuara për zvogëlimin dhe eliminimin e humbjeve mësimore, duke veçuar mbajtjen e mësimin plotësues, shtues, aktivitetet individuale me nxënës, zëvendësimin e orëve të humbura etj. Mirëpo, ata nuk ofrojnë ndonjë të dhënë më specifike për mënyrën e jetësimit të këtyre masave, kohëzgjatjen e tyre, përfshirjen e nxënësve etj.

Në anën tjetër, prindërit nuk kanë ndërtuar mendim apo qëndrim për humbjet mësimore të fëmijëve të tyre, nuk janë në gjendje që të ndajnë mendimin e tyre etj. Kjo reflektohet me mospërgjigje të 66% të prindërve të përfshirë në hulumtim, ndërsa pjesa tjetër e prindërve është e shpërndarë nga mendimi se do të ketë pak humbje që mund të kompensohen, deri te mendimi se do të ketë shumë humbje dhe vështirë se mund të kompensohen.

Si duket mungesa e debatit institucional për ndikimin e pandemisë në rritjen e pabarazive në mësim dhe humbjet mësimore në mësim ka bërë që humbjet

mësimore të mos shikohen si problem më vete, që në fillimet e pandemisë! Pavarësisht kësaj, pandemia COVID-19 pritet të ketë ndikim domethënës në nivelin e arritjeve të nxënësve dhe të ndikojë në shpërfaqjen e humbjeve mësimore. Sfidë mbetet vlerësimi real i nivelit të humbjeve mësimore dhe gjetja e modaliteteve të suksesshme për kompensimin e tyre.

*Përkrahja e fëmijëve nga prindërit* rezulton të jetë e ngritur gjatë periudhës së pandemisë. Ajo është dhënë më shumë për sigurimin e pajisjeve teknologjike për mësim online dhe për kryerjen e detyrave të shtëpisë. Mirëpo, prindërit më pak janë kujdesur që t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre të caktojnë një orar mësimi në shtëpi (vetëm 27% e prindërve janë shprehur se këtë e bëjnë për fëmijët e tyre), të mbajnë kontaktet me mësimdhënësit për të marrë informacione për nevojat e mbështetjes për fëmijët e tyre ( rreth 31 % e prindërve janë shprehur se këtë e bëjnë në mënyrë të vazhdueshme), etj.

Në anën tjetër, *raporti i prindërve me shkollën gjatë pandemisë* del të jetë kryesisht i lidhur me informimin për çdo ndryshim të bërë rreth organizimit të procesit mësimor në kushtet e pandemisë, këtë e thonë rreth 68% e prindërve. Vetëm 13% e prindërve janë shprehur se nga shkolla e fëmijëve të tyre kanë marrë kërkesë për ndihmën e prindërve, për të punuar me fëmijët e tyre rreth angazhimeve në mësim. Kjo tregon se shkolla dhe prindërit akoma nuk kanë një përkrahje reciproke të bashkëpunimit për çështje përmbajtjesore të organizimit të mësimi, arritjet e nxënësve dhe përfshirjen aktive të prindërve në këto procese. Duhet theksuar se bashkëpunimi i shkollës me prindër për çështje të procesit mësimor dhe arritjet e nxënësve, sipas qëndrimeve të mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave, është më i mirë në shkollat urbane dhe është më i shpeshtë në nivelin fillor.

### ***7.3. Kuadri i masave dhe politikave arsimore të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimi në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID - 19***

Gjatë analizës së kuadrit të masave dhe politikave arsimore të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimi në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID–19, kemi konstatuar se

masat e ndërmarra janë të përafërta si në vendet e rajonit dhe më gjerë, kjo për faktin se pothuajse të gjitha sistemet arsimore pikënisje kanë marrë udhëzimet dhe rekomandimet e OBSH-së, të UNICEF-it dhe të mekanizmave shtetërorë, siç është IKShP-ja në rastin e Kosovës. Kjo mund të përshkruhet me:

- vendosjen e parimeve të punës që kanë në fokus mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve/nxënësve, qasjen në mësim dhe zhvillimin e kompetencave;
- vendosjen e mekanizmave për menaxhimin e mësimin në kushtet e pandemisë, në ndërlidhje me masat e vendosura nga IKShP-ja;
- protokollet për masat higjienike dhe mbrojtëse - rregullat e sjelljes dhe pasojat për organizimin shkollor;
- organizimin e vitit shkollor dhe të punës së shkollës sipas tre skenarëve të mësimin, nga skenari me prani fizike deri te skenari i mësimin në distancë.

Pra, korniza e planifikimit në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021 – në kushtet e pandemisë COVID-19, është mbështetur në Kornizën për rihapjen e institucioneve edukativo-arsimore të aprovuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara - UNESCO, UNICEF-i, Banka Botërore, WFP dhe UNHCR-ja.

Zhvillimi dhe miratimi i masave dhe politikave arsimore për organizimin e mësimin në arsimin parauniversitar në kushtet e pandemisë COVID-19, përgatitjet e bëra për fillimin e vitit shkollor 2020/2021, ulja e rasteve të infektiveve në fillimet e vitit shkollor, bënë të mundur që, si në shumë vende, edhe në Kosovë të ndodhë kthimi në shkollë dhe mësimi të organizohet sipas protokolleve të skenarëve të mësimin në kushtet e pandemisë.

Në anën tjetër, kuadri i masave dhe politikave arsimore të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimin në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID-19, del të jetë më shumë në nivel të planifikimeve dhe udhëzimeve të përgjithshme, dhe jo në nivel të

masave të drejtpërdrejta, që duhet të rezultojnë me bartës të masave përkatëse dhe afate të përmbushjes, në mënyrë që ato të rezultojnë me efektivitet të mësimit në kushtet e pandemisë.

Menaxhimi i situatës me personel gjatë pandemisë është një nga masat e vendosura, mirëpo nuk është zbrërthyer si masë e zbatimit në kontekstin politikave dhe mundësive për rekrutimin e mësimitdhënësve, me qëllim të zëvendësimit të mësimitdhënësve që mungojnë për shkaqe shëndetësore. Kjo u reflektua në punën e shkollave, të cilat në përgjithësi e kishin të pamundur të mbulojnë orët mësimore në rastet kur ka pasur mësimitdhënës të cilët kanë qenë të infektuar me COVID-19 dhe nuk kanë mundur të mbajnë mësim në asnjërin prej skenarëve të mësimit.

Zbatimi i kurrikulës dhe udhëzimet metodologjike përvijohen në kuadër të masave të përcaktuara me udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 – në kushtet e pandemisë COVID-19. Mirëpo, ato nuk përcillen me masa të tjera, siç theksohet në udhëzuesin e përgjithshëm se grupi i kurrikulës në MAShTI do të përcaktojë një version më të përmbledhur të RNF dhe RNL për mësimin në kushtet e pandemisë, përfshirë edhe mësimin në distancë.

Pothuajse ngjashëm ishte edhe situata me masat e vendosura për përgatitjen dhe zbatimin e mësimit online, nuk janë vendosur masa dhe veprimet afatshkurta që duhet ndërmarrë për të siguruar një platformë bazike në nivel shkolle, e cila lehtëson punën e shkollës gjatë mësimit në kushtet e pandemisë, zhvillimin e materialeve mësimore digjitale dhe për ngritje të kompetencës digjitale të mësimitdhënësve. Kjo u reflektua në punën e shkollave, pasi vetëm disa shkolla që ishin pjesë e mbështetjes nga partnerët arritën të konsolidojnë platformë online në nivel shkolle për të lehtësuar mësimin në kushtet e pandemisë. Masa dhe veprime që mungonin në Udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID-19, janë vendosur në draftin e Strategjisë së Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026, mirëpo ato pritet të gjejnë zbatim tek në fillimet e zbatimit të PSAK-ut 2022-2026.



Pandemia COVID-19 ka përkeqësuar pabarazinë ekzistuese në mësim, e cila ishte e theksuar edhe para pandemisë - sipas studimit PISA 2018, duke goditur më së shumti grupet e marginalizuara, komunitetet më të varfra dhe më të cenueshme. Qasja ndaj grupeve të marginalizuara është e përshkruar në mesin e masave të vendosura në kuadër të Udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimin në arsimin parauniversitar në kushtet e pandemisë, mirëpo nuk ka të zhvilluar një politikë të veçantë për të shmangur thellimin e pabarazive arsimore gjatë pandemisë. Politikat, strategjitë dhe programet zhvillimore ekzistuese, me gjithë përparësitë e tyre, e humbin relevanten e tyre atëherë kur autoritetet përgjegjëse nuk kanë kapacitete dhe gatishmëri për t'i zbatuar (Rraci, E., 2020).

Një aspekt tjetër i adresuar me masat e vendosura për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë lidhet me monitorimin dhe inspektimin e arsimit parauniversitar. Edhe pse njëri nga parimet e vendosura për mësimin në kushtet e pandemisë shërben si udhërrëfyes për cilësinë e mësimin edhe në kushtet e pandemisë, bazuar në tri prioritetet e përcaktuara me udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020/2021, fokusi kryesor i monitorimit dhe inspektimit në arsimin parauniversitar vihet tek aspektet logjistike dhe organizative, jo në përmbajtjen e procesit mësimor, qasjet në mësimdhënie dhe cilësinë e mësimin në kushtet e pandemisë. Në anën tjetër, kjo nuk ka qenë pengesë për IA që të fokusohet edhe në çështjet e cilësisë së mësimin, mirëpo këtë nuk e reflektojnë raportet që referojnë zhvillimet në arsimin parauniversitar në Kosovë në kohë pandemie.

Në përgjithësi, masat e ndërmarra nga institucionet vendimmarrëse për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë janë përqendruar në organizimin e procesit mësimor: pjesëmarrjen fizike në shkollë, realizimin e programeve mësimore, ndërkaq, pavarësisht se mirëqenia e fëmijëve ishte parimi bazë i organizimit të mësimin në kushtet e pandemisë, pak janë vendosur masa dhe janë ofruar këshillim dhe mbështetje emocionale për fëmijët gjatë kësaj periudhe (KEC, 2021).

#### ***7.4. Zgjidhjet e mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim***

Zgjidhjet e mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim janë preokupim i të gjitha sistemeve arsimore, pra edhe i institucioneve të Republikës së Kosovës. Ballafaqimi me pandeminë edhe në vitin vijues shkollor vazhdon të sfidojë mbarëvajtjen e proceseve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Në anën tjetër, nuk kanë munguar përpjekjet për të gjetur zgjidhje të mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim, përfshirë mobilizimin që në të gjitha rrethanat e mundshme mësimi të mbahet në shkolla, me prani fizike të nxënësve dhe të mësimdhënësve. Organizimi i mësimit plotësues për nxënësit që kanë shfaqur ngecje në arritjen e rezultateve, si pasojë e COVID-19, është evidentuar si një përpjekje institucionale me shtrirje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Referuar raportit të MASHTI-t për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit që kanë shfaqur ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e COVID-19, MASHTI, në koordinim dhe bashkëveprim me gjithë aktorët e përfshirë në procesin arsimor dhe në veçanti mësimdhënësit, të cilët nëpërmjet formave interaktive të komunikimit dhe verifikimit të informacioneve/përvojave të mësimit kanë nxjerrë në pah dhe kanë identifikuar ngeçjet e nxënësve në mësim. Bazuar në identifikimet e bëra, shkollat dhe mësimdhënësit kanë planifikuar forma për përkrahjen e nxënësve në arritjen dhe përmbushjen me sukses të rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave të përcaktuara në programin mësimor lëndor, përmes organizimit të mësimit plotësues, për nxënësit e klasave I- XII.

Sipas raportit, procesi i organizimit dhe mbajtjes së mësimit plotësues për të gjithë nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar, të cilët pas identifikimit nga mësimdhënësit se kanë ngecje në të nxënë dhe pas planifikimit, ky proces ka filluar në të gjitha komunat e Republikës nga 7 maji i vitit 2021 dhe ka vazhduar deri në përfundim të vitit mësimor. Mësimi plotësues është organizuar dhe zhvilluar në fushat kurrikulare Gjuhë amtare, Matematikë dhe Shkencat natyrore, dhe mësimin e kanë vijuar gjithsej 181630 nxënës,

nga klasa e parë deri në të dymbëdhjetën (I-XII), apo 61.64% e nxënësve në nivel të vendit, duke i realizuar gjithsej 100365 orë mësimore.

Mësimi plotësues, i organizuar dhe zhvilluar në mbështetje të nxënësve me ngecje në të nxënë, nuk është raportuar se është zhvilluar me ndonjë orientim ndryshe nga organizimi i mësimit në kushte të pandemisë. Pa orientime për mësimdhënie të bazuar në projekte dhe në tema/përmbajtje të identifikuar nga nxënësit, e të drejtuara/plotësuara nga mësimdhënësi, si një mundësi më efektive, zgjidhje e mundshme afatshkurtër për adresimin e humbjeve mësimore. Pra, jo si mundësi për vlerësim shtesë me notë e përmirësim të notave, por me qëllim plotësimin dhe kompensimin e humbjeve mësimore.

Me vetë faktin se mësimi plotësues, i organizuar dhe zhvilluar në mbështetje të nxënësve me ngecje në të nxënë, nuk është reflektuar në rezultatet e vlerësimeve të bëra në kuadër të këtij studimi, kërkohet qasje tjetër ndaj organizimit të mësimit plotësues dhe të gjitha formave tjera për mbështetje të nxënësve.

Në radhë të parë, duhet mësuar nga përvoja e organizimit të mësimit plotësues në gjysmën e dytë të vitit shkollor 2020/2021, nuk duhet orientuar mbështetjen për nxënës vetëm në ofrimin e përmbajtjeve, të cilat mësimdhënësit nuk kanë arritur t'i ofrojnë gjatë periudhës së pandemisë. Mbështetja duhet të jetë e bazuara në atë se çfarë nxënësit në fakt kanë nevojë. Për këtë nevojiten udhëzime apo orientime të qarta nga MASHTI dhe DKA-ja. Orientimi në punë/mësimdhënie të bazuar në projekte dhe në tema/përmbajtje të identifikuar nga nxënësit, e të drejtuara/plotësuara nga mësimdhënësit, do të ishte një qasje sadopak e bazuar në nevoja të nxënësve. Lidhur me gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim, përtej organizimit të mësimit plotësues, akoma nuk janë ndërmarrë iniciativa të qëndrueshme përmes krijimit të një plani/strategjie shtetërore që sigurojnë trajtimin e problematikës me një qasje gjithëpërfshirëse. Ndërsa për një plan më afatgjatë të mbështetjes së sistemit arsimor është filluar me përgatitjen e dokumentit strategjik për digjitalizim të sistemit të arsimit, si një mundësi për të përmirësuar cilësinë e mësimit online, modalitet i mësimit, që si duket do të jetë i pashmangshëm edhe për një kohë, pasi që situata me pandeminë nuk duket se do të jetë (shumë) ndryshe edhe në vitin shkollor 2021/2022,

mirëpo deri në kohën e hartimit të këtij raporti nuk është shënuar ndonjë progres në këtë drejtim.

Në anën tjetër, institucionet ndërkombëtare, si Banka Botërore, UNICEF-i, që analizojnë ndikimet e pandemisë në arsim, nga perspektiva të shumta: ekonomike, sociale, financiare etj., lidhur me gjetjen e zgjidhjeve të mundshme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim, ndër të tjera, rekomandojnë që sistemet arsimore: (i) të ofrojnë programe për shkolla verore dhe programe të tjera të mësimin të përsheptuar për ta kompensuar humbjen e të nxënies të fëmijët, veçanërisht për ata që rrezikojnë të mbeten prapa; (ii) të sigurojnë dhe të përmirësojnë financimin arsimor për të lehtësuar dhe parandaluar humbje të mëtejshme të të nxënies dhe për të mbështetur përmirësimet; (iii) të fuqizojnë mbështetësin mësimdhënësit dhe prindërit, në mënyrë që ata t'i ndihmojnë fëmijët për të mbetur të angazhuar në mësim etj. Referimi në këto rekomandime janë mundësi që duhet shfrytëzuar si zgjidhje afatmesme për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim.

Fillimi i hartimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë për periudhën 2022-2026 shihet si një mundësi afatmesme për përfshirje të nevojave për zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim dhe për të ndërmarre reforma që do të përmirësojnë performancën e arsimimit dhe që do të krijojnë qëndrueshmëri në kuadrin afatmesëm.

## 8. Përfundime dhe rekomandime

Qëllimi i këtij studimi ishte identifikimi i efekteve të COVID-19 në humbjet mësimore dhe në rritjen e pabarazive në mësim, mangësitë e sistemit në rrethana të tilla, si dhe propozimi i zgjidhjeve bazuar në rezultatet e tij. Nga gjetjet e studimit dolën në pah një varg i dëshmimeve që tregojnë se kishte një përgjigje të shpejtë të sistemit arsimor ndaj rrethanave të pandemisë për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Njëkohësisht kishte mjaft sfida dhe probleme, të cilat kanë ndikuar në thellimin e humbjeve mësimore dhe në rritjen e pabarazisë në mësim. Prandaj, vlerësojmë se gjetjet e këtij studimi do të shërbejnë për ndërmarrjen e hapave dhe masave të mëtejshme nga MASHTI, komunat dhe shkollat për përmbushjen e humbjeve mësimore dhe eliminimin e pabarazive në mësim në të ardhmen.

### 8.1. Përfundime

Përmbledhja e përfundimeve u referohet pyetjeve kërkimore, të cilat e udhëhoqën këtë studim. Nga analiza dhe krahasimi i të dhënave të fituara dhe të diskutuara, në lidhje me pyetjet kryesore të studimit, janë nxjerrë përfundimet në vijim:

- Mungesa e një sistemi të standardizuar të vlerësimit për shkallë kurrikulare në arsimin parauniversitar në Kosovë, si dhe mungesa e një sistemi për informata kthyesë në formën elektronike për arritjet e nxënësve, për të krahasuar arritjet e rezultateve të nxënësve në raport me klasë dhe lëndë mësimore të caktuara, ka pamundësuar një vlerësim të saktë të humbjeve mësimore nga ndikimi i pandemisë dhe njëkohësisht pamundëson planifikimin dhe orientimin e qartë të çfarëdo nisme për kompensim të humbjeve mësimore.
- Humbjet mësimore të nxënësve në Kosovë, nga ndikimi i pandemisë COVID-19, vijnë nga faktorë të ndryshëm, si: mbyllja e shkollave dhe mësimi në distancë; shkurtimi i kohës mësimore standarde (orëve të mësimi), reduktimi i orëve mësimore dhe përmbajtjeve kurrikulare në disa lëndë mësimore dhe metodat e mësimdhënies joefektive në kushtet

e pandemisë, kundrejt mësimdhënies në kushte të zakonshme në mjediset e klasës.

- Metodologjia për vlerësimin e humbjeve mësimore, e përdorur në këtë studim, tregon se ndikimi i pandemisë në humbjet mësimore është i mundshëm të jetë sipas dy skenarëve: (i) nga fillimi i pandemisë (mars 2020) dhe deri në fund të vitit shkollor 2020/2021, nxënësit në Kosovë kanë humbje mësimore të krahasuara me 41 pikë të të nxënësve në PISA, apo mbi një vit të shkollimit; dhe (ii) nxënësit nga fillimi i pandemisë, kanë humbje mësimore të krahasuara me 24 pikë të të nxënësve në PISA, apo më shumë se 60% e një viti të shkollimit.
- Humbjet mësimore dalin në pah edhe në vlerësimet e organizuara në kuadër të këtij studimi me nxënësit e klasës së dytë në lëndën e Gjuhës shqipe, të realizuar me një mostër të nxënësve 1260 dhe me nxënësit e klasës së shtatë në lëndët e Gjuhës shqipe dhe Matematikës, të realizuar me mostrën 1244 nxënës.
- Nxënësit e klasës së dytë në këtë vlerësim, me mesataren e arritshmërisë 51.5 %, kanë arritur vetëm minimumin bazë e rezultateve të të nxënësve dhe kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Nxënësit e klasës së dytë kanë probleme të theksuara në zbatimin e rregullave të drejtshkrimit elementar, në të shkruarit drejt, në përdorimin e shenjave të pikësimit, në shkrimin e një teksti të shkurtër në bazë të rregullave që lidhen me temën përkatëse, në vendosjen e titullit, në përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, në përdorimin e emrave të përveçëm etj.
- Nxënësit e klasës së shtatë në lëndën e Gjuhës shqipe, me mesataren e arritshmërisë 41.% dhe me mesataren e arritshmërisë 48% në Matematikë, kanë arritur vetëm minimumin e rezultateve bazë të të nxënësve dhe kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Rezultatet e përgjithshme në lëndën e Gjuhës shqipe tregojnë se rreth 51% e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënësve në

lëndën e Gjuhës shqipe, ndërsa 36 % e nxënësve të klasës së shtatë nuk i kanë arritur rezultatet e të nxënësve në lëndën e Matematikës, të cilat janë matur me test të vlerësimit në këtë studim.

- Referuar analizës së rezultateve sipas kërkesave/pyetjeve të veçanta në lëndën e Gjuhës shqipe dhe në lëndën e Matematikës, nxënësit kanë arritur rezultate më të larta në kërkesat/pyetjet në të cilat kërkohej përdorim i strategjive të memorizimit, kundrejt kërkesave që kërkonin përdorim të strategjive elaboruese dhe të mendimit kritik.
- Dallimet në arritjet e nxënësve në vlerësimet e realizuara në kuadër të studimit, të konvertuara në notë mesatare sipas sistemit të vlerësimit, në raport me notën mesatare të nxënësve të njëjtë në fund të vitit mësimor 2020/2021 – nga vlerësimi i mësimdhënësve, janë tejet të larta. Rreth 62% janë më të larta vlerësimet e mësimdhënësve kundrejt arritjeve të nxënësve në vlerësimet e realizuara në këtë studim. Dallimet tregojnë për kritere të ndryshme që aplikojnë mësimdhënësit në vendosjen e notave për nxënës.
- Nxënësit kanë arritshmëri të ulët, pavarësisht skenarëve të mësimi dhe numrit të nxënësve në shkolla. Nuk ka dallim domethënës statistikor që e dallon arritshmërinë e nxënësve në raport me skenarët e mësimi dhe numrin e nxënësve në shkolla.
- Në vlerësimet e realizuara në kuadër të studimit janë identifikuar dallime në arritjet e nxënësve sa i përket vendbanimit (fshat–qytet), gjinisë, kushteve shtëpiake për mësim gjatë pandemisë, si dhe dallime në raport me arritjet e nxënësve sipas numrit të anëtarëve në familje dhe numrit të fëmijëve në shkollë.
- Sfidat dhe shqetësimet kryesore për organizimin e mësimi në kushtet e pandemisë, që raportohen nga shkollat, janë: mungesa e pajisjeve të TIK-ut dhe kompetencës digjitale të mësimdhënësve, cilësia e planifikimit të zbatimit të kurrikulës në kushtet e pandemisë, ndryshimi

i qasjes në mësim, ngarkesa emocionale dhe psikologjike e nxënësve, lodhja, ngarkesa e mësimdhënësve gjatë punës me dy grupe të nxënësve, performanca e nxënësve etj.

- Humbjet mësimore janë një nga shqetësimet më të mëdha të ngritura nga shkollat, mirëpo nuk raportohen dëshmi dhe evidenca statistikore nga matje dhe analiza të bëra në nivel shkolle, nivelet e humbjeve etj. Bazuar në vlerësime të përgjithshme, nga shkollat raportohet se humbjet mësimore janë më të mëdha në gjuhë, matematikë dhe shkencat natyrore, me gjithë faktin se për këto lëndë mësimore është organizuar mësimi plotësues bazuar në vendimet e MAShTI-t.
- Masat e planifikuara nga shkollat për zvogëlimin dhe eliminimin e humbjeve mësimore kryesisht përqendrohen në mbajtjen e mësimit plotësues, aktivitetet individuale me nxënës dhe zëvendësimin e orëve të humbura. Organizimi i mësimit plotësues për nxënësit që kanë shfaqur ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e COVID-19 është evidentuar si një përpjekje institucionale me shtrirje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Mirëpo, mësimi plotësues, i organizuar dhe zhvilluar në mbështetje të nxënësve me ngecje në të nxënë, nuk është reflektuar në rezultatet e vlerësimeve të bëra në kuadër të këtij studimi.
- Mungesa e debatit institucional për ndikimin e pandemisë në rritjen e pabarazive në mësim dhe humbjet mësimore në mësim ka bërë që institucionet shkollore të mos kenë një fokus më të veçantë ndaj kësaj problematike. Në anën tjetër, vlerësimi real i nivelit të humbjeve mësimore dhe gjetja e modaliteteve të suksesshme për kompensimin e tyre konsiderohen sfida të mëdha për shkollat.
- Interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar gjatë këtij viti shkollor në kushtet e pandemisë, nga pjesëmarrësit e shkollave reflektohet të jetë ndikuar nga organizimi i mësimit dhe skenarët e mësimit në kushtet e pandemisë, qasja e punës së mësimdhënësve me



nxënës, niveli i bashkëpunimit me prindër, mjedisi i të nxënësve në shkollë dhe në shtëpi.

- Përkrahja e fëmijëve nga prindërit është rritur gjatë pandemisë, e drejtuar më shumë për sigurimin e pajisjeve teknologjike për mësim online dhe për kryerjen e detyrave të shtëpisë. Ndërsa, raporti i prindërve me shkollën gjatë pandemisë del të jetë kryesisht i lidhur me aspektet e informimit rreth organizimit të procesit mësimor në kushtet e pandemisë, kundrejt nevojës për ta fokusuar bashkëpunimin lidhur me ndihmën e prindërve, për të punuar me fëmijët e tyre rreth angazhimeve në mësim.
- Kuadri i masave dhe politikave arsimore të ndërmarra nga institucionet arsimore në Kosovë, për organizimin e mësimi në arsimin parauniversitar në kushtet e pandemisë COVID-19, janë të përafërta me ato të vendeve të rajonit dhe më gjerë dhe në mbështetje të udhëzimeve dhe rekomandimeve të IKShPK-së, të cilat kanë referencë Kornizën për rihapjen e institucioneve edukativo-arsimore, të aprovuar nga mekanizmat relevantë ndërkombëtarë.
- Në përgjithësi, masat e ndërmarra nga institucionet vendimmarrëse për organizimin e mësimi në kushtet e pandemisë janë përqendruar më shumë në organizimin e procesit mësimor, pjesëmarrjen fizike në shkollë. Po ashtu, në realizimin e programeve mësimore, kundrejt masave dhe veprimeve për këshillimin dhe mbështetjen psiko-sociale për fëmijët gjatë mësimi në kushtet e pandemisë dhe masave e veprimeve për të shmangur thellimin e pabarazive arsimore dhe zvogëlimin e humbjeve mësimore gjatë pandemisë.
- Një pjesë e masave të përshkruara në Kornizën e planifikimit për t'u ndërmarrë nga institucionet arsimore në Kosovë për organizimin e mësimi në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë COVID – 19, kanë mbetur më shumë në nivel të planifikimeve dhe udhëzimeve të

përgjithshme dhe nuk raportohet se kanë gjetur zbatim për të ngritur efektivitetin e mësimin në kushtet e pandemisë.

- Menaxhimi i situatës me personel gjatë pandemisë nuk është zbrëthyer si masë e zbatimit në kontekstin e mundësive për rekrutimin e mësimitdhënësve, me qëllim të zëvendësimit të mësimitdhënësve që mungojnë për shkaqe shëndetësore. Kjo u reflektua në punën e shkollave, të cilat në përgjithësi e kishin të pamundur të mbulonin orët mësimore në rastet kur ka pasur mësimitdhënës të infektuar me COVID-19 dhe nuk kanë mundur të mbajnë mësim në asnjërin prej skenarëve të mësimin.
- Përfshirja e mësimitdhënësve në trajnime gjatë periudhës së pandemisë, në aspektin sasior, raportohet të jetë relativisht e mirë. Mirëpo, të gjeturat tregojnë se ka mungesë të evidencës në shkolla për përfshirjen e mësimitdhënësve në trajnime. Mungesa e evidencave vë në pikëpyetje gjithëpërfshirjen e mësimitdhënësve në trajnime. Në anën tjetër, mbetet sfida cilësia e trajnimeve të ofruara për mësimitdhënës gjatë periudhës së pandemisë.
- Fokusi kryesor i monitorimit dhe inspektimit në arsimin parauniversitar gjatë pandemisë është vendosur tek aspektet logjistike dhe organizative, jo në përmbajtjen e procesit mësimor, qasjet në mësimitdhënje dhe cilësinë e mësimin në kushtet e pandemisë. Mirëpo, kjo nuk ka qenë pengesë për IA që të fokusohet edhe në çështjet e cilësisë së mësimin.
- MASHTI, me gjithë masat e pasqyruara në këtë raport, akoma nuk ka ndërmarrë iniciativa të qëndrueshme, përmes krijimit të një plani/strategjie shtetërore, për trajtimin e problematikës së humbjeve mësimore me një plan afatmesëm dhe afatgjatë, pasi që vazhdimi i pandemisë COVID-19 pritet të ketë ndikim domethënës në performancën e nxënësve, në humbjet mësimore dhe në rritjen e pabarazive në mësim.

- Përvoja në organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë, mësimit nga këto përvoja, u vlerësuan se janë një mundësi e mirë për të kuptuar rëndësinë dhe përparësinë e shfrytëzimit të teknologjisë në mësimdhënie. Për të ndërmarrë masa konkrete në zhvillimin e kompetencës digjitale, në mënyrë të veçantë të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, dhe për digjitalizimin e arsimit. Pandemia nuk nënkupton vetëm një gjendje emergjence, por ajo gjithashtu mund të shfaqë një perspektivë mundësish për rishikim apo rikonceptualizim kombëtar të sistemit arsimor – duke u orientuar kështu drejt një sistemi të ri vlerash (Madhi & Trupia, 2021).

## 8.2. *Rekomandime*

Me qëllimi të orientimit të politikave dhe të praktikave institucionale për të zbutur në masë të mundshme humbjet dhe pabarazitë mësimore, sikurse kanë vepruar të gjitha vendet, bazuar në gjetjet e studimit, po japim këto rekomandime:

- Për adresimin e të gjitha problemeve të arsimit parauniversitar që lidhen me cilësinë e arsimit, ato të njohura para pandemisë dhe ato të shpërfaqura gjatë periudhës së pandemisë, nevojitet planifikim dhe bashkërendim i integruar i veprimeve ndërmjet të gjitha niveleve të institucioneve arsimore në Kosovë, duke iu referuar edhe rekomandimeve të mekanizmave ndërkombëtarë për ngritjen e sistemeve arsimore pas pandemisë.
- MASHTI duhet të hartojë plan kombëtar për zvogëlimin e humbjeve mësimore të ndikuara nga COVID-19 dhe për eliminimin e pabarazisë në mësim, të mbështetur financiarisht, si dhe të zhvillojë një mekanizëm efektiv dhe të përshtatshëm në ndihmë shkollave për vlerësimin real të humbjeve mësimore dhe për mbështetje afatgjate të nxënësve për kompensimin e humbjeve mësimore.

- Duke marrë parasysh se pandemia COVID-19 nuk dihet ende se sa do të vazhdojë, është e domosdoshme që të përshpejtohen veprimet për digjitalizimin e arsimit, me theks të veçantë për zhvillimin e një platforme të standardizuar për organizimin e mësimin në distancë, zhvillimin e materialeve mësimore digjitale dhe ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve për kompetencat digjitale në mësimdhënie.
- Ndërrimi i qasjes në raport me dinamikën e kompletimit të shërbimeve profesionale në nivel shkolle dhe të asistentëve mbështetës duhet të jetë prioritet i institucioneve arsimore. Funksionalizimi i mekanizmave të këshillimit dhe mbështetjes psiko-sociale, emocionale dhe profesionale, mund të shmangë thellimin e pabarazive arsimore dhe mund të ndikojë në zvogëlimin humbjeve mësimore të shkaktuara nga pandemia dhe cilësia e ulët e arsimit.
- Fuqizimi i mekanizmave të monitorimit dhe mbështetjes për të siguruar llogaridhënie paraqitet si nevojë për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, e cila edhe nga ndikimet e pandemisë ka rënë shumë. Pastaj, ngritja e kapaciteteve të mekanizmave për sigurimin e cilësisë, nga niveli qendror deri në nivelin e shkollës, është mënyrë që siguron përmbushjen e roleve dhe përgjegjësive të tyre për sigurim të cilësisë dhe mundësi për të siguruar përgjegjësi dhe llogaridhënie.
- Komunitat/DKA-të rekomandohen të mbështesin shkollat në adresimin e sfidave dhe problemeve që lidhen me organizimin e shkollës, kushtet e mësimdhënies në shkollë, kompletimin e shkollave me pajisje të TIK-ut dhe internetit të qëndrueshëm. Gjithashtu, të ofrojnë mundësi e përkrahje për shkollat, për zbatimin e autonomisë së shkollës, menaxhimin e financave nga shkollat, si dhe funksionalizimin e mekanizmave të shkollës, të cilët kanë rol në vendimmarrje dhe në aktivitetet profesionale që zhvillohen nga shkollat.
- Institucionet arsimore/shkollat të analizojnë rezultatet e këtij studimi për arritjet e nxënësve, të analizojnë punën e tyre gjatë pandemisë,

arritjet, sfidat dhe problemet me të cilat janë ballafaquar, si dhe të ndërmarrin veprime konkrete, afatmesme dhe afatgjate për përkrahjen nxënësve për kompensimin e humbjeve mësimore. T'u kushtohet kujdes i veçantë fëmijëve që vijnë nga grupet e cenueshme, punës me nxënës me projekte, si programe të njohura për shkolla verore dhe programe të tjera të mësimin të përsheptuar për të kompensuar humbjen mësimore.

- Mbështetja e fëmijëve nga prindërit për t'u përballur me të nxënit në kushtet e pandemisë dhe për mësim në shtëpi duhet të jetë e vazhdueshme, krahas kujdesit për sigurimin e teknologjisë për mësim dhe përdorimin e saj për qëllime mësimore. Në anën tjetër, sistemi arsimor duhet të sigurojë mbështetje për prindërit që kanë burime të kufizuara dhe kanë shumë fëmijë për të mbajtur në shkollë, ndërsa shkollat duhet të thellojnë bashkëpunimin e vazhdueshëm me prindër për çështje të mësimin në zvogëlimin e humbjeve mësimore, si dhe për çështje të këshillimit dhe përkrahjes socio-emocionale të fëmijëve.
- Duke u bazuar në gjetjet e këtij studimi, sidomos në problemet e shfaqura në sistem, në aspektin e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe përgatitjen e tyre, por edhe në sistemin për sigurimin e cilësisë në shkollimin parauniversitar, kërkohen të bëhen hapa konkretë dhe ndryshime cilësore.
- Për të kompletuar gjithanshëm studimin për ndikimin e COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit, rekomandohet që të bëhen studime të mëtejme, për aspekte të veçanta, për të parë më thellësisht disa nga aspektet që nuk janë mbuluar me këtë studim, si pasojat psiko-sociale të fëmijët, ndikimin në raportet sociale të fëmijët, përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të teknologjisë nga fëmijët për një kohë më të gjatë etj.

Për të zbatuar këto rekomandime, është i domosdoshëm bashkërendimi ndërmjet vendimmarrësve dhe profesionistëve. Humbjet mësimore dhe jo

vetëm, të konstatuara me këtë studim, paraqesin një referencë të qartë për ndërmarrjen e hapave konkretë, të planifikuar mirë, për zbutjen e pabarazisë në shkollim, por edhe për “shërimin” e segmenteve jofunksionale të sistemit arsimor në Kosovë. Sa më shpejt të kuptojmë se mësimi/shkolla nuk është më siç ka qenë dhe nuk do të jetë edhe një kohë të gjatë, aq më shumë ka shpresë se sistemi i arsimit në Kosovë mund të përmirësohet dhe të avancohet. Shpërfillja e kësaj situatë nuk është gjë tjetër vetëm se ikje nga përgjegjësia dhe mungesa e vullnetit dhe përkushtimit për ngritje të cilësisë së arsimit dhe rikthimit të besimit të shkolla/mësimdhënia.

## Referencat

- Banka Botërore (2020). Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, Vlerësim i ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundërpërgjigja e vendeve. <https://pubdocs.eorlbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>
- Bradshaw, J., (2014). PISA: Sfidat dhe mundësitë. Fjalimi kryesor në konferencën: Kosova në PISA 2015 – Ndikimi i vlerësimit të nxënësve në cilësinë e arsimit. MASHT, Kosovë.
- Deschaine, M. E. (2021). “Ala Carte” Education: An Inevitable Outgroëth of COVID? *Academia Letters*, Article 134, <https://doi.org/10.20935/AL134>.
- Engzell, P., Frey, A., Verhagen, M.D. (2021). Learning loss due to school closures during the COVID-19 pandemic, *PNAS*, Vol. 118 No. 17, <https://doi.org/10.1073/pnas.2022376118>.
- European Commission, (2020). Implications of the novel coronavirus (COVID-19) on education and training: State-of-play in Member States EAC-NA-COORDINATION@ec.europa.eu.
- GLOSSARY OF EDUCATION REFORM, online, cituar më 10.10.2021.
- Gurr, D. (2021). Educational Leadership and the Pandemic. *Academia Letters*, Article 29. <https://doi.org/10.20935/AL29>.
- Hyseni-Duraku, Z. & Nagavci, M. (2020). Ndikimi i pandemisë COVID-19 në edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin parauniversitar, UP, Prishtinë.
- Implikimet e koronavirusit të ri (COVID-19) në arsim dhe trajnime: Gjendja në shtetet anëtare (Implications of the novel coronavirus (COVID-19) on education and training: State-of-play in Member States), Presidenca Kroate e Këshillit të Bashkimit Evropian, Versioni i 9-të i 31.03.2020.
- Instituti Pedagogjik i Kosovës (2020). Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19. IPK, Prishtinë.
- De Witte, K. & Maldonado, J. E. (2020). Kriza e COVID-19 dhe mbyllja e shkollave, efektet në performancën e nxënësve dhe në pabarazinë arsimore. <https://www.katholiekonderëijs.vlaanderen/engels>

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

Martin J., Tomasik, Laura, A., Helbling, Moser, U. (2020). Educational gains of in-person vs. distance learning in primary and secondary schools: A natural experiment during the COVID-19 pandemic school closures in Switzerland. <https://doi.org/10.1002/ijop.12728><https://onlinelibrary.wiley.com/doi/full/10.1002/ijop.12728>

MASHTI (korrik, 2021): Raport për organizimin e mësimi plotësues për nxënësit që kanë shfaqur neçje në arritjen e rezultateve si pasojë e COVID-19. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2021/08/raporti-mbi-organizimin-e-mesimit-plotesues-ne-shkolla-2-converted.pdf>

Matthews, B., Ross, L. (2010): METODAT E HULUMTIMIT. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.

Mehmeti, S., (2021). Ndikimi i pandemisë COVID-19 në arsimin parauniversitar në Kosovë. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Prishtinë.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. (2020). Master plani për zhvillimin e mësimi në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, (2020). Rezultatet nga studimi ndërkombëtar TIMSS 2019 (8 Dhjetor 2020). <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/12/timss-rezultatet.pdf>.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, (2020). Udhëzues i përgjithshëm i MASH për organizimin e mësimi në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezuesi-final-file-10-09-2020.pdf>.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. (2020). Udhëzues për qasjen dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta për vitin shkollor 2020-2021. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. (2020\_01). Udhëzues për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/10/udhezuesi-per-vleresim-2020\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/10/udhezuesi-per-vleresim-2020_1.pdf).

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimi në distancë, <https://masht.rks->



[gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti_1.pdf)

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta (SHML). [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf)

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për DKA për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti_1.pdf)

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Përdorimi i platformës Zoom –Zoom – us. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti_1.pdf)

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, (2020). Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimit në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf>.

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Vendimi 25/01B për procedurat realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/vendim-procedurat-e-realizimit-te-vleresimit-te-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance-ne-te-gjitha-nivelet-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove-24042020.pdf>.

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Master plani për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (2016). Raport për arritjet e nxënësve të Kosovës në PISA 2015. Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim (DVSM), MASHT.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (2019). Raport i arritshmërisë së nxënësve të Kosovës në PISA 2018 (Programi i OBEZh-it për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve). Divizioni për Sigurim të Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim, MASHT.

Morina, M., Uka, A., Raza, K. (2021). A case study of kosovan teachers' transition to distance education during the covid-19 pandemic, International Journal on Innovations in Online Education, 5(2) 2021.

Osdautaj, M., (2020). Gjendja e arsimit kosovar bazuar në testin PISA 2018. Instituti Pedagogjik i Kosovës. <https://ipkmasht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/02/Gjendja-e-arsimit-kosovar-sipas-PISA-2018.pdf>.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). 2021. Editorial - Arsimi në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19. [http://mail.kec-ks.org/ep-content/uploads/2021/04/Editorial\\_Arsimi-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-COVID-19-FINAL.pdf](http://mail.kec-ks.org/ep-content/uploads/2021/04/Editorial_Arsimi-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-COVID-19-FINAL.pdf).

Qeveria e Republikës së Kosovës (11 mars 2020). Vendim për ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet..., <https://kryeministri-ks.net/dokumente/page/3/>.

Qirezi, B., (15.04.2020). Mbajtja në jetë e sistemit arsimor: Si po zhvillohet mësimi online në kohë pandemie? <https://d4d-ks.org/editorial/mbajtja-ne-jete-e-sistemit-arsimor-si-po-zhvillohet-mesimi-online-ne-kohe-pandemie/>.

Rraci, E., (2020). ARISE - Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim: Raport kombëtar për Kosovë. Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). <http://mail.kec-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/National-Report-Kosovo-ALB-Final.pdf>.

Udhëzues mbi mësimin në distancë & COVID19, versioni i 7 prillit 2020, Banka Botërore. <http://documents.eorlbank.org/curated/en/531681585957264427/pdf/Guidance-Note-on-Remote-Learning-and-COVID-19.pdf> .

Udhëzuesi mbi përgjigjen emergjente: Televizioni Edukativ & COVID-19, versioni i 17 prillit 2020, Banka Botërore. <http://documents.eorlbank.org/curated/en/659411587145759242/pdf/Rapid-Response-Guidance-Note-Educational-Television-COVID-19.pdf>.

UNESCO (2020, Motivimi i fëmijëve gjatë mëimit nga shtëpia. <https://en.unesco.org/news/resources-parents-and-teachers-motivating-supporting-children-during-remote-learning> .

UNICEF (2020a). Manuali i Mësuesve të Platformës ‘LearnIn’ për të Nxënit gjatë Emergjencave - Krijimi i mënyrave të personalizuara të të nxënit për nxënësit. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-3-krijimi-i-menyrave-te-personalizuara-te-te-nxenit.pdf>.

UNICEF (2020b). Manuali i Mësuesve të Platformës ‘LearnIn’ për të Nxënit gjatë Emergjencave - Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-2-mirepritja-e-nxenesve-serish-ne-shkolle.pdf>

UNICEF (2020c). Manuali i Mësuesve të Platformës ‘LearnIn’ për të Nxënit gjatë Emergjencave - Mbështetja e nxënësve gjatë izolimit në shtëpi. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-1-mbeshtetja-e-nxenesve-gjate-izolimit-ne-shtepi.pdf>.

UNICEF (2020). Zyra Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore (2020). Ngritja e Sistemeve Arsimore të Qëndrueshme pas Pandemisë COVID-19: Konsiderata për vendimmarrësit e institucioneve arsimore në nivel kombëtar, vendor dhe shkolle. [https://www.unicef.org/albania/media/3116/file/ECAR%20guidelines%20FOR%20EDUCATION%20PROVISION%20\(ALB\)%20.pdf](https://www.unicef.org/albania/media/3116/file/ECAR%20guidelines%20FOR%20EDUCATION%20PROVISION%20(ALB)%20.pdf).

Tomasik, M.J., Helbling, L.A., Moser, U. (2020). Educational gains of in-person vs. distance learning in primary and secondary schools: A natural experiment during the COVID-19 pandemic school closures in Sëitëzlerland, *International Journal of Psychology*, DOI: 10.1002/ijop.12728.

Tonković, A., Pongračić, L., Vrsalović, P. (2020). Djelovanje pandemije Covid-19 na obrazovanje diljem svijeta, *Časopis za odgojne i obrazovne znanosti Foo2rama*, Vol. 4, No. 4.

Thaçi, J., (2020). Analizë Paraprake e Gjendjes për Strategjinë e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026. Instituti ATOMI, Prishtinë.

**Botues**  
Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Shtypi**  
Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 300 copë

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37:311(496.51)"2019/2020-2020/2021"(083.4)  
37(496.51)(092)

Ndikimi i COVID-19 në humbjet mësimore, pasojat në rritjen e pabarazive në mësim dhe sfidat e përmbushjes/kompensimit /  
Selim Mehmeti ... [et al.] - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2021. - 156 f. : ilustr. ; 24 cm.

Arsimi -- Statistika -- "2019/2020-2020/2021" -- Kosovë  
Arsimi -- Mësimdhënia -- Kosovë

**ISBN 978-9951-591-56-0**

Aleph [000099333]